**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

**01 Nr. 02/23**
**Rahovec, 16.02.2023**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e dytë (2), e cila do të mbahet më **28 shkurt 2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.
Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.406/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban 2022- 2027;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.404/22, i datës 28.12.2022, për miratimin e Planit të Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera për Komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim - plotësimit të Rregullores 01 Nr.05/23, të datës 30.1.2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21, e datës 26.2.2021;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për faljen e borxheve të papaguara për taksat në aktivitete (afariste), nga data 1.1.2000– 31.1.2017;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.149/2006, i datës 14.7.2006;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për caktimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe të zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo - arsimore;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2022, në vitin 2023;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik P-01952-1, zona kadastrale Ratkoc;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-01952-1;
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë P-02240-73, zona Kadastrale Rahovec;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale P-02240-73;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Kramovik P-00330-0;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim - vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë; - P – 00722-0;
16. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private P- 01041-1 ZK – Xërxë;
17. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
18. Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike - 2022 - Kontratat kornizë;
19. Informatë mbi menaxhimin e aseteve për vitin 2022;
20. Informatë nga DKA-ja për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Delfrim Kafexhiu**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. I prot / Br. prot. 424 Më / Dt. 08.02.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

| | |
|---|---|
| DATË /A: | 7/02/2022 |
| PËR/ZA/TO : | Defrim Kafexhiu, Kruesues i Kuvendit Komunal |
| NGA/OD/FROM: | Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm |
| LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Informatë mbi menaxhimin e aseteve për vitin 2022 |

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, respektivisht sektori për menaxhimin e aseteve komunale, është përgjegjës për regjistrimin, inventarizimin, tjetërsimin dhe asgjësimin e aseteve komunale dhe mbi bazën e kësaj përgatit raporte periodike dhe vjetore.

Poashtu, në çdo vit kalendarik DEZHT, përgatit pikë informuese për Kuvendin Komunal në Rahovec, mbi menaxhimin e aseteve komunale.

Gjatë vitit 2022, me propozim të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, drejtuar Kryetarit të komunës z.Smajl Latifi, janë formuar këto komisione lidhur me pasuritë e komunës së Rahovecit:

- Komisioni për regjistrimin e pasurive jo-financiare;
- Komisioni për inventarizimin e pasurive jo-finaciare;
- Komisioni për tjetërsimin e pasurive jo-financiare;
- Komisioni për asgjësimin e pasurive jo financiare.

Të gjitha komisionet e formuara e kanë kryer punën me kohë, duke filluar nga procesi i regjistrimit të aseteve, inventarizimi, kurse gjatë vitit 2022 nuk ka pasur tjetërsim dhe asgjësim të aseteve.

-Në fund të vitit 2022 komisioni i ka kryer inventarizimin e pasurive jo finaciare në Administratë, objektet e Arsimit, QKMF dhe objektet tjera përcjellëse.

-Komisioni i regjistrimit e ka përfunduar regjistrimet dhe ka evidentuar në Administratë komunale, objektet kulturore dhe sportive gjithsej 7.276 asete, në shkolla janë evidentuar 21.205 asete, kurse në QKMF, QMF dhe AMF 1.831 asete.

**Regjistrimet mbi 1,000.00€ dhe me pak se 1,000.00€ gjatë vitit 2022.**

| Nr. | Përshkrimi | Numri i Regjistrimeve | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Regjistrimet mbi 1,000.00€ | 316 | 7,685,253.99€ |
| 2 | Regjistrimet nën 1,000.00€ | 459 | 110,030.76 € |
| TOTAL | | 775 | 7,795,284.75€ |

**Asetet nën 1,000.00€ sipas kodeve nga data 01.01.2000 - 31.12.2022 të cilat janë të regjistruara në programin e-Pasuria.**

| Nr. | Përshkrimi | Kodi | Artikuj | Vlera |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mobilje | 13501 | 24810 | 228,270.44 € |
| 2 | Paisje të teknologjis Informative-TIK | 13503 | 2155 | 121,990.52 € |
| 3 | Paisje Mjekësore | 13506 | 295 | 13,200.00 € |
| 4 | Paisje tjera | 13509 | 2600 | 43,778.82 € |
| | TOTALI | | 29860 | 407,239.78 € |

**-Regjistrimet në vlerën mbi 1,000.00€ sipas klasave të pasuris të regjistruara nga viti 2000 deri më 31.12.2022 në programin SIMFK:**

| Nr. | Klasa Pasurive | Kodi | Vlera |
|---|---|---|---|
| 1 | Objekte Arsimore | 31121 | 13,751,050.90 € |
| 2 | Objekte Sportive | 31124 | 2,046,987.13 € |
| 3 | Objekte Kulturore | 31123 | 1,763,480.38 € |
| 4 | Vetura të ndihmës së shpejtë | 31703 | 51,685.54 € |
| 5 | Paisje speciale mjekësore | 31660 | 14,252.53 € |
| 6 | Objekte Shëndetsore | 31122 | 3,178,022.71 € |
| 7 | Kapitale tjera | 31900 | 190,734.65 € |
| 8 | Kamiona | 31701 | 18,157.40 € |
| 9 | Kanalizim | 31250 | 674,293.56 € |
| 10 | Ndërtimi i rrugëve | 31200 | 367,369.62 € |
| 11 | Tokat | 32100 | 75,104,323.90 € |
| 12 | Paisje të tjera | 31690 | 9,223.91 € |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 13 | Ujësjellës | 31400 | 209,681.28 € |
| 14 | Trotuare | 31240 | 264,279.31 € |
| 15 | Ndërtimi i rrugëve lokale | 31230 | 1,753,619.97 € |
| 16 | Ndërtesat banesore | 31110 | 6,914,543.89 € |
| 17 | Ndërtimi i rrugëve regjionale | 31220 | 47,932.50 € |
| 18 | Investimet në vijim | 32500 | 27,810,673.00 € |
| 19 | Veturat zyrtare | 31700 | - € |
| 20 | Automjet transporti | 31706 | - € |
| 21 | Furnizim me rrymë-gjenerator | 31510 | 13,411.00 € |
| 22 | Struktura tjera | 31130 | 647,960.02 € |
| 23 | Ndërtesa e administratës afariste | 31120 | 6,649,110.51 € |
| | **TOTALI** | | **141,480,793.71 €** |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
-IV- Nr. I prot / Br. prot. 755 Më / Dt. 08.02.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

# Informatë e DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të Vitit Shkollor 2022/2023

Të nderuar!

Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë 4 muajve të gjysmëvjetorit të parë është angazhuar për përcjelljen e mbarëvajtjes së procesit edukativo arsimor.
Ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht në kontakt të përhershëm dhe në vizita në shkolla dhe sipas të gjitha të dhënave, procesi mësimor i gjysmëvjetorit të parë pati filluar në të gjitha shkollat, por me vonesë prej 1 muaji, përkatësisht më 3 tetor 2022, pas pezullimit të grevës nga ana e sindikalistëve.
Pas fillimit të procesit mësimor, MASHTI hartoi Kalendarin e Ri, sipas të cilit parashihej që orët e humbura mësimore të zëvendësoheshin ditëve të shtuna. Mirëpo, ky kalendar i paraparë të zbatohej, praktikisht në komunën tonë nuk u zbatua, për shkak se SBASHKU, mësimdhënësit dhe Këshilli i Prindërve nuk pranuan të zbatojnë një skemë të tillë të zëvendësimeve.
Ajo që u zbatua në gjysmëvjetorin e parë ishte koha e përfundimit të këtij gjysmëvjetori, i cili këtë vit nuk përfundoi në fund të muajit dhjetor, por në fund të muajit janar, përkatësisht, më 27 janar 2023. Drejtoria Komunale e Arsimit kishte bërë gati një plan me një varg aktivitetesh dhe fillimisht kemi filluar vizitat e zyrtarëve të DKA-së në të gjitha shkollat. Vizita të këtilla nëpër shkolla kanë vazhduar sepse synojmë që sistemin arsimor të komunës sonë ta ngrisim në një nivel më të lartë, që siguron arsim cilësor.

Gjatë kësaj periudhe kemi kryer disa punë dhe kemi zhvilluar disa aktivitete:

- Pas lidhjes së kontratës për lëndë ngohëse, është bërë furnizimi i objekteve shkollore me dru dhe pelet.

- Me Aktivat Profesionale kemi mbajtur takimin e radhës për zgjerimin e Pakos Pedagogjike edhe për klasat e larta (9-12) dhe kjo Pako Pedagogjike tashmë është finalizuar edhe për ciklin e lartë. Për këtë projekt tashmë kemi nisur procedurën e realizimit.

- Është lidhur kontrata për ndërtimin e objektit të ri të Shfmu "Hamëz Thaçi" në Xërxë. Me vënien e gurthemelit, filloi puna në ndërtimin e objektit të ri të SHFMU " Hamëz Thaçi" në Xërxë.

- Është lidhur kontrata për projektin "Ndërtimi i aneksit të objektit të SHFMU "Katër Dëshmorët" në Ratkoc, projekt i cili gjithashtu ka filluar të zbatohet.

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, janë zhvilluar vizita sistematike shëndetësore tek nxënësit e klasave të para dhe të pesta të shkollave fillore.

- Ka përfunduar dhe është përuruar projekti i rregullimit të fushës sportive në oborrin e shkollës "12 Maji" në Ratkoc.
- Ka përfunduar furnizimi me inventar për objektin e ri të shkollës në Retijë.

- Më 19 nëntor u mbajt Gara Komunale e Olimpiadës Matematike.

- Në prag të festës së 28 Nëntorit, u bë përurimi i shkollës në Retijë, ndërsa në Shfmu "Katër Dëshmorët" përuruam fillimin e punimeve.

- Gjatë muajit dhjetor rregulluam edhe këndin e lodrave për fëmijë në oborrin e Çerdhes për Fëmijë "TULIPANËT" në qytet.

- U bë përurimi i objektit të Çerdhes për Fëmijë në Xërxë.

**Datë: 08.02.2023**

**Avni Morina, Drejtor i DKA-së**

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Rahovecit
Drejtoria për Arsim
RAHOVEC
IV
ORAHOVAC
Odeljenje za Obrazovanje
Opština Orahovac
REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti Ligjor / Pravnim Departmanom / Legal Department

13 - DL

| | |
|---|---|
| Për: | z. Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL<br>znj.Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL |
| Kopje: | z. Kryesuesi i KK- Rahovec<br>z.Kryetarit të Komunës - Rahovec |
| Përmes: | z. Hysen Durmishi , Zëvendësminstër Ministër i MMPHI<br>z. Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm |
| Nga: | Znj Florije Boshnjaku, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MMPHI 23.01.2023 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Ajshe Ejupi, Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, të mbështetjes ligjore dhe të bashkëpunimit institucional në fushën e legjislacionit |
| Lënda: | Raport i vlerësimit të ligjshmërisë të aktit të Komunës së Rahovecit |
| Lloji i aktit: | Vendimi Nr-406/22 për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027 |

I/e nderuari Minister,
E nderuara zv. Sekretare e Përgjithshme,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Nenin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave ka pranuar nga MAPL më datë 18.01.2023, aktin e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit kërkesën nr.020-16/1 të datës 11.01.2022 për shqyrtimin e ligjshmërisë të Vendimit Nr-406/22 për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin

dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, kërkon nga kuvendi i komunës së Rahovecit:

**Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit**

Vendimit Nr-406/22 për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027.

## Arsyetim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit Nr-406/1 për për miratimin e Planit te Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027 dhe përmbajtjes se Planit te Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027, ka konstatuar se në këtë dokument korniza ligjore e këtij dokumenti është bazuar ne legjislacionin e cili nuk është në fuqi (shih piken 1.4), andaj ju njoftojmë se

- Ligji nr.02/L-70 për Sigurinë në trafikun rrugor Ligji Nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor është i shfuqizuar pjesërisht me Ligji Nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi dhe Ligjin Nr.05/L-088 për Rregulla të Trafikut Rrugor , ndërsa në tërësi ky ligj është shfuqizuar me Ligjin Nr. 05/L-132 për Automjete i publikuar ne Gazetën Zyrtare nr.15 me datë 11 maj 2017 dhe
- Ligji nr.2004/1 për transport rrugor është i shfuqizuar me Ligjin ne 04/L-179 i publikuar ne Gazetën Zyrtare nr.21 datë 13 qershor 2013.
- Ligji Nr. 03/L- 160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja është i shfuqizuar me Ligjin nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.18 datë 13 korrik 2022.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Rahovecit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të komunës dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me ketë vlerësim.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Rahovecit



# Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027

# Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit

2022-2027

Nëntor, 2022

# *Falënderimet*

Ky plan është përgatitur nga grupi punues i Komunës së Rahovecit, bartëse e të cilës është Drejtoria për Shërbime Publike në mbështetje dhe bashkëpunim të ngushtë me grupin koordinues, konsulentët profesional dhe ekspert të fushave të ndryshme.

Grupi punues dhe koordinues për hartimin e planit të mobilitetit në komunën e Rahovecit, kanë bërë analizën e gjendjes në terren dhe kanë propozuar planin e mobilitetit me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe lëvizjes së lirë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

## *Grupi Punues:*

1. Përparim Krasniqi
2. Albnor Mullabazi
3. Sulejman Daka
4. Agim Hoti
5. Shpejtim Mustafa
6. Diellza Çanta
7. Haziz Krasniqi
8. Blerta Gashi
9. Ilir Haxhijaha
10. Masar Vuçiterna
11. Afrim Limani
12. Afrim Oruqi
13. Autoshkollat në komunen e Rahovecit
14. Stacioni Policor në Rahovec
15. OJQ-të në komunën e Rahovecit

## *Akronimet / Shkurtesat*

| | |
|---|---|
| **PMU** | Plani i Mobilitetit Urban |
| **PZhK** | Plani Zhvillimor Komunal |
| **PZhU** | Plani Zhvillimor Urban |
| **PRrU** | Plani Rregullues Urban |
| **VSM** | Vlerësimi Strategjik i Mjedisit |
| **KASH** | Korniza Afatmesme e Shpenzimeve |

# Tabela e përmbajtjes


**1. Hyrje .....9**

1.1. Fushëveprimi i planit ..... 9

1.2. Profili i komunës për nga perspektiva e mobilitetit ..... 9

1.3. Parimet bazë nga planet dhe dokumentat komunale dhe objektivat e përgjithshme të komunës .....11

1.4. Korniza ligjore .....11

**2. Gjendja ekzistuese .....13**

2.1. Siguria në trafik ..... 13

2.2. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal ..... 17

2.3. Trafiku për këmbësorë ..... 17

2.4. Trafiku për çiklistë ..... 18

2.5. Parkimi ..... 18

2.6. Transporti kolektiv (publiko - privat) ..... 19

2.7. Ngarkesa në trafik ..... 19

2.8. Lëvizja e personave me mobilitet të zvogëluar ..... 21

**3. Vizioni - Objektivat strategjike .....21**

**4. Plani i mobilitetit 2022-2027 .....25**

4.1. Rritja e sigurisë nëpër rrugët brenda qytetit ..... 25

4.2. Siguri në afërsi të shkollave ..... 26

4.3. Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar ..... 28

4.4. Përshtatja e infrastrukturës për biznese ..... 30

4.5. Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve ..... 31

4.6. Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal .....32

4.7. Ndërtimi i rrugëve tranzite .....32

4.8. Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale .....34

4.9. Ri-orientimi i qarkullimit në qytet .....34

**5. Plani i veprimit .....37**

**6. Vlerësimi strategjik në mjedis (VSM) .....40**

6.1. Përmbledhje e PM .....40

6.2. Referenca Ligjore e konsultuar për përcaktim .....41

6.3. Analiza krahasuese sipas kritereve të shtojcës 1 të ligjit për vsm nr. 03/L-230, si dhe aktiviteteve të PM të komunës së Rahovecit .....42

**7. Plani financiar .....44**

7.1. Hyrje .....44

7.2. Struktura e Buxhetit Komunal .....44

7.3. Plani Investiv .....47

7.4. Analiza buxhetore e kostove investive kapitale .....47

7.5. Nevoja për investime të reja ... 49
7.6. Vlerësimi i investimeve të reja në mobilitet ... 50
7.7. Planifikimi i rrjedhës së parasë për investimet në mobiliet ... 52
**8. Monitorimi dhe rishikimi ... 55**
8.1. Monitorimi i planit të mobilitetit urban për vitin 2022 ... 55
**Aneks I ... 56**
**Aneks II ... 57**

## Lista e tabelave

**Tabela 1: Struktura Buxhetore e Komunës (2022-2025) ... 44**
**Tabela 2: Investimet Kapitale (2022 - 2025) ... 45**
**Tabela 3: Pasqyra përmbledhëse e planit të mobilitetit për periudhën 2022-2027 ... 48**
**Tabela 4: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2027 ... 49**
**Tabela 5: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2027 ... 49**
**Tabela 6: Rrjedha e parasë e investimeve të planifikuara për periudhën 2022-2027-50**
**Tabela 7: Investimet e planifikuara në bazë të kategorive të investimeve për periudhën 2022-2027 ... 50**
**Tabela 8: Investimet e planifikuara në bazë të prioriteteve të vlerës mesatare për një projekt ... 51**
**Tabela 9: Investimet e planifikuara të bazuara në prioritet për periudhën 2022-2027 ... 51**
**Tabela 10: Burimet e financimit për periudhën e investimeve 2022-2027 ... 52**
**Tabela 11: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2027 rrjedha e parasë ... 53**
**Tabela 12: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2027 rrjedha e parasë ... 53**

## Lista e figurave


Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit .......... 10
Figura 2. Raporti mbi numrin e aksidenteve nëpër vite .......... 14
Figura 3. Rrethrrotullimi në hyrje të qytetit, rruga rajonale Xërxë – Malishevë .......... 14
Figura 4. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Xërxë .......... 15
Figura 5. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Krushë e Madhe.... 15
Figura 6. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Gjakovë - Prishtinë .......... 16
Figura 7. Kryqëzimi në rrugën rajonale Rahovec – Krushë e Madhe .......... 16
Figura 8. Shembuj të rrugëve me siguri të ulët për lëvizje të automjeteve dhe këmbësorëve .......... 16
Figura 9. Parkingjet ekzistuese në qytetin e Rahovecit .......... 18
Figura 10. Pikat karakteristike në të cilat janë bërë matjet e fluksit të qarkullimit .......... 19
Figura 11. Fluksi i automjeteve dhe këmbësorëve dhe struktura e qarkullimit .......... 20
Figura 12. Propozimi për kthim në rrugë njëkahore “Gëzim Hamza” .......... 25
Figura 13. Shembull se si do të zhvillohet qarkullimi pas kthimit në rrugë njëkahore .... 26
Figura 14. Parametrat e ndërtimit të ishullit për këmbësorë .......... 27
Figura 15. Zgjidhja ideore duke përdorur ishuj ndarës .......... 28
Figura 16. Lokacioni i propozuar për qetësimin e trafikut me ishuj ndarës në afërsi të një shkolle fillore .......... 28
Figura 17. Kriteret teknike për qasje në trotuare për personat me mobilitet të zvogëluar .......... 29
Figura 18. Një vendkalim i këmbësorëve ku duhet të sigurohet qasje .......... 29
Figura 19. Ideja për ndaljen e automjeteve me kohë të limituar në rrugën “Xhelal Hajda” .......... 30
Figura 20. Vendndaljet e propozuara në qendër të qytetit .......... 31
Figura 21. Vendndaljet e propozuara në dalje të qytetit .......... 31
Figura 22. Rruga tranzite në pjesën veriore .......... 33
Figura 23. Rrugët tranzite në pjesën Jug-lindore të qytetit .......... 33
Figura 24. Disa nga kryqëzimet e rrezikshme me rrugë magjistrale .......... 34
Figura 25. Qarkullimi njëkahorë në rrugët kryesore të qytetit .......... 35
Figura 26. Disa skenar të mundshëm për orientimin e qarkullimit njëkahorë në qytet.... 36
Grafiku 1: Struktura e të ardhurave komunale .......... 45
Grafiku 2: Struktura e të ardhurave komunale .......... 45
Grafiku 3: Investimet e planifikuar kapitale .......... 46
Grafiku 4: Trendi i të hyrave vetanake .......... 46
Grafiku 5: Paraqitja grafike e strukturës investimeve për periudhën planifikuese 2022-2027 .......... 49
Grafiku 6: Paraqitja grafike e strukturës së investimeve për periudhën planifikuese 2022-2027 .......... 50
Grafiku 7: Paraqitja grafike e burimeve të financimit .......... 52

# 1. HYRJE

## 1.1. Fushëveprimi i planit

Plani i mobilitetit është plan strategjik nga fusha e trafikut dhe ka për qëllim përmirësimin dhe harmonizimin e nevojave për lëvizje për të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Duke marrë parasysh rritjen e vrullshme të shkallës së motorizimit, infrastrukturën rrugore jo funksionale, sigurinë e pamjaftueshme për lëvizje të pamotorizuara dhe kushtet ambientale, atëherë zhvillimi i një plani të mobilitetit urban nuk mund të kuptohet vetëm si një objektiv i thjeshtë, por si prioritet.

Planet e mobilitetit mbështetën në planet aktuale të zhvillimeve komunale, mirëpo janë shumë më të detajuar dhe më specifike në fushën e trafikut dhe të transportit në përgjithësi.

Qëllimi i planit të mobilitetit urban është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të sistemit të transportit dhe lëvizjeve tjera (lëvizjeve të motorizuara dhe të pamotorizuara) me qëllim që të krijojnë:

- sigurimin e qasjes sa më të lehtë për lëvizjet ditore dhe shërbime tjera;
- përmirësimin e shkallës së sigurisë;
- zvogëlimin e ndotjes së ambientit;
- rritjen e efikasitetit dhe ekonomicitetit gjatë transportit të njerëzve dhe të mallrave;
- rritjen e atraktivitetit dhe kualitetin e mjedisit urban.

Përfshirja e qytetarëve dhe pjesëmarrësve tjerë në hartimin e planit të mobilitetit është ndër principet themelore. Përfshirja dhe mendimet e tyre janë kontribut i rëndësishëm, sepse ndërlidhet me nevojat e biznesit, organizimin dhe dinamikën e qytetit si dhe me kualitetin e jetesës.

Me hartimin e planit të mobilitetit, Komuna e Rahovecit tenton të jetë një komunë funksionale dhe e integruar, duke akomoduar të gjithë pjesëmarrësit në trafik dhe krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara.

## 1.2. Profili i komunës për nga perspektiva e mobilitetit

### Popullsia

Numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Rahovecit bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 është 56,208 banorë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15,892 banorë që do të thotë se rreth 28 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40,316 banorë apo rreth 72 %.

## Pozita gjeografike

Territori i Komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.5 km², që shtrihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në Veri-Lindje me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në Jug-Lindje me Komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në Jug me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në Perëndim me Komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km. Ekziston lidhje të mira komunikative në mes komunave dhe në Lindje të komunës kalon magjistralja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren–Pejë.

Territori i komunës shtrihet në hemisferën në mes shkallës 42° e 30' dhe 42° e 50' të gjerësisë gjeografike veriore dhe ndërmjet 20° e 21' dhe 20° e 55' të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimet në Komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krushë e Madhe deri në 920 m lartësi mbidetare Zatriqi.




Figura 1. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit

Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshinore, kodrinore dhe malore.

## 1.3. Parimet bazë nga planet dhe dokumentat komunale dhe objektivat e përgjithshme të komunës

Komuna e Rahovecit eshte ne perfundim të miratimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), si dhe është në proces të hartimit të Planit Rregullues Urban (PRrU) për "Qendrën e Vjetër të Qytetit". Në këtë dokument është trajtuar problemi i komunikacionit dhe mobiliteti në përgjithësi, pastaj është bërë planifikimi i rrugëve, trotuareve dhe për llojet e ndryshme të transportit. Në kuadër të këtyre planeve janë trajtuar edhe vendndaljet e autobusëve dhe parkingjet për lokalitete të ndryshme. Në vijim janë paraqitur disa nga objektivat komunale të cilat janë paraparë në kuadër të këtyre planeve të cilat e trajtojnë hapësirën në përgjithësi:

### Strategjia e zhvillimit të infrastrukturës sipas PZHK-së

Synimi 1. Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët:

- Asfaltimi i rrugëve që lidhin vendbanimet, asfaltimi i rrugëve lokale;
- Mirëmbajtjen e rrugëve lokale;
- Përfundimi i Rrugës Unazore (Tranzite) mbi Rahovec;
- Rregullimi i anësoreve mbrojtëse;
- Rregullimi i sinjalizimit për vendkalim këmbësorësh në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara sidomos në qendrat sekondare;
- Rregullimin e trotuareve në vendbanimet;
- Rregullimin e sinjalizimit për vijën hekurudhore, në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara;
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në Rahovec dhe qendrat sekondare.

## 1.4. Korniza ligjore

Plani i mobilitetit urban për Komunën e Rahovecit, është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Rahovecit, për lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, për përmirësimin e kualitetit të jetës, krijimin e ambientit të pastër dhe të shëndoshë mjedisor dhe social.

Plani i mobilitetit urban për komunën e Rahovecit bazohet në kornizën ligjore në fuqi në Kosovë, si dhe parimet dhe konventat ndërkombëtare të cilat janë të ndërlidhura me mobilitetin e qëndrueshëm urban, si:

- Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, I ndrshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-069;
- Ligji Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-070;
- Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-120 dhe Ligjin Nr. 06/L-068;
- Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale;

- Ligj Nr. 04/L-076 për Policinë;
- Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.

Siguria në trafik është e rregulluar me Ligjin Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, I ndrshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-069. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve në sistemin e komunikacionit rrugor.

Përpos ligjit për sigurinë në komunikacion, me çështje të sigurisë në trafik merret edhe Ligji për Policisë, i miratuar në vitin 2012. Nga ana tjetër, edhe Ligji për vetëqeverisje lokale, Regullorja për shërbime komunale, si dhe aktet tjera nënligjore të komunave të Kosovës trajtojnë fushën e sigurisë së trafik duke kompletuar bazën ligjore në këtë fushë.

Ligji për planifikim hapësinor, ka për qëllim rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban. Në kuadër të këtij ligji, planifikimi hapësinor duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të Kosovës dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm, po ashtu duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitete.

Sipas Ligjit për planifikim hapësinor, parashikohet që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke e themeluar komisionin e ekspertëve të planifikimit (në nivelin lokal). Në Kosovë ekzistojnë dy nivele të planifikimit (kombëtare dhe lokale) dhe llojet e planeve janë: Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Posaçme, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Planet për Zhvillim Urban, Planet Rregulluese Urbane.

Ligji për mbrojtjen e mjedisit, cakton shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar, përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Ligji për vetëqeverisjen lokale përshkruan bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse.

Në kuadër të Ligjit për vetëqeverisje lokale, janë caktuar të drejtat në nivel lokal, si e drejta për:

- zhvillimin lokal ekonomik;
- planifikimin urban dhe rural;
- shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal; janë kompetencat vetanake, të plota dhe eksluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, këto kompetenca janë përcaktuar me nenin 17 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

# 2. GJENDJA EKZISTUESE

Komuna e Rahovecit shtrihet në mesin e rrugëve magjistrale Gjakovë-Prishtinë dhe Gjakovë–Prizren, si dhe atyre rajonale Malishevë–Gjakovë, dhe Rahovec–Suharekë. Territori i komunës është relativisht i madh i cili ka një rrjet rrugor prej 297 km rrugë të të gjitha kategorive. Rrugët magjistrale dhe rajonale janë të asfaltuara dhe në gjendje të mirë ka edhe prej atyre rrugeve brenda qytetit që janë pa asfaltuara, sidomos ne lagjet periferike. Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm në rrugët periferike të komunës, ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit ka pak vështirësi në zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve, kjo bëhet edhe më vështirë kur kemi parasysh praninë e madhe të motokultivatorëve. Konfiguracioni i terrenit është kodrinor, ku karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj kemi edhe rrugët shumë të ngushta të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik. Shumica e këtyre rrugëve janë të asfaltuara, mirëpo nuk kanë trotuare për lëvizjen e këmbësorëve. Për nga aspekti i mobilitetit rrugët në këto lagje mund të cilësohen si të rrezikshme duke mos ofruar siguri të mjaftueshme të gjithë pjesëmarrësve në trafik.

Komuna përveç trafikut rrugor ka edhe atë hekurudhor e cila e lidh Prishtinën – Shkupin, mirëpo aktualisht kjo linjë është jashtë funksionit.

## 2.1. Siguria në trafik

Siguria në komunën e Rahovecit përkatësisht në zonën urbane sipas konceptit të mobilitetit mund të llogaritet e nivelit të ulët. Kjo për faktin se ka një infrastrukturë rrugore adekuate për automjete, ndërsa jo në nivel të duhur për lëvizje të mjeteve të pa motorizuara si për këmbësorë ashtu edhe për çiklistë. Zona urbane karakterizohet me mungesë të trotuareve për këmbësorë, për shkak se nuk ka pasur mundësi të ndërtimit të tyre. Në këto lagje rrugët janë shumë të ngushta në shumicën prej tyre zhvillohet trafiku në dy kahje dhe e bën shumë të vështirë dhe të rrezikshme lëvizjen e këmbësorëve. Këto rrugë shfrytëzohen shumë sidomos nga nxënësit për të shkuar në shkollë, sepse lëvizja në këmbë është e vetmja mënyrë e lëvizjes për këto nevoja ditore, pasi që transport urban nuk ka të organizuar brenda qytetit.

Problem tjetër i sigurisë ka të bëjë edhe me mos rregullimin adekuat të disa kryqëzimeve sidomos atyre që janë të lidhura me rrugët rajonale dhe magjistrale, të cilat kalojnë nëpër komunën e Rahovecit. Edhe sipas raporteve policore mbi numrin e aksidenteve është një numër relativisht i madh, ku shumica e tyre ndodhin pikërisht në këto kryqëzime me rrugët magjistrale dhe rajonale. Në vazhdim do t'i japim disa nga pikat më të rrezikshme të cilat nuk i plotësojnë kriteret teknike gjeometrike për funksionimin e tyre.




*Figura 2. Raporti mbi numrin e aksidenteve nëpër vite*




*Figura 3. Rrethrrotullimi në hyrje të qytetit, rruga rajonale Xërxë – Malishevë*

Qëllimi i projektimit të rrethrrotullimeve është që në hyrje të udhëkryqit të detyrojë automjetet ta zvogëlojnë shpejtësinë në mënyrë që të rritet siguria, në këtë udhëkryq me këto parametra gjeometrik kjo gjë nuk ka ndodhur për faktin se mjetet që lëvizin në drejtimin Malishevë – Xërxë i mundësohet e drejta e kalimit krahasuar me ata të cilët është dashur të kenë të drejtë përkatësisht mjetet që lëvizin në rrethrrotullim, dhe pikërisht është kjo edhe arsyeja se pse ndodhin aksidente në këtë udhëkryq, gjithashtu edhe kyçja nga qyteti nuk është projektuar si duhet sepse nuk ka dukshmëri të mjaftueshme.







*Figura 4. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Xërxë*

Ky është njëri ndër udhëkryqet më të rrezikshme në komunën e Rahovecit, sepse në këtë kryqëzim kemi edhe kalimin e hekurudhës. Dihet se një pjesë e madhe e fshatit Xërxë shtrihet në pjesën e poshtme të këtij kryqëzimi, ndërsa në afërsi të tij gjendet shkolla fillore, pikërisht në këto pika gjatë vitit shkollor bëhet edhe më e rrezikshme sepse kërkesa për të kaluar nga njëra anë në tjetrën është shumë e madhe.





*Figura 5. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Krushë e Madhe*




*Figura 6. Kryqëzimi në rrugën magjistrale Gjakovë - Prishtinë*

Disa rrugë të lagjeve që janë të rrezikshme për zhvillimin e komunikacionit të automjeteve dhe të këmbësorëve.



*Figura 8. Shembuj të rrugëve me siguri të ulët për lëvizje të automjeteve dhe këmbësorëve*








*Vendet ku janë paraparë të ndërtohen rreth rrotullimet;*

- *Rruga rajonale Xerxe-Kramavik*
- *Rruga rajonale Rahovec-Malishevë*
- *Rruga rajonale Rahovec-Suharekë*

## 2.2. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal

Të gjitha mangësitë e përmendura më lartë për nga aspekti i sigurisë janë të lidhura drejtpërsëdrejt edhe me mungesën e sinjalizimit adekuat, niveli i sinjalizimit si atij horizontal po ashtu edhe atij vertikal nuk është në nivelin e duhur ne rruge rajonale, e bëhet edhe më e rëndë kur dihet se në vitet e fundit nuk ka pasur kompani të kontraktuar për mirëmbajtjen e tij.

Në zonën urbane kemi sinjalizim adekuat sidomos në pjesët e qytetit ku janë ndërtuar rrugët e reja, ndërsa në ato rurale ka vetem ne rruget kryesore. Në zonat rurale ka vetëm disa shenja vertikale STOP, të cilat janë vendosur në kryqëzime me rrugët kryesore, kurse sinjalizim horizontal nuk ka fare ne rruge sekondare, është bërë vetëm njëherë kur është ndërtuar rruga pastaj nuk është mirëmbajtur fare, apo nuk është përsëritur më.

## 2.3. Trafiku për këmbësorë

Shtigjet e këmbësorëve janë pothuajse pjesa më e rëndësishme e infrastrukturës sidomos për zonat urbane, kur dihet që shumica e lëvizjeve ditore bëhet në këmbë, mirëpo pa i anashkaluar edhe nevojën për rrugët që i lidhin fshatrat. Në komunën e Rahovecit nuk është gjendja e mirë me trotuare, apo thënë më mirë lëvizja në këmbë nuk është e sigurt në këtë qytet. Qyteti ka një terren kodrinor me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve që karakterizohen me rrugë të ngushta të cilat janë të asfaltuara në tërësi, ndërsa nuk ka fare trotuare për lëvizjen e këmbësorëve. Sidomos gjatë periudhës së dimrit kemi një gjendje shumë të rrezikshme për lëvizje të këmbësorëve duke pasur parasysh edhe pjerrtësitë në këto rrugë. Në përgjithësi përveç disa rrugëve kryesore në qendrën e qytetit që kanë trotuare, shumica e lagjeve tjera nuk kanë fare. Këtu duhet të përmendim edhe rrugën që qon në drejtimin e shkollës së mesme “Xhelal Hajda” rrugë e cila është shumë e frekuentuar nga nxënësit nuk ka një infrastrukturë adekuate për lëvizje të këmbësorëve. Në përgjithësi mund të themi se gjendja me trotuare nuk është në nivelin e duhur si për nga mungesa ashtu edhe mirëmbajtja e duhur. Në PZHK është paraparë që të ndërtohen disa trotuare këto sidomos në rrugë që i lidhin fshatrat sepse edhe në këto raste nuk kemi hapësira për lëvizje të sigurtë të këmbësorëve, sidomos në rrugët rajonale kur dihet se mjetet këtu mund të lëvizin me një shpejtësi më të madhe.

Të dhëna të detajuara në lidhje me gjatësinë e trotuareve gjenden në aneks.

## 2.4. Trafiku për çiklistë

Në qytetin e Rahovecit kemi disa shtigje për çiklistë deri më tani, edhe pse në PZHK është përmendur që janë të nevojshme këto shtigje mirëpo, duke e marrë parasysh gjendjen e terrenit dhe hapësirat në dispozicion për krijimin e shtigjeve është shumë e vështirë që të krijohen. Në të ardhmen nëse qyteti vazhdon të rritet në pjesën e rrafshët është mirë që të parashihen, dhe të inkorporohet edhe kjo formë e transportit. Kemi shtegun ne rrugen Ibrahim Rugova me gjatesi 609 metra,kemi krijuar pergjate rruges Rahovec –Hamoc-Fortes ne segmetin e kesa rruge eshte vendos shtegu per cikliste.

## 2.5. Parkimi

Qyteti i Rahovecit ka shumë pak hapësira publike apo private të cilat mund të shfrytëzohen për parkingje. Në zonën qendër nuk ka hapësira as mundësi për krijimin e parkingjeve, kjo njëherit është edhe një shqetësim sepse është një hapësirë shumë e vogël tek shtepia e Kultures në qendër të cilin qytetarët e shfrytëzojnë për parking, i cili e pengon rrjedhën e qarkullimit. Ekzistojnë edhe disa parkingje në pjesën e poshtme të qytetit afër tregut i cili mund të shfrytëzohet mirëpo, përveç ditëve të tregut shumë pak shfrytëzohet në ditët tjera.




*Figura 9. Parkingjet ekzistuese në qytetin e Rahovecit*

## 2.6. Transporti kolektiv (publiko - privat)

Trafiku urban në komunën e Rahovecit përkatësisht në zonën urbane nuk ekziston. Ka të organizuar trafikun urbano – periferik dhe atë ndër urban. Të gjitha itineraret janë të caktuara nga disa rregullore të nxjerra nga Kuvendi Komunal, mirëpo këto janë shumë të vjetra sepse janë nxjerr në vitin 2001 dhe janë të bazuara në ligjin e vjetër të transportit. Kjo mund të cilësohet edhe një e metë dhe duhet të rishikohet kjo rregullore me qëllim që të përshtatet me ligji e ri që është në fuqi. Transporti urbano – periferik organizohet me autobus nga kompanitë private, ku gjendja e mjeteve në disa raste nuk është në nivelin e duhur, linjat kryesisht shfrytëzohen për transportin e nxënësve. Ndërsa sa i përket linjave ndërurbane ka një qasje të mirë dhe shpeshtësia e tyre është në nivelin e duhur. Komuna ka stacion të autobusëve që me rregullore është paraparë që të gjitha linjat duhet të nisen dhe të përfundojnë në këtë stacion. Mirëpo, një shqetësim tjetër është se operatorët e autobusëve nuk e respektojnë dhe ndalen edhe në pjesët tjera të qytetit, si për zbritjen e udhëtareve ashtu edhe për marrjen e tyre. Kjo ndodh sidomos në zonat atraktive në qendër apo në afërsi të shkollave. Aktualisht ka disa vendndalje të shënuar për autobusë brenda qytetit, mirëpo në vijmë duhet që ta analizojmë nëse është e nevojshme që të vendoset dhe të krijohet një infrastrukturë adekuate.

## 2.7. Ngarkesa në trafik

Për nevoja praktike janë të rëndësisë së veçantë karakteristikat e jolinearitetit kohorë të qarkullimit të automjeteve në periudha të ndryshme kohore. Periudha dhe zgjatja e numërimit varet nga qëllimet dhe mënyra e planifikimit. Për nevoja të planit matjet e fluksit të trafikut janë bërë vetëm për një orë në pika karakteristike të hyrjeve të qytetit.

Përpos automjeteve motorike, me qëllim të caktimit të strukturës së qarkullimit, janë bërë edhe mat-jet e numrit të këmbësorëve dhe biçikletave të cilat qarkullojnë brenda orës.




*Figura 10. Pikat karakteristike në të cilat janë bërë matjet e fluksit të qarkullimit*

Të dhënat për qarkullimin e mjeteve dhe strukturën e qarkullimit në udhëkryqin U1 tek Semaforët janë dhënë në fig. 11.










*Figura 11. Fluksi i automjeteve dhe këmbësorëve dhe struktura e qarkullimit*

Për nga struktura e qarkullimit shihet se në kohën kur janë realizuar matjet e fluksit dominojnë mjetet motorike krahasuar me këmbësorët, për nga numri i shfrytëzuesve mund të konstatojmë se ky udhëkryq ka kapacitet rezervë për përballimin e një fluksi më të madh të automjeteve dhe këmbësorëve gjithashtu.

## 2.8. Lëvizja e personave me mobilitet të zvogëluar

Komuna e Rahovecit përkatësisht zona urbane ka bere nje infrastrukturë adekuate e cila do t'i mundësonte personave me mobilitet të zvogëluar një qasje të lehtë dhe një lëvizje të lirë. Rrugët janë shumë të ngushta në disa pjesë të qytetit kanë të pamundur të krijohen hapësira për lëvizje të lirë të kësaj kategorie. Mirëpo, edhe pjesët e qytetit ku ka trotuare, përkatë-sisht jane vendosur pjerrinat e duhura për t'u qasur më lehtë në to.

# 3. VIZIONI - OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Qyteti i Rahovecit i cili konsiderohet me dendësi të madhe në zonën qendër, me një konfiguracion kodrinor të terrenit, me rrugë shumë të ngushta si rezultat i një plani kaotik të ndërtimit të shtëpive individuale e bënë që lëvizshmëria në qytet të jetë e vështirë dhe e pa sigurtë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

Gjatë analizës në kapitullin e mësipërm del të jetë se siguria e lëvizjes në qytet është në nivel jo të mirë, sidomos për lëvizjet në këmbë, kjo për faktin se kemi një qarkullim dy kahor të automjeteve në rrugë shumë të ngushta ku madje shumica prej tyre nuk kanë trotuare për lëvizje të sigurt të këmbësorëve.

Aktualisht trafiku për mjete të motorizuara është i orientuar në rrugën kryesore të qytetit, kjo për shkak se nuk ka ndonjë rrugë alternative e cila i plotëson kriteret që të përdoret si rrugë tranzite për mjete të rënda, pak në këtë aspekt mbetemi të hendikepuar për të ofruar zgjidhje për një periudhë afatshkurtër, qoftë për nga aspekti i sigurisë apo i ri-orientimit të qarkullimit, kjo për faktin se kërkohen investime pak më të mëdha si për nga aspekti kohor ashtu edhe ai financiar.

Nëse i referohemi Planit Hapësinor të Kosovës, Rahoveci bënë pjesë në "zonën e verdhë" të ashtuquajtur, duke e konsideruar si vendbanim urë lidhës me mes të komunave tjera, me një pemëtari dhe vreshtari të zhvilluar. Për ta arsyetuar këtë epitet kryefjala bie të jetë organizimi i trafikut dhe transportit si në nivelin komunal ashtu edhe në atë lokal në qendër të qytetit. Ndërsa, nëse i referohemi PZHK, planeve rregullative e kemi po të njëjtin vizion ku thuhet që:

> *"Komunë me sistem të avancuar administrativ, trende pozitive në punësim dhe zvogëlim të varfërisë, duke e avancuar sistemin arsimor dhe shëndetësor, zhvillim të vendbanimeve me plan, zhvillim të qëndrueshëm mjedisor duke mbrojtur edhe vlerat e trashëgimisë kulturore, me ekonomi stabile duke avancuar vreshtarinë dhe perimtarinë, infrastrukturë të planifikuar e bashkëkohore".*

- Për t'i plotësuar apo për t'i arritur këto vizione për nga aspekti i mobilitetit na duhet që të kemi një qytet:
- Me qasje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik,
- Infrastrukturë adekuate për të gjitha format e lëvizjes.

Vizioni i qytetit në aspektin e mobilitetit është ndërtuar në këto katër elemente:

- Kapaciteti,
- Arritshmëria (qasshmëria),
- Atraktiviteti,
- Qëndrueshmëria.

| **Kapaciteti** | **Arritshmëria (qasshmëria)** |
|---|---|
| • Kapaciteti i rrjetit rrugor<br>• Kapaciteti i transportit publik<br>• Rrjeti i çiklizmit<br>• Bizneset | • Koha e udhëtimit<br>• Shpejtësia e lëvizjes<br>• Parkingjet<br>• Kënaqshmëria e shfrytëzuesve të rrjetit rrugor |
| **Atraktiviteti** | **Qëndrueshmëria** |
| • Ecja<br>• Hapësira publike | • Siguria rrugore<br>• Qëndrueshmeria e rrjetit rrugor<br>• Përdorimi i mjeteve alternative të lëvizjes |

Nga analiza e gjendjes ekzistuese ashtu edhe nga vizioni për zhvillimin e qytetit objektivat i kemi ndarë në dy periudha:

1. **Objektiva afatshkurtra 0-1 vit dhe**
2. **Objektiva afatmesme 0-5 vite.**

**1. Objektiva afatshkurtra 0-1 vit:**

- Rritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit,
- Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar,
- Përshtatja e infrastrukturës për biznese,
- Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve,
- Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal,
- Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve.

**2. Objektiva afatmesme 0-5 vite:**

- Ndërtimi i rrugëve tranzite,
- Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale,
- Ri-projektimi dhe rindërtimi i udhëkryqeve të rrezikshme,
- Ri-orientimi i qarkullimit në qytet.

### O 1.1. Rritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit

Ashtu siç e kemi potencuar edhe më herët qyteti i Rahovecit ka mungesë të trotuareve për lëvizje të sigurtë të këmbësorëve, nuk janë marrë masa adekuate për ta rritur sigurinë në afërsi të shkollave, ekzistojnë disa udhëkryqe që nuk i plotësojnë kriteret për një lëvizje të sigurt në to. Për këtë arsye janë propozuar disa skenarë për të rritur nivelin e sigurisë në disa pjesë të qytetit.

### O 1.2. Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar

Disa rrugë të qytetit kanë trotuare për lëvizjen e mjeteve të pa motorizuara mirëpo, qasja e njerëzve me mobilitet të zvogëluar nuk është e mundshme, kjo për faktin se pikërisht në vendkalime të këmbësorëve nuk janë respektuar kriteret teknike për rampa (lëshesa), të cilat do ta mundësojnë një qasje më të lehtë. Ky objektiv është shumë lehtë i realizueshëm dhe nuk kërkon ndonjë investim të madh, andaj edhe mendohet që të kryhet brenda grupit të parë të objektivave.

### O 1.3. Përshtatja e infrastrukturës për biznese

Rruga kryesore e qytetit "Xhelal Hajda", është rruga në cilën janë të shtrira të gjitha bizneset në qytetin e Rahovecit, aktualisht në këtë rrugë trafiku zhvillohet në dy kahe ku gjerësia e rrugës është 7m. Në trotuare përgjatë gjithë rrugës janë të vendosura pengesa fizike anti park, mirëpo edhe skajoret e rrugës janë shumë të larta, për momentin është e pamundur që të ndalen automjetet për të kryer ndonjë shërbim apo lokalet të bëjnë furnizimet e tyre. Për këtë arsye ne kemi menduar të krijojmë një hapësirë legale për ndalje e cila nuk do ta kishte penguar rrjedhën e qarkullimit, kjo hapësirë është menduar që të krijohet në mes të dy drunjëve dekorativ, ku ekziston një distancë prej 10m.

### O 1.4. Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve

Brenda qytetit të Rahovecit nuk ka vendndalje legale të autobusëve, pra me këtë nënkuptojmë që të gjitha udhëtimet, zbritjet bëhen nga stacioni i autobusëve, edhe pse kjo çështje është rregulluar me rregullore mbi linjat e transportit nuk respektohet, pothuajse të gjithë operatorët e linjave transportuese bëjnë marrjen dhe zbritjen e udhëtareve në pika të ndryshime të qytetit. Për këtë arsye është menduar që të bëhen disa vendndalje përveç stacionit të autobusëve, kjo për faktin që të legalizohet një pikë e vetme e destinuar për këtë çështje, jo të shfrytëzohet apo të keqpërdoret rruga për ndalje sipas dëshirës së udhëtarëve.

## Objektiva afatmesme 0 – 5 vite

### O 2.1. Ndërtimi i rrugëve tranzite

Rruga kryesore e qytetit njëherit është e rruga në të cilën detyrimisht kalojnë të gjitha mjetet, duke i përfshirë edhe ato të rëndat, kjo për faktin se nuk ka rrugë alternative për ta ri-orientuar qarkullimin. Në këtë periudhë afatmesme mendohet që të ndërtohet rruga tranzite në pjesën veriore të qytetit rrugë e cila tashmë është edhe e trasuar. Me ndërtimin e kësaj rrugë do kemi mundësinë që mjeteve të rënda t'ja kufizojmë lëvizjet në qendër të qytetit, me këtë kufizim automatikisht do të ndikojmë në rritjen e sigurisë së pjesëmarrësve tjerë brenda zonës së qytetit, në të njëjtën kohë do të na jepen edhe mundësi që në periudhat afatmesme të bëhet edhe një ri-organizim i brendshëm i rrugëve.

### O 2.2. Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale

Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese kemi ardhur në përfundim se kemi një numër të konsiderueshme të udhëkryqëve që mund t'i konsiderojmë me rrezikshmëri të lartë, kjo për faktin se ka ndodhur një numër i konsiderueshëm i aksidentëve. Këtu bëjnë pjesë disa kryqëzime me rrugë magjistrale siç janë në fshatin Xërxë, fshatin Krushë e Madhe, rrethrrotullimi në hyrje të qytetit. Të gjitha këto pika duhet të ri-projektohen apo të vendosen masa dhe mënyra të tjera të qarkullimit.

### O 2.3. Ri-projektimi dhe rindërtimi i udhëkryqëve të rrezikshme

### O 2.4. Ri-orientimi i qarkullimit në qytet

Me ndërtimin e këtyre rrugëve tranzite mundësohet edhe rregullimi apo ri-orientimi i brendshëm i rrugëve, aktualisht kërkesa për lëvizje nuk është shumë e madhe dhe kapaciteti i rrugëve është në nivel të kënaqshëm, mirëpo për një periudhë afatmesme kërkesa për lëvizje mund të rritet, ndërsa është e pamundur zgjerimi i rrjetit rrugor në qendër të qytetit. Për këtë arsye është e nevojshme që të bëhet kahëzimi i trafikut përmes rrugëve njëkahore.

# 4. PLANI I MOBILITETIT 2022-2027

## 4.1. Rritja e sigurisë nëpër rrugët brenda qytetit

Organizimi i rrugëve njëkahore për disa lagje të thella të qytetit, kjo është bërë sidomos për rrugët të cilat nuk kanë trotuare dhe nuk ka mundësi të ndërtohen trotuare, me orientimin njëkahorë është e mundshme që të krijohet një hapësirë e ndarë për lëvizje të këmbësorëve.

Në figurën e mëposhtme është marr një shembull model se si mund të rezervohet një hapësirë e destinuar për këmbësorë, brenda sipërfaqes së përbashkët për lëvizje.

Shumica rrugëve brenda qytetit janë shumë të ngushta dhe trafiku në to zhvillohet në të dy drejtimet, me kthimin e tyre në rrugë njëkahore si në figurën e mëposhtme krijohet një hapësirë e cila mund të shënohet për lëvizje të këmbësorëve p.sh në një rrugë gjerësia është 4.5m, 3m mund të ndahen për lëvizje të mjeteve në një drejtim ndërsa 1.5m mund të ndahen për lëvizje të sigurtë të këmbësorëve.



*Figura 12. Propozimi për kthim në rrugë njëkahore "Gëzim Hamza"*



*Figura 13. Shembull se si do të zhvillohet qarkullimi pas kthimit në rrugë njëkahore*

## 4.2. Siguri në afërsi të shkollave

Për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave janë propozuar disa modele apo praktika për qetësimin e trafikut si:

- Pengesat në rrugë (të vendosura sipas kritereve dhe standardeve teknike);
- Ngushtimi i shiritave të lëvizjes me qëllim të zvogëlimit të shpejtësisë;
- Vendosja e sinjalistikës adekuate, në përshtatje me kushtet e lëvizjes në afërsi të shkollave;
- Ndriçimi i vendkalimeve për këmbësorë.

### 4.2.1. Masat e propozuara për kontrollimin e trafikut

Edhe nëse ndonjëherë duken si tërësi e veçantë, udhëheqja e trafikut dhe qetësimi i tij paraqesin mjete të ndryshme dhe kanë të bëjnë me probleme të ndryshme. Udhëheqja e trafikut përfshinë masa të ndryshme për kontrollimin e trafikut me qëllim të udhëheqjes së lëvizjes dhe rritjen e sigurisë për këmbësorë.

**Me rastin e përzgjedhjes së masave për qetësimin e trafikut, janë marrë parasysh tre kritere themelore:**

- funksioni dhe karakteri i rrugës;
- kushtet e qarkullimit dhe
- kriteret shtesë (lokacioni i pjesës së rrugës, struktura e qarkullimit etj).

Mbi bazën e analizave të bëra në rrjetin rrugor të komunës së Rahovecit, janë identifikuar pika të rrezikut në pjesët e rrugëve rajonale dhe atyre lokale.

Krahas karakterit të rrugëve, janë konstatuar masat adekuate për përmirësimin e gjendjes së sigurisë, veçanërisht në pjesët e rrugëve në afërsi të shkollave, dhe në vazhdim do të propozohen rekomandimet si në vijim:

**Për rrugët rajonale:**

- Masat e qetësimit të trafikut, me aplikimin e ishujve ndarës përgjatë rrugës në të dy anët e vendkalimit për këmbësorë;
- Vendosja e sinjalizimit adekuat horizontal dhe vertikal, me qëllim të paralajmërimit të afërsisë së zonës së shkollës.

**Zgjidhja teknike bazohet në:**

- Ndërtimin e ishullit qendror në rrugën kryesore në të dy anët e vendkalimit për këmbësorë, secili me gjatësi 10m – 15m, dhe me gjerësi nga 1,5 – 2,0m, ndërsa lartësia e skajorit të ishullit h = 12 cm (Fig.14). Kjo zgjidhje parashihet për pjesët e rrugës në të cilat shpejtësia është e kufizuar nga 40-50 km/h, e cila i përgjigjet edhe shpejtësisë së kufizuar në zonat e banuara.




*Figura 14. Parametrat e ndërtimit të ishullit për këmbësorë*

Përdorimi i gungave ose platformave të ngritura në rrugë për qetësimin e trafikut, nuk preferohen për rrugë magjistrale dhe rajonale. Prandaj, me rastin e aplikimit të masave për qetësimin e trafikut në komunën e Rahovecit, të vlerësohet se në cilat pjesë të rrugëve rajonale mund të përdoret modeli me ishull ndarës në vendkalim për këmbësorë.

Në vijim është dhënë një zgjidhje ideore për një shkollë në qendër të qytetit duke përdorur ishuj ndarës, për kahëzimin e trafikut, këto janë metoda standarde të cilat përdoren për këto raste. Eshtë menduar që rruga të mbetet njëkahore për qarkullim, duke e ngushtuar apo zvogëluar gjerësinë e vendkalimit të këmbësorëve, ky ngushtim drejtpërsedrejt do të ndikojë në rritjen e sigurisë për faktin se rruga dhe koha e kalimit në vendkalim të këmbësorëve eshtë më e shkurtë, dhe njëherit i detyron që ngasësit ta zvogëlojnë shpejtësinë në afërsi të vendkalimit.




*Figura 15. Zgjidhja ideore duke përdorur ishuj ndarës*




*Figura 16. Lokacioni i propozuar për qetësimin e trafikut me ishuj ndarës në afërsi të një shkolle fillore*

## 4.3. Qasja për njerëz me mobilitet të zvogëluar

Sipas Ligjit për Ndërtime (LN) Nr. 04/L-110, komunat janë përgjegjëse për implementimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative lidhur me përshtatshmërinë e infrastrukturës për persona me mobilitet të zvogëluar (aftësi të kufizuara). Ato gjithashtu janë përgjegjëse për zhvillimin e PKO (Planin Operativ Kombëtar) për implementimin e SKPAK (Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara), që do të aprovohet në Kuvendin Komunal.

Sipas planit të veprimit për zbatimin e strategjisë kombëtare për persona me aftësi të kufizuara, komunat duhet të ndërmarrin aktivitete të caktuara që ndërlidhen me objektivin e pestë të strategjisë.

Qyteti i Rahovecit karakterizohet me trotuare të mangëta dhe të ngushta, mirëpo edhe në ato segmente ku ka trotuare nuk janë respektuar kriteret për qasje të njerëzve me mobilitet të zvogëluar, për ta arritur këtë më poshtë janë dhënë kriteret për realizimin e këtyre rampave për qasje në trotuare.




*Figura 17. Kriteret teknike për qasje në trotuare për personat me mobilitet të zvogëluar*



*Figura 18. Një vendkalim i këmbësorëve ku duhet të sigurohet qasje*

Përgjatë rrugës kryesore të qytetit janë trotuare në të dy anët mirëpo nuk janë të ekzekutuara lëshesat për qasje të njerëzve me mobilitet të zvogëluar, andaj për të mundësuar qasjen e lehtë nevojitet që në të gjitha vendkalimet e këmbësorëve të implementohen këto rampa sipas kritereve teknike standarde.

## 4.4. Përshtatja e infrastrukturës për biznese

Rruga kryesore e qytetit “Xhelal Hajda”, është rrugë me dy shirita për lëvizje në të dy kahjet. Para disa viteve rruga ka qenë njëkahore, një shirit për lëvizje një për parking të mjeteve, mirëpo pas analizave të bëra nga zyrtarët komunal kanë ardhur në përfundim se rruga përsëri duhet të kthehet në dykahore, dhe njëherit ka qenë edhe kërkesë e bizneseve të shtrira përgjatë rrugës të cilat e zhvillojnë aktivitetin e tyre të përditshëm, të cilët kanë nevojë për furnizime ditore.

Pasi që trupi i rrugës i ka 7m gjerësi me nga 3.5m për secilin shirit, është e mjaftueshme për t’u ndalur mjeti nëse merren edhe 80cm nga hapësira në mes të drunjëve. Në figurën e mëposhtme është dhënë në mënyrë të detajuar ideja për ndaljen e automjeteve me kohë të limituar, për shërbime të shkurtra në lokalet përgjatë rrugës.



*Figura 19. Ideja për ndaljen e automjeteve me kohë të limituar në rrugën “Xhelal Hajda”*

Në këtë mënyrë do të krijohej një hapësirë për ndaljen e mjeteve pa e penguar qarkullimin e tyre në rrugën kryesore, duke e marrur një hapësirë të pa shfrytëzuar në mes të drunjëve. Ky intervenim shihet të jetë i nevojshëm që të krijohet një infrastrukturë më e mirë për biznese dhe të mos pengohet rrjedha normale e qarkullimit.

## 4.5. Rregullimi i vendndaljeve të autobusëve

Të gjitha nisjet si për linjat urbano - periferike ashtu edhe për ato ndër urbane në qytetin e Rahovecit realizohen nga stacioni i autobusëve. Mirëpo kompanitë auto transportuese, gjithashtu edhe udhëtaret nuk e respektojnë këtë pasi që ndalen respektivisht presin autobusët në pika të ndryshme të qytetit pa ndonjë infrastrukturë adekuate për ndalje apo pritje. Duke e parë nevojën e qytetarëve së bashku me grupin punues kemi ardhur në përfundim që disa vendndalje ilegale të cilat e pengojnë rrjedhën normale të qarkullimit të legalizohen në ato vende që nuk do ta pengonin dhe të krijohet një infrastrukturë e sigurtë për pritjen e autobusëve.

Edhe pse koha e udhëtimit nga pika të largëta deri tek stacioni nuk është shumë e madhe dhe mund të realizohet edhe në këmbë, përsëri kemi menduar që qytetarëve t'i ofrohet një shërbim me kualitativ sa i përket transportit.



*Figura 20. Vendndaljet e propozuara në qendër të qytetit*



*Figura 21. Vendndaljet e propozuara në dalje të qytetit*

Kështu që është menduar që të krijohen dy vendndalje të autobusëve një në qendër të qytetit, tek semaforët si në figurën 20 dhe tjetri në dalje të qytetit në rrugën rajonale R204 figura 21.

Pasi që ndaljet ilegale nuk janë të përshtatshme si për nga aspekti i sigurisë ashtu edhe për nga ai funksional, kjo është arsyeja kryesore se pse duhet të krijohet një infrastrukturë adekuate me siguri maksimale për të gjithë pjesëmarrësit.

## 4.6. Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal

Gjendja e sinjalizimit në qytetin e Rahovecit nuk është e mirë, për këtë ka nevojë që të përsëritet dhe të vendoset në vendet ku mungon. Gjatë realizimit të vendosjes së shenjave duhet të respektohen të gjitha standardet e parapara me udhëzimin administrativ të Kosovës.

Në një kontekst të tillë, sinjalizimi i trafikut (horizontal, vertikal dhe plotësues) duhet të ofrojnë informacionet e duhura dhe lexueshmëri të mirë në të gjitha kushtet atmosferike dhe të shikueshmërisë (ditë, natë, lagështirë, thatësirë, mjegull), dhe të garantojnë informacion të plotë në drejtimin e automjetit. Një sinjalistikë e qartë dhe efikase është dhe elementi kyç për përmirësimin efektiv të sigurisë rrugore.

Sinjalizimi horizontal, është i pakët dhe janë evidentuar shumë probleme të shtrirjes dhe mirëmbajtjes. Këto probleme janë shkaktuar nga qëndrueshmëria e dobët e mbulesës së rrugëve dhe nga prezenca e pluhurit e shkaktuar nga rrugët e pa asfaltuara dhe nga trotuaret e pa shtruara ose në një gjendje jo të mirë e rrugëve.

Sinjalizimi vertikal, duhet të kenë një afat teknik përdorimi prej jo më pak se shtatë vjet. Gjithashtu sinjalet vertikale duhet të jenë homogjene, duke mënjanuar fenomenët ku janë vendosur sinjale të vogla dhe të mëdha pa ndonjë kriter të veçantë, shpesh lartësitë nuk janë në përputhje me rregullat e vendosjes, janë shumë të pakta dhe disa herë jo në vende shumë të dukshme.

## 4.7. Ndërtimi i rrugëve tranzite

Aktualisht në qytetin e Rahovecit rruga kryesore e cila e përshkon qendrën e qytetit është e vetmja rrugë e cila i plotëson kriteret për qarkullimin e mjeteve të rënda, me këtë nënkuptohet se nuk ka ndonjë alternativë tjetër për ri-organizimin e qarkullimit në qytet. Lëvizja e mjeteve komerciale në qendër drejtpërsëdrejt ndikon edhe në sigurinë e këmbësorëve kur dihet se rruga në fjalë nuk ka trotuare adekuate, dhe pjesërisht të ndërprera, ku në këto raste lëvizja e këmbësorëve bëhet në shtresën qarkulluese si e përbashkët me të gjitha mjetet tjera.

Në planin zhvillimor dhe rregullative është paraparë që të ndërtohen rrugët tranzite ku ajo në pjesën veriore tashme është e trasuar dhe është përfunduar, e cila lidhë rrugët rajonale R204, R110 dhe R117. Me këtë segment rrugor do të mundësohet ri-orientimi i automjeteve komerciale, që ta shmangin qendrën e qytetit.

- Rruga Rahovec-Hamoc-Fortesë, rrugë që lidh dy rruge rajonale
- Rruga kater korsi, Rahovec-Xerxe si dhe nga rrethrrotullimi ne hyrje te qytit deri te rruga transite eshte ne ndertim shiriti i 3 te rrugor.



*Figura 22. Rruga tranzite në pjesën veriore*

Aq më shumë do ta lehtësonte qarkullimin edhe ndërtimi i rrugës tranzite në pjesën Jug-lindore të qytetit, me këtë do të ishte përmbyllur qarkorja e jashtme e qytetit e cila do ta kishte mundësuar një qasje shumë më të shpejtë dhe më të lehtë në qytet. Një pjesë e kësaj rruge është ndërtuar dhe është në ndërtim e sipër krejt çka duhet janë investime për të lidhur këtë. Në figurën 23 me ngjyrë të kuqe është shënuar traseja ekzistuese mirëpo, disa parametra gjeometrikë nuk janë shumë të favorshëm për qarkullimin e mjeteve komerciale, andaj së bashku me grupin punues është menduar që të shqyrtohet mundësia e lidhjes së këtyre dy pikave me trase të re, e cila është e drejtë edhe shumë e favorshme për qarkullim.



*Figura 23. Rrugët tranzite në pjesën Jug-lindore të qytetit*

## 4.8. Rritja e sigurisë në udhëkryqe me rrugë magjistrale

Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese kemi ardhur në përfundim se kemi një numër të konsiderueshme të udhëkryqëve që mund t'i konsiderojmë me rrezikshmëri të lartë, kjo për faktin se ka ndodhur një numër i konsiderueshëm i aksidentëve. Këtu bëjnë pjesë disa kryqëzime me rrugë magjistrale siç janë në fshatin Xërxë, fshatin Krushë e Madhe, rrethrotullimi në hyrje të qytetit. Të gjitha këto pika duhet të ri-projektohen apo të vendosen masa dhe mënyra të tjera të qarkullimit.

Krushë e Madhe | Xërxë




*Figura 24. Disa nga kryqëzimet e rrezikshme me rrugë magjistrale*

Të gjitha kryqëzimet e lartpërmendura, por edhe disa tjera kanë nevojë për një analizë gjeometrike, dhe funksionale me qëllim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit.

## 4.9. Ri-orientimi i qarkullimit në qytet

Me ndërtimin e këtyre rrugëve tranzite mundësohet edhe rregullimi apo ri-orientimi i brendshëm i rrugëve, aktualisht kërkesa për lëvizje nuk është shumë e madhe dhe kapaciteti i rrugëve është në nivel të kënaqshëm, mirëpo për një periudhë afatmesme kërkesa për lëvizje mund të rritet, ndërsa është e pamundur zgjerimi i rrjetit rrugor në qendër të qytetit.

Për nga aspekti i sigurisë së këmbësorëve Rahoveci karakterizohet me rrugë shumë të ngushta dhe mungesë të trotuareve, pikërisht për këtë arsye është menduar që të bëhet orientimi i qarkullimit në rrugë njëkahore që të krijohet një hapësirë për lëvizje të sigurtë të këmbësorëve.

Më poshtë në figurën 25 janë prezantuar disa skenar të mundshëm për orientimin e qarkullimit njëkahorë në qytet.






*Figura 25. Qarkullimi njëkahorë në rrugët kryesore të qytetit*



*Figura 26. Disa skenar të mundshëm për orientimin e qarkullimit njëkahorë në qytet*

# 5. PLANI I VEPRIMIT

Nëse analizohen faktorët kyç që çuan shumë qytete evropiane në hartimin e planeve të mobilitetit urban këtë alternativë për lëvizje mund ta kuptojmë po kaq të vlefshme edhe për komunën e Rahovecit. Është pikërisht trendi i 20 viteve të fundit në Kosovë për rritjen e shkallës së motorizimit, dhe nevoja që të ndryshohet qasja për analizën e lëvizshmërisë në qytet. Duke e parë këtë trend të rritjes së mjeteve të motorizuara patjetër që duhet të akomodohen në rrjetin ekzistues, i cili nuk ishte i planifikuar për këtë shkallë të motorizimit. Tani sfida kryesore e inxhinierëve mbetet që të ruhet balanca në mes të mjeteve motorike dhe atyre të pa motorizuara, duke i akomoduar në infrastrukturën ekzistuese, mirëpo duke mos bërë asnjëherë kompromis për zvogëlimin e sigurisë.

Sfida është të gjenden mënyra për të promovuar dhe ruajtur kulturën e ecjes, ngasjen e biçikletës qasjen e lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik dhe transferimin e praktikave inovative të përshtatshme në shërbim të mobilitetit në komunën e Rahovecit.

**Veprimi 1: Caktimi i zyrtarit për mobilitet urban**

Në kudër të drejtorisë për shërbime publike është e nevojshme të caktohet një zyrtar për mobilitet urban, i cili ka për detyrë të përgatis një program për menaxhimin e mobilitetit urban që përfshinë më shumë informata, fushata ndërgjegjësimi, promocion, marketing, koordinim dhe organizim.

**Veprimi 2: Rritja e sigurisë në trafik - siguria në rend të parë**

Edukimi lidhur me rregullat e trafikut dhe pjesëmarrjen e sigurt në trafik. Drejtoria për Shërbime Publike së bashku me Drejtorinë e Arsimit dhe Policinë, të përgatisin materialin e nevojshëm dhe të organizojnë ligjërata për edukimin në trafik në komunën e Rahovecit. Ligjëratat kryesisht të mbahen nga profesionistë të fushës dhe të organizohen në shkollat fillore dhe të mesme.

**Veprimi 3: Promovimi i lëvizjeve të pa motorizuara**

Të organizohen fushata ndërgjegjësimi dhe promovimi të lëvizjeve të pa motorizuara. Të bëhet promovim mediatik në nivel lokal (TV lokale, media elektronike etj). Të shfrytëzohen ngjarje të caktuara për promovimin e lëvizjeve të pamotorizuara, si java evropiane e mobilitetit (16-22 shtator), dita pa makina etj. Gjatë kësaj jave në shumë vende, mbahen me mijëra aktivitete për promovimin e lëvizjeve të pamotorizuara. Është i nevojshëm krijimi i partneriteteve ndërmjet Komunës dhe shkollave (mundësisht edhe me përfshirjen edhe të ndonjë OJQ-je) me qëllim të krijimit të politikave më të përshtatshme dhe promovimin lëvizjeve të pamotorizuara.

**Veprimi 4: Përshtatja e infrastrukturës për persona me aftësi të veçanta**

Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe në partneritet me organizatat përkatëse për persona me aftësi të veçanta, në mënyrë që në të gjitha vendet e kalimeve në rrugë dhe në vendkalimet për këmbësorë, të merren masa adekuate në përshtatje me kriteret teknike, që vendkalimet e këmbësorëve t’u mundësojnë qasje edhe personave me mobilitet të zvogëluar.

| Nr | Masat | Qëllimi | Indikatorët | Përgjegjës | Rëndësia e masave (1-3)[1] | Kostoja E përafërt | Afatet kohore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave | Rregullimi i qarkullimit me qëllim të rritjes së sigurisë | Qetësimi i trafikut | Komuna e Rahovecit | 1 | 2000 /ishull<br>2 x 2000 = 4000 € | 2023 + 2024 |
| 2 | Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | Vendosja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore | Nr.i shenjave të vendosura dhe gjatësia/ sipërfaqja e sinjalizimit horizontal | Komuna e Rahovecit | 1 | 16 000<br>20 000<br>20 000<br>20 000<br>20 000 | 2023<br>2024<br>2025<br>2026<br>2027 |
| 3 | Krijimi i hapësirave për lëvizjen e sigurtë të këmbësorëve në rrugët ekzistuese | Shenjëzimi i tyre, ndarja e tyre nga shiritat qarkullues | Gjatësia e tyre | Komuna e Rahovecit | 2 | 5000 | 2023 |
| 4 | Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve | Krijimi i hapësirave të sigurta për lëvizje të këmbësorëve | Gjatësia e trotuareve të ndërtuara | Komuna e Rahovecit | 1 | 100 000<br>50 000<br>50 000<br>50 000<br>50 000 | 2023<br>2024<br>2025<br>2026<br>2027 |
| 5 | Infrastruktura rrugore për personave me aftësi të veçanta | Përshtatja e infrastrukturës rrugore për personave me mobilitet të zvogëluar | Gjendja e infrastrukturës rrugore pas realizimit | Komuna e Rahovecit | 1 | 3000<br>10 000 | 2023<br>2024-2026 |
| 6 | Riorientimi i qarkullimit | Kahëzimi i trafikut | Infrastruktura e re e krijuar | Komuna e Rahovecit | 2 | 4000 | 2023 |
| 7 | Ndërtimi i stacioneve të autobusëve | Përmirësimi i kushteve të trafikut ndërurban – dhe urbano periferik | Numri i stacioneve të ndërtuara | Komuna e Rahovecit | 1 | 4500<br>2 vendndalje | 2023 |
| 8 | Krijimi i vend-ndaljeve në rrugën Xhelal Hajda | Përshtatja e infrastrukturës për biznese | Numri i vend ndaljeve | Komuna e Rahovecit | 1 | 300 €/vendndalje<br>5000 për 15 vendndalje | 2023 - 2024 |
| 9 | Ndërtimi i rrugëve tranzite – pjesa veriore, Suharekë – Prishtinë, ndertimi i rruges 3 shiritore ''rruga e UCK-se'' | Krijimi i rrugëve të reja me qëllim të largimit të automjeteve komerciale nga qendra | Riorientimi i qarkullimit | Komuna e Rahovecit<br>Ministria e Infrastrukturës | 2 | 1,500,000.00 | 2023<br>2024<br>2025 |

1 Rëndësia e masave: 1- urgjente, 2 – mesatare, 3- e ulët

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | Ri-projektimi i ud-hëkryqeve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes se sigurisë<br><br>Udh. Xërxë<br><br>Udh. Krushë<br><br>Udh.Rahov. | Rritja e sigurisë në udhëkryqë | Format e reja të rregullimit | Komuna e Rahovecit<br><br>Ministria e Infrastruk-turës | 1 | 150 000<br><br>150 000<br><br>150 000 | 2023 |
| 11 | Ri-projektimi i ud-hëkryqëve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes se sigurisë<br><br>Udhëkryqët në rrugët rajonale<br><br>Prishtinë R 204<br><br>Suharekë R 117<br><br>Xërxë R 110 | Rritja e sigurisë në udhëkryqe | Format e reja të rregullimit | Komuna e Rahovecit<br><br>Ministria e Infrastruk-turës | 1 | - | 2023 - 2025 |

# 6. VLERËSIMI STRATEGJIK NË MJEDIS (VSM)

Deklaratë e arsyetimit për përcaktim për mos përgatitjen e raportit të vlerësimit strategjik për mjedis, për planin e mobilitetit (PM) në komunën e Rahovecit.

## 6.1. Përmbledhje e PM

Komuna e Rahovecit, duke ju falënderuar mbështetjes së projektit të pare për mobilitet ngaa ana e DEMOS-it, ka përgatitur Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm (PM). Fillimisht është krijuar Grupi Punues i përbërë nga përfaqësues të palëve të ndryshme të interesit, përfaqësues të drejtorive relevante nga Komuna e Rahovecit.

Një rol të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së PM kanë luajtur ekspertët e angazhuar nga DEMOS, të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë me ekspertët komunal, në identifikimin dhe përshkrimin e situatës aktuale lidhur me qarkullimin rrugor, analizën financiare dhe mundësitë ekonomike financiare për përmirësimin dhe mundësimin e një mobiliteti të qëndrueshëm, përkufizimin e objektivave, përkufizimin e veprimeve dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren për një mobilitet gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

**Plani i Mobilitetit përfshinë:**

- sigurimin e qasjes më të lehtë për lëvizjet ditore dhe shërbime tjera;
- përmirësimin e shkallës së sigurisë;
- zvogëlimin e ndotjes së ambientit;
- rritjen e efikasitetit dhe ekonomicitetit gjatë transportit të njerëzve dhe të mallrave;
- rritjen e atraktivitetit dhe kualitetit të mjedisit urban.

**Plani i Mobilitetit nuk përfshinë:**

- ndërtimin e rrugëve të reja (përveç tranzitit i cili nuk do të jetë më i gjatë se 3 km);
- ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse siç janë: rrethrotullimet, nënkalimet apo mbikalimet;
- projekte të tjera, për të cilat sipas ligjit do të kërkohej vlerësimi i ndikimit në Mjedis.

## 6.2. Referenca Ligjore e konsultuar për përcaktim

**Ligji për Vlerësim Strategjik Mjedisor, Nr. 03/L-230,**

**Neni 3**

1. VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis.

2. Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, **komunikacionit,** menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat, duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.

Përcaktimi për të mos përgatitur raport të VSM për Planin e Mobilitetit (PM) në komunën e Rahovecit është në përputhje me nenin e lartë përmendur. Pika 2 e këtij neni potencon se **"... VSM është i detyrueshëm për planet nga fusha e ... komunikacionit..."**; Por, në pjesën e dytë të po këtij paragrafi vazhdohet "... **të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis për përputhje me ligjin..."**

**Neni 5 Përcaktimi i nevojës për VSM,**

1. Autoriteti përgjegjës duhet që të përcaktoj nga hulumtimi i secilit rast veç e veç, mbështetur në kriteret e Shtojcës 1, për planet ose programet referuar në nenin 3, paragrafi 3 dhe 4 i këtij ligji, se a kanë ndikim të theksuar në mjedis në mënyrë që ti nënshtrohen VSM.

Grupi punues për përgatitjen e PM, duke ju referuar provizionit të lartë përmendur, ka shqyrtuar PM duke krahasuar me kriteret e shtojcës 1 të ligjit për VSM, dhe nga ku gjithashtu është konstatuar se PM nuk pritet të ketë ndikime të mëdha në mjedis, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet procedurës së VSM.

## 6.3. Analiza krahasuese sipas kritereve të shtojcës 1 të ligjit për vsm nr. 03/L-230, si dhe aktiviteteve të PM të komunës së Rahovecit

| Kriteret e vlerësimit sipas shtojcës 1 të ligjit të VSM | Efektet e Planit të Mobilitetit në Komunën e Rahovecit (PM) |
|---|---|

| 1. **Karakteristikat e planeve dhe të programeve, duke pasur parasysh në veçanti:** | |
|---|---|
| 1.1. shkallën në të cilën një plan ose program përcakton kuadrin e projekteve dhe të aktiviteteve të tjera, ose lidhja e tyre me vendndodhjen, natyrën, madhësinë dhe kushtet operuese ose me burimet e përcaktuara, | PM nuk parasheh zhvillimin e projekteve (infrastrukturë, objekte përcjellëse në komunikacion etj) të cilat do t'i nënshtroheshin procedurës sipas ligjit për VNM. Megjithatë PM në njërën nga masat e propozuara (objektivi 2.1) parasheh ndërtimin e rrugës së tranzitit verior me gjatësi rreth 2km dhe si e tillë i nënshtrohet ligjit për VNM komunale. Po ashtu parashihet të bëhet edhe ri-projektimi dhe ri-ndërtimi i udhëkryqëve të rrezikshme por që si projekte do të trajtohen veç e veç për nënshtrimin ose jo për VNM.<br><br>Kurse objektivat më kryesore do të jenë lehtësimi i qarkullimit rrugor duke marrë masa lehtësuese në mënyrë që t'i mundësohet të gjithë pjesëmarrësve në trafik një qarkullim sa më i sigurt. |
| 1.2. shkallën në të cilën plani ose programi influencon plane dhe programe të përfshira dhe ato në hierarki, | Ky plan është në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Komunal i cili po ashtu ju ka nënshtruar procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor nga ku mund të konkludohet se nuk influencon, planet tjera ekzistuese qoftë ato komunale qoftë ato kombëtare. |
| 1.3. lidhjen e planit ose programit për integrimin e konsideratave mjedisore në veçanti në lidhje me promovimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, | Në përgjithësi, plani është në harmoni me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke propozuar masa lehtësuese për promovimin e lëvizjeve jo-motorike (p.sh. çiklizmin) në këtë komunë që do të kontribuonte në përmirësimin e kualiteti të ajrit duke bërë riqarkullimin përmes ndërtimit të tranzitëve. |
| 1.4. probleme mjedisore që lidhen me planin ose programin, | Në objektivat e parapara në Planin e Mobilitetit të Komunës, nuk është hasur në probleme të mundshme mjedisore që mund të lindin si pasojë e realizimit të objektivave të cekura më lartë. Megjithatë duhet thënë që parashihet ndërtimi i tranzitit verior por që do të ketë efekt pozitiv, në përmirësimin e kualitetit të ajirt, pasi që gjitha automjetet tranzite do të orientoheshin në atë rrugë duke kontribuar pozitivisht në ngritjen e kualitetit të ajrit. Projekti i tranzitit do ti nënshtrohet procedurës për VNM komunale si projekt i vetëm. |
| 1.5. përputhshmërinë e një plani ose programi për zbatimin e legjislacionit të Komunitetit mbi mjedisin (p.sh planet dhe programet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e ujit). | Duhet thënë se plani si plan nuk kërkohet sipas legjislacioneve qoftë mjedisore apo ato të vetëqeverisjes lokale, por që mund të ndërlidhet me shumë ligje të cilat e promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësimin e kualitetit të jetës, lëvizjen e lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, etj. Dhe mund të thuhet se si i tillë bëhet në mënyrë vullnetare nga Komunat dhe duke pasur parasysh kërkesat që rrjedhin nga ligji për VSM për skanimin e çdo plani apo programi të hartuar nga komunat në këtë rast, për ndikime të mundshme në mjedis, është parë e arsyeshme që ti nënshtrohet këtij procesi.<br><br>Ndër të tjera vlenë të ceket se ky plan dhe të gjitha objektivat e përfshira në këtë plan janë në harmoni të plotë me Planin Zhvillimor Komunal. |

| 2. Kar akteristika të efekteve dhe të zonave që ka të ngjarë të ndikohen, duke pasur parasysh, në veçanti: | |
|---|---|
| 2.1. probabilitetin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe natyrën e efekteve, | PM përfshinë periudhë 5 vjeçare (2022-2027). Gjatë këtyre viteve pritet të ketë rritje të efekteve të cilat do të jenë pozitive. (shih pikën 1.3) |
| 2.2. natyrën kumulative të efekteve, | Plani nuk parasheh efektet cilat në kontekstin kumulativ do të rezultonin me pasoja mjedisore. Përkundrazi me ri-orientimin e trafikut, shtimin e shtigjeve për biçiklist, rritja e sigurisë në rrugë do të ketë efekte pozitive në ngritjen e kualitetit të ajrit në përgjithësi dhe sigurisë në trafik për të gjithë pjesëmarrësit në veçanti. |
| 2.3. natyrën ndërkufitare të efekteve,<br><br>2.4. rrezikun e shëndetit të njeriut mbi mjedis (p.sh si shkak i aksidenteve), | Nuk do të ketë efekte negative ndërkufitare. Plani i Mobilitetit është i karakterit lokal. Priten efekte pozitive, por që do të jenë indirekte. Kjo do të rezultojë nga përmirësimi i qarkullimit rrugor dhe rritja e sigurisë në trafik, mundësimin e qasjes për persona me aftësi të kufizuara etj. |
| 2.5. shkallën dhe shtrirjen hapësinore të efekteve (zona gjeografike dhe madhësia e popullsisë që mund të preken), | Efektet pozitive mjedisore të këtij plani , deri në fund të vitit 2027 do të prekin 80% të territorit dhe banorëve të komunës së Rahovecit. |
| 2.6. vlerën dhe cenueshmërinë e zonës që ka të ngjarë të ndikohet si rezultat i, | Nuk është relevantë për PM Rahovec. |
| 2.6.1. karakteristikave të veçanta natyrore ose trashëgimisë kulturore, | Duke qënë se PM nuk parasheh ndërhyrje fizike (përveç ndërtimit të tranzitit), ndërtim të objekteve, infrastrukturës, prerje të pyjeve, zënie tokash, gërmime etj, nuk do të ketë dëmtim/degradim të zonave natyrore apo trashëgimisë kulturore. |
| 2.6.2. standardeve mjedisore të tepërta dhe vlerave limit, | PM nuk parasheh projekte të cilat do të rezultonin me emisione qoftë në ajër qoftë në ujë, e të cilat do të ishin subjekt i shqyrtimin në kontekstin e tejkalimit të standardeve apo vlerave kufitare. |
| 2.6.3. përdorimit intensiv të tokës, | PM nuk parasheh zënie, apo përdorim të tokave të gjitha veprimet sipas objektivave do të bëhen në gjendjen ekzistuese, me përjashtim të ndërtimit të urës së lartëcekur, por që nuk do të ketë përdorim intensiv të tokës. |
| 2.7. efektet mbi zonat ose sipërfaqet që kanë një status të njohur kombëtar, komunitar ose ndërkombëtar mbrojtës. | Komuna e Rahovecit shtrihet në mesin e rrugëve magjistrale Gjakovë – Prishtinë dhe Gjakovë – Prizren, si dhe atyre rajonale Malishevë – Gjakovë, dhe Rahovec – Suharekë. Konfiguracioni i terrenit eshtë kodrinorë ku karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë të ngushta të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik.<br><br>Në territorin e komunës së Rahovecit gjenden kanioni i Drinit të Bardhë dhe Parku Regjional i Mirushës të cilat kanë status të njohur kombëtar mbrojtës, por duke pasur parasysh që ky plan sheh intervenime/përmirësime vetëm në gjendjen ekzistuese dhe larg këtyre zonave mund të thuhet se nuk do të ketë ndonjë ndikim negativ i cili do të prekte këto dy zona si rezultat i këtij PM.<br><br>Në anën tjetër edhe objektivat e caktuara në PM janë me efekt të karakterit pozitiv. |

# 7. PLANI FINANCIAR

rregullim

## 7.1. Hyrje

Kapitulli financiar ka të bëjë me analizën e kapaciteteve buxhetore të komunës për periudhën kohore 2022-2027. Në bazë të të dhënave zyrtare komunale siç është Buxheti Vjetor i Komunës dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024, si dhe trendeve relevante ekonomike-financiare. Në vijim janë paraqitur përllogaritjet afat-mesme të trendeve të sipërpërmendura të cilat mund të kenë ndikim në investimeve të planifikuara dhe mirëmbajtëse të nevojshme në fushën e mobilitetit komunal për periudhën 2022-2027.

Për më shumë, projektet e identifikuara në fushën e mobilitetit reflektojnë si prioritete të komunës për të njëjtën periudhë (2022-2027), dhe duke marrë parasysh kapacitetin buxhetor të komunës, si dhe trendet ekonomike, mbështetjen me grante nga buxheti qendror, dhe të hyrat vetanake të komunës. Gjithashtu, si burim shtesë financimi janë identifikuar edhe segmenti i donatorëve, si mundësia e bashkë-financimit të projekteve të identifikuar.

## 7.2. Struktura e Buxhetit Komunal

Siç u potencua më sipër Buxheti i Komunës së Rahovecit për bazë ka Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2022-2024), ndërsa zbërthimi i shpenzimeve është si vijon:

*Tabela 1: Struktura Buxhetore e Komunës (2022-2024)*

| Viti | Buxheti komunal | Granti Qeveritar | Të hyrat vetanake | Investimet Kapitale |
|---|---|---|---|---|
| 2021 | 14,548,823 | 13,487,730 | 1,061,093 | 3,905,770 |
| 2022 | 15,053,660 | 13,703,112 | 1,350,548 | 4,354,212 |
| 2023 | 17,548,240 | 16,102,637 | 1,445,603 | 5,651,323 |
| 2024 | 18,868,048 | 17,362,862 | 1,505,186 | 6,653,713 |

Nga grafiku Nr. 1 mund të shihet një mospërputhje serioze në mes të ardhurave komunale të cilat tregojnë një varshmëri të madhe të buxhetit komunal në periudhën afatmesme.




*Grafiku 1: Struktura e të ardhurave komunale*

Nëse bëhet një krahasim në mes të hyrave vetanake të komunës dhe granteve qeveritare, nga grafiku 2 shihet qartë se grantet qeveritare përbëjnë pjesën dërmuese të buxheti më shumë se 85% të ardhurave të buxhetit të komunës së Rahovecit.




*Grafiku 2: Struktura e të ardhurave komunale*

Me qëllim që të shihet më mirë struktura e shpenzimeve komunale, është me rëndësi të veçohen investimet komunale, ku një pjesë të rëndësishme e përbëjnë investimet kapitale. Planifikimet e komunës për investime kapitale për vitet 2022 - 2024 janë si më poshtë:

*Tabela 2: Investimet Kapitale (2022 - 2024)*

| Viti | Buxheti komunal | Investimet Kapitale |
|---|---|---|
| 2021 | 14,548,823 | 4,354,212 |
| 2022 | 15,053,660 | 4,815,816 |
| 2023 | 17,548,240 | 5,651,323 |
| 2024 | 18,868,048 | 6,653,713 |

Nëse u referohemi KASH të hartuar nga Komuna e Rahovecit, investimet kapitale planifikohen të shënojnë rritje të lehtë, edhe pse deri në 2023 nuk planifikohet të mbërrijë nivelin e periudhës 2020, kur ato ishin në nivelin më të lartë për komunën.




*Grafiku 3: Investimet e planifikuar kapitale*

Kur bëhet fjalë për të Hyrat Vetanake, po ashtu KASH e Komunës tregon për një rritje simbolike e cila nuk është ndonjë lëvizje serioze sa i përket financimit të pavarur nga ana e komunës në periudhën 2023-2025, siç mund shihet edhe nga tabela dhe grafiku i më poshtëm.




*Grafiku 4: Trendi i të hyrave vetanake*

## 7.3. Plani Investiv

Investimet e planifikuara në mobilitet janë të bazuara në nevojat e vlerësuara për përmirësimin e gjendjes aktuale. Plani i investimeve është i bazuar në burimet e financimit nga mjetet financiare të aplikueshme në komunë.

Objektivat e planifikimit të investimeve me qëllim të realizimit të planit janë të bazuara në parakushtet e përcaktuara:

- Përcaktimi i nevojave investive i bazuar në nevojat për mobilitet;
- Mundësia e financimit të investimeve të planifikuara bazuar në burimet e njohura të financimit;
- Ndarja e projekteve në bazë të prioriteteve e bazuar për përmirësimin e gjendjes në fushën e mobilitetit. Prioritetet e investimeve janë të planifikuara në tre grupe:
    - Urgjent
    - Mesatare
    - E ulët
- Rrjedha e parasë për investimet e planifikuara është bazuar në kohën e përfundimit të investimeve për detyrimet e kontraktuara me operatorët ekonomik të kontraktuar;
- Burimet e financimit të investimeve janë të arritshëm, janë të njohura për përmbushjen e investimeve të planifikuara;
- Investimet e planifikuara janë të përllogaritura sipas çmimeve aktuale sipas kategorive investive të planifikuara.

## 7.4. Analiza buxhetore e kostove investive kapitale

Investimet e plan- ifikuara janë të bazuara në 8 projekte të shpërndara në kategori të përcaktuara.

Vlerësimi i projekteve e mundësia e realizimit të planit të investimeve për periudhën e planit 2022-2026 projektet janë të kategorizuara në disa grupe kryesore në varëshmëri prej natyrës se tyre. Investimet janë të bazuara në 5 kategori kryesore të investimeve:

- Siguria në komunikacion;
- Rregullimi i qarkullimit të automjeteve;
- Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve;
- Sinjalizimi;
- Infrastruktura për persona me mobilitet të zvogëluar.

Ndarja e investimeve do të mundësoj monitorimin e realizmit më të lehtë të planit, dhe ndikimin e realizimit të përmbushjes së objektivave të përcaktuara.

*Tabela 3: Pasqyra përmbledhëse e planit të mobilitetit për periudhën 2022-2027*

**Tabela përmbledhës e Investimeve**

| | |
|---|---|
| Numri i Hapësirave | 8 |
| Total Investimet | 2,010,000 |
| Vlera e mesatare për projekt | 251,250 |
| Në % | |

| Investimet 2016-2020 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vlera investive | 900,000 | 449,000 | 440,000 | 150,000 | 71,000 | **2,010,000** |
| *Në %* | *44.8%* | *22.4%* | *21.8%* | *7.46%* | *3.54%* | *100.0%* |

Struktura e Investimeve

| Kategoria | Vlera investive | Investimet në % |
|---|---|---|
| Siguria në komunikacion | 900,000 | 44.8% |
| Rregullimi i qarkullimit Automjete | 449,000 | 22.4% |
| Rregullimi i qarkullimit këmbësor | 440,000 | 21.8% |
| Sinjalizim | 150,000 | 7.46% |
| Infra. për njerëz me nev. e veçanta | 71,000 | 3.54% |
| **Total** | **2,010,000** | **100.0%** |

| Burimet e Financimit | Komuna e Rahovecit | Ministria e infrastrukturës | Donatorët | Total |
|---|---|---|---|---|
| Vlera investimeve | 900,000 | 1,039,000 | 71,000 | 2,010,000 |
| Në % për 2016-2020 | 44.8% | 51.7% | 3.5% | 100.0% |

| Investimet/Prioriteti | I Lartë | Mesatar | I Ulët | Total |
|---|---|---|---|---|
| Vlera investimeve | 1,039,000 | 449,000 | - | 2,010,000 |
| *Në %* | *51.7%* | *22.3 %* | | *100.0%* |

| Kategoria/Investimet | I Lartë | Mesatar | I Ulët | Total |
|---|---|---|---|---|
| Numri i projekteve | 8 | | - | |
| Vlera mesatare për projekt | 251,250 | | | 2,010,000 |

| Burimet e financimit 2016-2020 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total | Në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna Rahovec | 350,000 | 200,000 | 165,000 | 95,000 | 90,000 | 900,000 | 44.8% |
| Ministria e infrastrukturës | 300,000 | 300,000 | 200,000 | 100,000 | 139,000 | 1,039,000 | 51.7% |
| Donatoret | | | | 71,000 | | 71,000 | 3.5% |
| **Total** | **650,000** | **500,000** | **365,000** | **266,000** | **229,000** | **2,010,000** | **100%** |

*Në %*

## 7.5. Nevoja për investime të reja

Investimet e planifikuara janë të bazuara në burimet e financimit të qëndrueshëm, të cilat mundësojnë siguri në realizimin e investimeve. Investimet kapitale janë të planifikuara në bazë të buxhetit aktual. Vlera e investimeve në fushën e mobilitetit për periudhën 2022-2026 është përllogaritur në 2,010,000 Euro.

*Tabela 4: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2026*

| Investimet | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Vlera Investive | 650,000 | 500,000 | 365,000 | 266,000 | 229,000 | 2,010,000 |
| *Në %* | *32.3%* | *24,8%* | *18.1%* | *13.23%* | *11.39%* | *100.0%* |




*Grafiku 5: Paraqitja grafike e strukturës investimeve për periudhën planifikuese 2022-2026*

Investimeve për periudhën planifikuese janë të koncentruara në dy vitet e para të planit të mobilitetit (2022/2023), ndërsa në periudhën 2024-2026 janë në pjesëmarrje më të ulët.

- Investimeve e planifikuara për periudhën 2022/2023 në vlerë prej 1,150,000.00 Euro në përqindje 57.2%.
- Investimeve e planifikuara për periudhën 2024/2026 në vlerë prej 860,000.00Euro në përqindje 42.8%.

*Tabela 5: Investimet e planifikuara në Mobilitet për periudhën 2022-2026*

| Investimet | 2022/2023 | 2024/2026 | Total |
|---|---|---|---|
| Vlera Investive | 1,150,000 | 860,000 | 2,010,000 |
| *Në %* | *57.2%* | *42.8%* | *100.0%* |




*Grafiku 6: Paraqitja grafike e strukturës së investimeve për periudhën planifikuese 2022-2026*

Investimet në mobilitet janë ndikuar prej alokimit të buxhetit komunal si dhe burimeve të tjera të financimit të cilat sipas përvojes janë të alokuara në kuartalin e tretë dhe të katërt të viteve të investimeve.

*Tabela 6: Rrjedha e parasë e investimeve të planifikuara për periudhën 2022-2026*

| Investimet | Q1 | Q2 | Q3 | Q4 | Total | Në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | - | 50,000 | 100,000 | 500,000 | 650,000 | 32.3% |
| 2023 | - | 50,000 | 100,000 | 350,000 | 500,000 | 25 % |
| 2024 | - | - | 100,000 | 265,000 | 365,000 | 18.1% |
| 2025 | - | - | 100,000 | 166,000 | 266,000 | 13.23% |
| 2026 | - | - | 100,000 | 129,000 | 229,000 | 11.39% |
| **Total** | | **100,000** | **500,000** | **1,410,000** | **2,010,000** | **100.0%** |

## 7.6. Vlerësimi i investimeve të reja në mobilitet

### 7.6.1. Struktura e investimeve për periudhën 2022-2026

Struktura e investimeve vënë në pah dominimin e kategorive: **siguria në komunikacion, rregullimi i qarkullimit**, pjesëmarrja e të cilëve është rreth 57.2% nga vlera e përgjithshme e investimeve të planifikuara. Ndërsa, kategoritë e tëra të investimeve kanë pjesëmarrje dukshëm më të vogëla.

*Tabela 7: Investimet e planifikuara në bazë të kategorive të investimeve për periudhën 2022-2026*

| Kategoria | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total | Në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Siguria në komunikacion | | 600,000 | 300,000 | | | 900,000 | 44.7% |
| Rregullimi i qarkullimit të automjeteve | 150,000 | 250,000 | 49,000 | | | 449,000 | 22.4% |
| Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve | | 200,000 | 240,000 | | | 440,000 | 21.9% |
| Sinjalizimi | | 50,000 | 40,000 | 40,000 | | 130,000 | 6.4% |
| Sinjalet ndriçuese | | 20,000 | | | | 20,000 | 1.0% |
| Infrastruktura për persona me mobilitet të zvogëluar | | 71,000 | | | | 71,000 | 3.6% |
| **Total** | **150,000** | **1,191,000** | **629,000** | **40,000** | | **2,010,000** | **100.0%** |

### 7.6.2. Investimet e bazuara në prioritetet për periudhën 2022-2026

**Kategoria e investimeve me prioritet - Të Lartë:** pjesëmarrja e kategorisë në vlerë prej 1,191,000 EURO e shprehur në përqindje 59.2% nga vlera e përgjithshme e investimeve. Vlera mesatare e bazuar në projekt i këtij grupi është 148,875 i cili është më e ulët në krahasim me kategorinë e investimeve me prioritet mesatar. Përcaktimi i prioritetit të lartë të këtij grupi nënkupton një vëmendje të shtuar për realizimin e pa kusht të këtyre investimeve për arritjen e objektivave të përcaktuara. Realizimi me sukses i këtij grupi të investimeve ka ndikim në plotësimin e nevojave me ndikim në mobilitet.

**Kategoria e investimeve me prioritet - Mesatar:** Projektet e kësaj kategorie kanë pjesëmarrje në vlerë prej 669,000 EURO e shprehur në përqindje 33.2% nga vlera e përgjithshme të investimeve. Vlera mesatare e bazuar në projekt të këtij grupi është 83,625 Euro i cili është më i ultë në krahasim me kategorinë e investimeve me prioritet të lartë.

**Kategoria e investimeve me prioritet – Të Ulët:** nuk është vlerësuar asnjë investim në këtë kategori për periudhën e planifikuar 2022-2026.

*Tabela 8: Investimet e planifikuara në bazë të prioriteteve të vlerës mesatare për një projekt*

| Kategoria | I Lartë | Mesatar | I Ulët | Total |
|---|---|---|---|---|
| Vlera investimeve | 1,341,000 | 669,000 | - | 2,010,000 |
| *Në %* | *66.7%* | *33.3%* | *0.0%* | *100.0%* |
| Numri i projekteve | 5 | 3 | 0 | 8 |
| Mesatarja për një projekt | 148,875 | 83,625 | | 251,250 |

Projektet e vlerësuara në bazë të prioriteve janë bazë për monitorimin e aplikimit të planit si dhe ndikimin e planit në objektivat e përcaktuara të planit edhe për faktorët tjerë jo financiar.

*Tabela 9: Investimet e planifikuara të bazuara në prioritet për periudhën 2022-2026*

| Kategoria | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I Lartë | 600,000 | 300,000 | 241,000 | | 200,000 | 1,341,000 |
| Mesatar | 100,000 | 300,000 | 269,000 | - | - | 669,000 |
| I Ulët | - | - | - | - | - | - |
| **Total** | **700,000** | **600,000** | **510,000** | | | **2,010,000** |

## 7.7. Planifikimi i rrjedhës së parasë për investimet në mobilitet

**Investimet planifikohen të financohen kryesisht nga dy burime:**

- Buxheti komunal;
- Grantet qeveritare.

Mirëpo grupi punues nuk ka përjashtuar mundësinë e financimit nga donatorët. Prandaj plani i mobilitetit lenë të hapur alternativa se një pjesë e projekteve të financohet nga donatorët.

- Financimi nga burimet e buxhetit Komuna e Rahovecit janë në vlerë prej 669,000 e shprehur në përqindje 33.3%. Mjetet nga buxheti komunal janë të angazhuara përgjatë të gjitha viteve të planit (2022-2026);
- Financimi nga burimet nga Grantet Qeveritare janë në vlerë prej 1,341,000 Euro e shprehur në përqindje 66.7%. Financimi i projekteve është i planifikuar në periudhën e planit 2022-2026.

*Tabela 10: Burimet e financimit për periudhën e investimeve 2022-2026*

| Kategoria | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total | Në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Rahovecit | 300,000 | 100,000 | 100,000 | 89,000 | 80,000 | 669,000 | 33.3% |
| Grantet Qeveritar | 600,000 | 400,000 | 341,000 | - | - | 1,341,000 | 66.7% |
| Total | 900,000 | 500,000 | 441,000 | 89,000 | 80,000 | 2,010,000 | 100.0% |




*Grafiku 7: Paraqitja grafike e burimeve të financimit*

*Tabela 11: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2026 rrjedha e parasë*

| Nr. | Projekti | Kategoria | Prioriteti | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave | Siguria në komunikacion | I Lartë | 2,000 | 2,000 | - | 5,000 | - | 9,000 |
| 2 | Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | Sinjalizimi | I Lartë | 15,000 | 20,000 | 20,000 | 5,000 | | 60,000 |
| 3 | Krijimi i hapësirave për lëvizjen e sigurtë të këmbësorëve në rrugët ekzistuese | Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve | Mesatar | | - | - | 20,000 | - | 20,000 |
| 4 | Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve | Rregullimi i qarkullimit të këmbësorëve | I Lartë | 30,000 | 216,500 | 200,000 | | | 446,500 |
| 5 | Infrastruktura rrugore për person-at me mobilitet të zvogëluar | Infra. për persona me mobilitet të zvogëluar | Mesatar | 3,000 | 2,500 | 2,500 | | | 8,000 |
| 6 | Ndërtimi i kabinave te vendaljeve të auto- busëve | Rregullimi i qarkullimit të automjeteve | I Lartë | | - | 100,000 | - | | 100,000 |
| 7 | Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelal Hajda | Rregullimi i qarkullimit të automjeteve | I Lartë | | 50,000 | 50,000 | 10,000 | | 110,000 |
| 8 | Ndërtimi i rrugëve tranzite dhe rregullimi i rrugeve ne qytet | Rregullimi i qarkullimit të automjeteve | I Lartë | 100,000 | 900,000 | 256,500 | | | 1,256,500 |
| | **Total** | | | **150,000** | **1,191,000** | **629,000** | **40,000** | | **2,010,000** |

*Tabela 12: Tabela përmbledhëse e projekteve të planifikuara për periudhën e planifikuar 2022-2026 rrjedha e parasë*

| Masat | Qëllimi | Burimet e Financimit | Prioriteti | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave | | | | | | | | | |
| Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave | Qetësimi i trafikut | Komuna e Rahovecit | I Lartë | 2,000 | - | - | - | - | 2,000 |
| Ndërtimi i ishujve për rritjen e sigurisë në afërsi të shkollave | Qetësimi i trafikut | Komuna e Rahovecit | I Lartë | - | 2,000 | - | - | - | 2,000 |
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | | | | | | | | | |
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | Nr.i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal | Komuna e Rahovecit | I Lartë | 16,000 | - | - | - | - | 16,000 |
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | Nr.i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal | Komuna e Rahovecit | I Lartë | - | 20,000 | - | - | - | 20,000 |
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | Nr.i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal | Komuna e Rahovecit | I Lartë | - | - | 20,000 | - | - | 20,000 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | Nr.i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal | Komuna e Rahovecit | I Lartë | - | - | - | 20,000 | - | 20,000 |
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | Nr.i shenjave të vendosura dhe gjatësia/sipërfaqja e sinjalizimit horizontal | Komuna e Rahovecit | I Lartë | - | - | - | - | 20,000 | 20,000 |

| Masat | Qëllimi | Burimet e Financimit | Pri-oriteti | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ri-orientimi i qarkullimit** | | | | | | | | | |
| Riorientimi i qarkullimit | Infrastruktura e re e krijuar | Komuna e Rahovecit | Mesatar | | | | | | |
| **Ndërtimi i stacionëve të autobusëve** | | | | | | | | | |
| Ndërtimi i stacionëve të autobusëve | Numri i stacionëve të ndërtuara | Komuna e Rahovecit | I Lartë | | | | | | |
| **Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelal Hajda** | | | | | | | | | |
| Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelal Hajda | Numri i vendndaljeve | Komuna e Rahovecit | I Lartë | | | | | | |
| Krijimi i vendndaljeve në rrugën Xhelal Hajda | Numri i vendndaljeve | Komuna e Rahovecit | I Lartë | | | | | | |
| **Ndërtimi i rrugëve tranzite dhe rrugeve brenda zones urbane** | | | | | | | | | |

| Masat | Qëllimi | Burimet e Finacimit | Prioriteti | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ri-projektimi i udhëkryqëve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes se sigurisë | | | | | | | | | |
| Ri-projektimi i udhëkryqëve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes së sigurisë | Format e reja të rregullimit | Grantet Qeveritare | I Lartë | | | | | | |
| Ri-projektimi i udhëkryqëve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes së sig-urisë-Xërxë | Format e reja të rregullimit | Grantet Qeveritare | I Lartë | | | | | | |
| Ri-projektimi i udhëkryqëve me rrugën magjistrale – me qëllim të rritjes së sig-urisë-Krushë | Format e reja të rregullimit | Grantet Qeveritare | I Lartë | | | | | | |

# 8. MONITORIMI DHE RISHIKIMI

## 8.1. Monitorimi i planit të mobilitetit urban për vitin 2023

<table>
<tr><td></td><td>Masat</td><td colspan="2">SIGURIA NË TRAFIK - Masat për qetësimin e trafikut</td></tr>
<tr><td></td><td>Lokacioni</td><td colspan="2">Rruga________________________________________________</td></tr>
<tr><td></td><td>Karakteri</td><td>magjistrale/rajonale</td><td>lokale</td></tr>
<tr><td>1</td><td>Veprimet e pritura</td><td>- Ishujt në vendkalim për këmbësorë<br>- Masat tjera ____________________<br>1. ____________________</td><td>- gunga në rrugë<br>- shirita vibrues<br>- platforma<br>- disqe nga goma<br>- vetëm sinjalizim</td></tr>
<tr><td rowspan="3">Realizimi</td><td>PO</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>JO</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>PJESËRISHT</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="4">A është e nevojshme të përdoren masa tjera shtesë për qetësimin e trafikut</td></tr>
<tr><td colspan="4">PO          JO</td></tr>
</table>

Shënime shtesë:

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
________________________

Rahovec, më________________________

Përgjegjësi i monitorimit të PMU:

________________________

# Aneks I

Rëndom para gungës së parë të serisë ka shenjë për parandalim ose shenjë në rrugë. Sipas rregullave, këto elemente artificiale vihen nëpër gjysmën apo tërë gjerësinë e shiritit qarkullues të rrugës. Nëse vihen radhazi, distanca ndërmjet tyre mund të jetë prej 20 deri me 60 m, varësisht nga situata.

**Varësisht nga kufizimi i shpejtësisë, të njëjtat janë me dimensione siç vijon:**

- Deri me 50 km/h, gjerësia e tyre nuk guxon të jetë më e vogël se 60 cm, ndërsa lartësia nuk guxon të jetë më shumë se 3 cm;
- Deri me 40 km/h, gjerësia e tyre nuk guxon të jetë më e vogël se 90 cm, ndërsa lartësia nuk guxon të kalojë në 5 cm dhe
- Deri në 30 km/h, gjerësia e tyre nuk guxon të jetë me e vogël se 120 cm, ndërsa lartësia nuk guxon të kalojë në 7 cm.








**Vendndalja e Autobusëve**




**K U V E N D I I K O M U N Ë S R A H O V E C**

**01-Nr.___/23**
**Me datë:00.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**
**_________________**
**Kryesues i Kuvendit**

PLANI I MOBILITETIT URBAN
PËR KOMUNËN E RAHOVECIT
2022-2027



K U V E N D I  I  K O M U N Ë S   R A H O V E C

**01-Nr.___/23**
**Me datë:00.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**

**_____________________**

**Kryesues i Kuvendit**

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC**
**PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIT 2023**

| Objektivat | Aktiviteti | Treguesit e verifikueshëm | Rreziqet dhe supozimet | Periudha kohore |
|---|---|---|---|---|
| **Miratimi i planit të punës për vitin 2023 dhe përpilimi i raportit vjetor të punës për vitin 2022.** | Finalizimi i planit të punës 2023 dhe raportit për vitin 2022. | Plani i punës për vitin 2023 dhe raporti i punës për vitin 2022 të miratuar nga KK. | | Janar 2023 |
| **Përcjellja dhe shqyrtimi i rregullt i punës dhe veprimeve të organeve komunale dhe përpilimi i rekomandimeve në mbrojtje dhe promovim të drejtave të komuniteteve** | Shqyrtimi i pajtueshmërisë së të gjitha akteve normative, politikave, praktikave të kuvendit komunal me qëllim të sigurimit se të drejtat dhe interesat e komuniteteve mbrohen në tërësi. | Mbajtja e takimeve të rregullta (të paktën 12) të Komitetit për Komunitete dhe shqyrtimi i akteve normative komunale (nëse ka). | Mos thirrja e takimeve me rregull;<br><br>Mungesa e kuorumit në takime; | Janar - dhjetor 2023 |
| | Ngritja e çështjeve relevante si dhe përgatitja dhe adresimi i rekomandimeve në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të komuniteteve pranë organeve të komunës (KK, Drejtori përkatëse, Kryetar). | Numri i çështjeve dhe rekomandimeve të përgatitura dhe të adresuara tek organet relevante (kurdo që nevojitet). | Mos gatishmëria e anëtarëve të komitetit për komunitete që t'i ngritin çështjet tek organet komunale.<br><br>Mungesa e interesimit të organeve relevante për trajtim dhe marrje parasysh të rekomandimeve. | Janar - dhjetor 2023 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Vizitë vendbanimeve dhe shkollave ku jetojnë komunitet jo shumicë** | Vizitë vendbanimeve ku jetojnë komunitet Serb, Ashkali, Egjiptian dhe atij të Romëve me qëllim të diskutimit dhe identifikimit të problemeve me të cilat këta banorë ballafaqohen | Numri i vizitave në teren; Lista e problemeve të identifikuara. | Mungesa e interesimit të anëtarëve të komitetit për kryerje të vizitave | Mars – maj 2023 |
| | Vizitë shkollave me nxënës të komuniteteve Serb, Ashkali, Egjiptian dhe Romë. Takim në teren me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme. | Numri i shkollave të vizituara | Mungesa e interesimit të anëtarëve të komitetit për kryerje të vizitave;<br>Mungesa e gatishmërisë së drejtorëve për takim. | Maj -Tetor 2023 |
| | Të ftohet drejtori i drejtorisë së shërbimeve publike në takimin e radhës së komitetit për të raportuar lidhur me projektet për infrastrukturë në lagjet e banuara nga komunitetet pakicë gjatë vitit 2023 | Mbajtja e takimit dhe raporti i përgatitur nga drejtoria e shërbimeve publike | Mosgatishmëria e drejtorisë për takim. | Maj- Tetor 2023 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Takime me drejtorë të departamenteve të ndryshme** | Të ftohet zyrtari kryesor financiar që të raportojë për Kornizën komunale buxhetore – Shqyrtimi i mundësisë për ndarjen e buxhetit për nevojat e identifikuara gjatë vizitave në vendbanimet e banuara me komunitetet jo shumicë | Mbajtja e takimeve dhe raportet e drejtorisë së financave | Mosgatishmëria e drejtorisë për takim. | Qershor – shtator 2023 |
| | Të ftohet drejtori i drejtorisë së arsimit në takimin e radhës së Komitetit per Komunitete lidhur me temën regjistrimi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin shkollorë 2022/23 dhe masat për parandalim të braktisjes së mësimit nga nxënësit e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Romë. | Mbajtja e takimit dhe raporti i përgatitur nga drejtoria e arsimit | Mosgatishmëria e drejtorisë për takim. | Shtator 2023 |
| **Përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucionet publike** | Mbajtja e një takimi me kryetarin e komunës dhe me zyrtarët komunal për shërbime publike<br>Përkthimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare<br>Përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucione publike.<br>Të sigurohet përkthimi gjatë çdo takimi të komitetit për komunitete | Implementimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare. | Mos gatishmëria e anëtarëve të komitetit për komunitete që t'i ngritin çështjet tek organet komunale.<br>Mungesa e interesimit të organeve relevante për trajtim dhe marrje parasysh të rekomandimeve. | Janar – Dhjetor 2023 |
| **Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Qeverisë për integrimin e komuniteteve rom dhe në shoqërinë e Kosovës, 2021-2025** | • Takime të rregullta me KKV-ën, siç është paraparë me strategjinë përkatëse, për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Qeverisë për integrimin e komuniteteve rom, dhe Ashkali në shoqërinë kosovare, 2021-2025.<br>• Takime konsultative me komunitetet rom dhe Ashkali për identifikim të prioriteteve për vitin 2023<br>• Avokim për ndarje të buxhetit dhe monitorim të zbatimit të strategjisë përkatëse. | Takime të rregullat me të gjitha mekanizma lokale në komunë me qëllim të adresimit të sfidave rreth implementimit të planit të veprimit | Mos ndarja e buxhetit për implementimin e planit të veprimit si dhe mos zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Qeverisë për integrimin e komuniteteve rom, Ashkali dhe egjiptian në shoqërinë e Kosovës, 2021-2025. | Maj- Shator 2023 |
| **Shqyrtimi i raporteve të organeve relavante komunale** | Shqyrtimi i raporteve të Zyrtarit Komunal për Komunitete dhe Kthim | Numri i raporteve të dorëzuara te Komiteti për Komunitete dhe | Mos dërgimi i raporteve dhe mungesa e zyrtarit në takimet Komitetit për Komunitete. | Janar-dhjetor 2023 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | pjesëmarrja e zyrtarit në takime | | |
| | Shqyrtimi i raportit dhe planin e punes për Komisionin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) | Draft raporti i dorëzuar tek anëtarët e komitetit | Mungesa e draft raportit | Janar-dhjetor 2023 |
| **Përgatitja e raportit të punës për vitin 2023 dhe planit të punës për vitin 2024.** | Shqyrtimi, analizimi dhe aprovimi i raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023 dhe hartimi i planit të punës për vitin 2024. | Draft raporti për vitin 2023 dhe draft plani i punës për vitin 2024. | Mosgatishmëria e anëtarëve të komitetit për përpilim të raportit dhe planit të punës | Dhjetor 2023 |

**KUVENDI I KOMUNËS NËRAHOVEC**

**01-Nr.____/2023**
**Me datë:28.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**

**________________**
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.1.2023 (e hane)** me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.**Defrim Kafexhiu**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.
**Kryesuesi** – Fillimisht, përshëndetje për të gjithë. I nderuar Kryetar i Komunës **z. Smajl Latifi**, Nënkryetar i **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, media, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është seanca e parë (1) për këtë vit kalendarik. Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me 19 janar, për këtë seancë ka përgatitur këtë

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027;**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme në Komunën e Rahovecit;**
5. **Shqyrtimi Raportit Financiar për vitin 2022;**
6. **Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr.80/20 të datës 28.06.2020, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021;**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-01240-0 në zonën kadastrale Retijë;**
8. **Shqyrtimi i raporti për zbatimin e rekomandimeve te auditorit te përgjithshëm sipas Planit të Veprimit për vitin 2022;**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-05864-0;**
10. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-07111-1;**
11. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00251-0;**
12. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03710-0;**
13. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03818-0 dhe P-03819-0;**
14. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-02352-0;**
15. **Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit për vitin 2022;**
16. **Shqyrtimi i Raportit të Punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2022;**
17. **Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2022;**
18. **Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Komunitete për vitin 2022;**

**19. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2022;**
**20. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Arsim për vitin 2022;**

**Kryesuesi** – A ka ndonjë pyetje apo diçka të tillë, rreth rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për miratimin e rendit të ditës?... Me shumicë unanime miratohet rendi i ditës.

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** – Dikush prej anëtarëve të kuvendit ka diçka për të thënë rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë unanime miratohet edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues. Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, ekzekutivin, asambleistët. Fillimisht, besova që kryesuesi do ta falënderoj secilin asambleistë për suksesin në performancë, sepse prej 48 indikatorëve, 23 prej tyre janë të asamblesë komunale. Në anën tjetër i kam dy çështje; Çështja e parë është rreth stadiumit të qytetit. Sipas informatave që i kam, ekziston një marrëveshje në mes FFK-së dhe Komunës së Rahovecit që të rregullohet stadiumi derisa mund të zhvillohen ndeshjet, e më pas të rregullohet çështja e fushës tjetër. FFK e ka bërë investimin e saj, Komuna e Rahovecit nuk e ka bërë. Është fjala për rërë dhe bari që duhet vendosur. Kur do të bëhet dhe sa i përket stadiumit desha ta pyes kryetarit për ndonjë lëvizje rreth çështjes së lokacionit diçka definitive, sepse gjatë takimit tonë të përfaqësueseve të partive politike dhe ministrin, në fund kemi arritur një dakordimi në heshtje që të ecim tutje rreth një lokacioni të stadiumit dhe bashkarisht t'i japim zgjidhje çështjes së stadiumit të qytetit. Ne si LDK votojmë çdo herë për kur do të keni nevojë, në dakordim të plotë me sportistët dhe sportdashësit. Kam pasur shumë shqetësime rreth kompenzimit të bujqve dhe ekonomive familjare. Ka qenë një komision i komunës që e ka bërë një vlerësim të dëmit të vërshimeve, ka ankesa për laramani në kompenzim. Sa ka qenë vlerësimi i komisioneve të komunës për dëmet e shkaktuara?... Sa ka kompenzuar qeveria dhe sa komuna?... Në çoftëse nuk janë kompenzuar komplet, pse nuk janë kompenzuar?...

**Edona Kryeziu** – Përshëndetje kryesues, kryetar, të gjithë të pranishmit në këtë seancë. Një pyetje për drejtorin e arsimit në lidhje me shkollën fillore në Ratkoc. Ka të bëjë me gjendjen fizike të shkollës, për dritare. Informacionet që më kanë ardhur që disa dritare janë në gjendje të mjerueshme, kur do të rregullohen këto dritare?. Pyetje e dytë: Tualetet po në këtë shkollë kanë qënë në gjendje shumë të keqe, janë rinovuar pa proces tenderues dhe më intereson të jem në dijeni se si do të përfundohen pagesat dhe sipas jush kryetar, a është kjo shkelje ligjore?...

**Sejfullah Sejfullahu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, asambleistët. Kemi pak presion për dëmet e kompenzuara nga vërshimet, nëse ka ndonjë informatë drejtori i bujqësisë apo kryetari për këta të refuzuarit, a mund ta bëjnë ndonjë ankesëm, të paktën ta kemi një përgjigje për ata që na pyesin. E dyta, ka të bëjë rreht shkollës së Krushës, kur do të jetësohet?...

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë - anëtarë të kuvendit të komunës, ekzekutiv, qytetarë, media. Mbi një muaj ndiçimi publik në fshatin Hoçë e Vogël dhe Brestoc është jashtë funksionit. Në kohën e dimrit, kur ndriçimi është mëse i nevojshëm për fëmijët në rrugën kryesore, ka krijuar vështirësi. Kërkojmë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ta dijmë se ku është problemi dhe kush e mban përgjegjësinë e mirëmbajtjes. Kolegu Fatoni, potencoi që edhe në fshatin Celinë nuk punon ndriçimi publik e që është shumë i nevojshëm për atë lokalitet. Çështja tjetër ka të bëjë me identifikimin e vendbanimeve, në fshatra nuk janë të identifikuara.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues. Përshëndetje për juve, kryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorat, mediat dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Pyetja ime është rreth një kanali te rruga Fortesë – Celinë, si

do të vazhdojë të punohet, do të jetë kanal i hapur apo me gypa dhe kah do ta ketë rrjedhjen?... Pyetja e dytë, ka të bëjë rreth debatit të fundit rreth tatimit në pronë. Ne i dimë kompetencat dhe e dijmë që ministria e financave e bën vlerësimin e pronës, ne si kuvend komunal e bëjmë koeficientin dhe deshta ta dij që a jemi të goditur edhe ne si komunë? A keni ndërmarrë diçka si kryetar i komunës rreth kësaj çështje, duke marrë parasysh ngritjen globale të çmimeve, ka qenë edhe covidi dhe i bie që njerëzit kanë pasur dhe vazhdojnë të jenë në situatë mjaftë të keqe.
**Leonard Morina** – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, asambleistë. Së pari, e kam një vërejtje për juve kryesues, meqenëse materiali fizik nuk po na vie, ky material që po vjen online, zakonisht vjen 80% e materialit e kthyer mbrapa dhe nuk lexohet lehtë. Një pyetje e kam për drejtorin e kulturës, Afrimin. Në këtë dy vitet e fundit e kam parë që në disa fshatra janë rregulluar disa qendra sportive; Në Opterushë, Gexhe, Celinë, Zoqisht, Kramovik etj... Meqenëse projekti i Drejtorisë së Arsimit ka dështuar në shkollën tonë për rregullimin e fushës sportive, për shkak të operatorit të papërgjegjshëm dhe doja ta dija nëse ka projekt për një fushë sportive në Malësi të Vogël.
**Kryesuesi** – Faleminderit Leonard. Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë fjalën e ka kryetari për përgjigje.
**Kryetari** – Përshëndetje për kryesuesin, anëtarët e kuvendit, mediat, LMT-në, OSBE-në, nënkrytetarin, drejtorët. Urime viti i ri 2023, shpresojmë të jetë vit i mbarë dhe i suksesshëm. Faleminderit për pyetjet. Burim Krasniqi ka kërkuar sqarime rreth një marrëvjeshjeje potenciale që ne me kryetarit e Federatës së Futbollit e kemi arritur për ngritjen e kapaciteteve të reja për KF. Rahovecin. Ata e kanë marrë përsipër që ne ta gjejmë një prone, t'ua japim në shfrytëzim KF. Rahovecit dhe pastaj sipas kriteteve që i posedon federata, të invesoj me mjete financiare në bashkëpunim me komunën për ndërtimin e një stadium me standarte të përshtatshme për superligë. E kemi gjetur një prone në Xërxe, një pjese të klubit, larg po u duket te Epopeja, larg në Xërxë, në qytet nuk po mundemi të gjejmë prone dhe në muajin shkurt do të provojmë edhe t'i adresohemi kuvendit që t'ia japim për 40 vite. Do të isha i lumtur nëse dikush ka ndonjë ide për ndonjë vend më afër, por nuk ka vende afër dhe mbetet që vendi më i përshtatshëm të jetë në Xërxë.
**Burim Krasniqi** – Meqenëse jemi në process të PZHK-së, kërkoj mirëkuptim, a jemi në atë rrugë që mund t'i bëjmë zgjidhje stadiumit?
**Kryetari** – Për momentin nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve nuk ka lëvizje para, ndërsa ne po përpiqemi për lëvizjen para që e kemi me rastin e shqyrtimit publik të PZHK-së. Shpresojmë që ne do ta kemi ndonjë kërkesë të ndonjë operatori privat, të provojmë që ta adresojmë nevojën dhe domosdoshmërinë e zgjerimit të zonës ndërtimore për zhvillim ekonomik. Do ta kemi edhe një takim me anëtarët e kuvendit me datë 8 shkurt (10 ditë përpara) parapërgatitje për betejën finale që anëtarët e kuvendit mund të kenë ide, kontaktet me qytetarë dhe me biznese të adresohen, para se të votohet në kuvend. Me 8 shkurt do të jetë vetëm një pikë e rendit të ditës që ka të bëjë me konsultimin për PZHK-në. Unë vazhdoj të insistoj që stadiumi duhet të bëhet në Rahovec, përkundër faktit që në bashkëpunim me FFK-në mund ta bëjmë një stadium tjetër në Xërxë. Kur ta kemi qartësinë me kod, me shkresë, me njoftim, finalizimin e PZHK-së atëherë na luftojmë për vend. Te kompenzimi i dëmeve, nga 540 fermerë të dëmtuar ose të prekur nga vërshimet (të merremi vesh, fillimisht komuna jonë është refuzuar), pastaj në e kemi bërë një ankesë profesionale e cila e ka mundësuar rikthimin ose vendosjen e komunës tonë në rishqyrtim te komision shtetëror i ministrisë për dëme. Nga 540 fermerë të dëmtuar, 214 janë kualifikuar me rreth 795.000euro. 326 fermerë janë refuzuar. Kemi vazhduar me një ankesë tjetër, besoj që është e bazuar dhe në fillim të shkurtit të kemi një rezultat të ri. Po luftojmë edhe për 1.220.000 euro për aq sa mendojmë që iu takon. Në çoftëse dëmet kanë ndodhur me 17 shtator, diku me 25 ose 26 shtator ne i kemi dërguar raportet, por me 6 tetor nga Ministri Peci, është nënshkruar një udhëzim i ri administrativ, i cili ka ra në kundërshtim me raportet të cilat i kemi bërë. Po përpiqemi t'i akomodojmë kërkesat e reja që pështaten me udhëzimin e ri administrativ sepse vullneti është, ndoshta mund të jetë edhe ndonjë përjashtim sepse ndoshta është dikush që e ka "tepruar". Shpresojmë që secili fermerë ta realizoj të drejtën e kompenzimit si të gjithë të tjerët nga komisioni shtetëror.

**Burim Krasniqi** – A i ka marrë parasysh qeveria komisionet e komunës, që e kanë bërë vlerësimin? E dyta, komuna a ka pasë takatë për ndonjë kompenzim?...

**Kryetari** – Komuna nuk ka kompenzuar, nuk ka kompetencë sepse nuk ka fond emergjent, jemi në fillim të vitit dhe të premten është alokuar buxheti pasdite. Komuna për kompenzim nuk ka fuqi sepse bëhet fjalë për vlera financiare shumë të mëdha. Janë situata që besoj që duhet të definohen më mirë në të ardhmen. Edona Kryeziu rreth dritareve: Nuk besoj që mund të rregullohen nyjet sanitare pa ndonjë procedurë të prokurimit. Për ndërrimin e dritareve, besoj që sivjet do të kemi mundësi të bëjmë diçka. Sejfullah Sejfullahu sa i përket dëmeve, besoj që përgjigjen e more. Përurimi i shkollës fillore është projekt i Ministrisë së Arsimit. Komuna është në statusin e vëzhguesit. Euroing-u e ka fituar kontratën dhe do të ishte mirë që përurimi të ndodh në vigjilie të 17 shkurtit. Lirigzon Kastrati rreth ndriçimit publik: Edhe mua mu kanë drejtuar banorët e Hoçës Vogël që një segment i ndriçimit nuk funksionon, ndonjëherë problemi është te KEDS-i, ndonjëherë te disa sensorë. Qendra ka mbetur e patrajtuar me ndriçim publik siç kanë mbetur edhe disa vendbanime. Kontrata me operatorin ka përfunduar, kemi lidhur një kontratë të re (shërbime esco – fond Slloven). Këta e kanë për detyrë zgjerimin e ndriçimit (digjitalizimin) dhe mirëmbajtjen e tij. Rasim Fazliu, në detaje nuk jam i sigurtë, mund të të jep përgjigje edhe Berati, përndryshe qëllimi i atij kanali është të shkarkohet uji dhe të kullohen tokat. Te çështje e tatimit në pronë: E shfrytëzoj të drejtën në emër të gjithëve dhe mendoj që ndoshta në këtë fazë duke e parë aspektin ekonomik-social është më mirë të shfuqizohet vendimi i tatimit në pronë që është nënshkruar nga Ministri Murati. Rreth faljes së 100 eurove, kuvendet e komunës nuk falin tatim në pronë, falin taksa të ndryshme, qira. Tatimi në pronë është obligativ sepse ligji e thotë ashtu, nëse shkojmë me falje siç po flitet, atëherë 90% e qytetarëve nuk paguajnë sepse nuk u mbetet borxh më. Komuna jonë e ka normën më të ulët të tatimit në pronë 0.16%. Leonard Morina, rreth kontratës. Është e vërtetë që operatori e ka bërë punën keq, me operatorin në fjalë është ndërprerë kontrata dhe e kemi në plan që për Malësi të Vogël do ta bëjmë një fushë sportive me standarde më të mira.

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2023-2027;**

**Skender Hamza** – Faleminderit kryesues. Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarit, drejtorat, kuvendarët. Kryetari i komunës me datë 13.10.2022 ka marrë vendim për formimin e grupit punues për hartmin e planit për transparencë komunale 2023-2027. Ky grup punues ka hartuar këtë plan, i cili ka dalur në diskutim publik (30 ditë në ueb-faqe të komunës). Me datë 16.11.2022 me qytetarë është mbajtur një konsultim publik. Udhëzimi administrativ nr.03/2022 për transparencë në komunë, përcakton obligimin që komunat ta hartojnë planin 4 vjeçarë të veprimit për transparencë duke ndërmarrë veprime konkrete në promovimin dhe ofrimin e transparencës së plotë për mbledhjet e kuvendit të komunës, mbledhjet e komiteteve, takimet publike, transparencë në shpenzim të buxhetit të komunës, çasja e shpejtë në shërbime elektronike, procedura transparente e punësimit, përditësimin e aktiviteteve ditore në faqen zyrtare të komunës. Objektivat kryesore të këtij plani janë: Të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshierje në procesin e planifikimit dhe zbatimit të politikave dhe qeverisje llogaridhënëse. Zbatimi i planit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës.

**Kryesuesi** – Faleminderit Skender, a ka dikush ndonjë gjë rreth këtij plani?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2022-2027.

**4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme në Komunën e Rahovecit;**

**Lendrit Qeli** – Faleminderit kryesues. Të nderuar kuvendarë, më lejoni që në emër të ZKKK-së t'ju prezantoj Planin Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit 2023-2025. Ky dokument derivon nga strategjia për të zhvendosurit dhe kryesisht kemi të bëjmë me dy kategori të të kthyerve: Me kategorinë e zhvendosjes dhe të diasporës. Ky plan ka synim grupet e komunitetit joshumicë që ende janë jashtë republikës së Kosovës dhe i ka këto bjektiva kryesore: Ka për qëllim mbështetjen e personave që kanë dëshirë të kthimit në vendin e origjinës,

bashkëpunimin me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ofrimin e strehimit dhe asistencës sociale, forcimit të menakizmave ekzistues, dialogu ndër-etnik për personat e zhvendosur në komunën pranuese. Vlen të theksohet që të gjitha obligimet financiare janë në kuadër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe të Bashkimit Europian. Që ka viti 2009 deri më tani janë të trajtuara rreth 45 kërkesa, vetëm 5 prej tyre nuk kanë mundur të realizohen në mungesë të pronës. Rreth 111 anëtarë të kthyer deri më tani kanë gjetur mbështetjen në kuadër programit RRK5.
**Kryesuesi** – Faleminderit Lendrit. A ka dikush diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe Plani Komunal i Veprimit për të Zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme në Komunën e Rahovecit.
**5. Shqyrtimi Raportit Financiar për vitin 2022;**
**Afrim Limani** – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë. Për dallim prej viteve tjera, ky raport financiar vjetor është më i madh që i përfshin të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet financiare që kanë ndodhur gjatë vitit 2022. Ky raport i ka kontratat e nënshkruara dhe obligimet financiare – kontraktuale të cilat janë të shprehura në mënyrë analoge. Të hyrat e rregullta për këtë vit janë 1.256.000 dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njejtë të vitit të kaluar e kemi një ndryshim pozitiv prej 84.000 euro. Shpenzimi i buxhetit për vitin 2022 të total është prej 15.650.000 (95.10%). Pozicioni i pagave 95.45%, Mallra dhe shërbile 99.67%, komunali 99.76%, subvencione dhe transfere 95.20%, kapitale 93.01%. Në fund, si obligime financiare kemi: Mallra dhe shërbime 285.440, komunali 55.475, subvencione 18.364, investime kapitale 1.483.159.
**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues. Drejtor, faleminderit për raportin. Te të hyrat e planifikuara është qudi, ka realizim më pak sesa planifikim. Është interesant që në vazhdimësi kemi rënie të të hyrave për taksa për leje ndërtimi, ndërtime ka, kjo i bie që numri i ndërtimeve pa leje, apo çka është duke ndodhur?... Ka një diskrepancë në mes ndërtimit dhe lejeve që merren. Taksa për certifikata të lindjes janë paraparë 14.000, janë realizuar 3000 (planifikim shumë joreal). Taksa tjera administrative, janë paraparë 50.000 janë realizuar janë realizuar 28.000, 50% planifikimi është jasht asaj që është realizuar. Në bujqësi, ka të bëjë me subvencionimin në pajisje bujqësore që komuna e Rahovecit iu ka bërë bujqëve, 2021 ka qenë 20.000, në 2022 është bërë 100.000, a janë këto mjete bujqësore që janë paraparë në 2022, apo janë mjete bujqësore që janë ndarë në 2019-20-21 por që nuk iu keni dhënë, i keni mbajtur peng deri në 2022 dhe keni filluar t'i shpërndani duke e rritur participimin në bujqësi. Shërbimet e avokaturës vlerën totale e kanë kapur rreth 26.296 euro për 2022. Në anën tjetër kemi një rritje prej 16.000 në 35.000 të gjobave të gjykatave d.m.th prej 144 euro (2021) shërbimet e avokaturës janë rrit në kontratën e fundit 37.000. Në anën tjetër prej 16.000 që kanë qenë gjobat në 2021, këtë vit komuna i ka 35.271 euro gjoba prej gjykatës dhe nuk shihet ndonjë efekt përkundër shpenzimeve që kanë ndodh. Te çështja e shpenzimeve, mungojnë shpenzimet që kanë ardhur si rezultat i procedurave përmbarimore. Nuk e di a ka ndodhur përmes përmbarimit apo inspektoriatit, por arsimtarët e Opterushës dhe Krushës kanë marrë mjete prej komunës për shujta dhe udhëtim prej kontratës kolektive, këtu duhet të jetë shifra rreth 70.000 euro dhe te stafi i QKMF-së rreth 80.000 euro për shkak të punës jashtë orarit. D.m.th këto dy kategori nuk i pashë askund në raportin financiar. Në raportin financiar në tabelën 5.5, në faqen 31 thotë: Vlerat e mbetura të kontratës të papaguar, janë 17.532.879 (borxhe dhe kontrata të papaguara). Kjo nënkupton që në 2023-2024 dhe në gjysmën e 2025-tës nuk duhet të kemi kontrata të reja sepse përafërsisht aq është buxheti për investime kapitale përveç nëse kemi ndonjë grant specifik. E treta, është shqetësuese, kemi kontrata të papaguara të 2018-2019-tës. Këto janë total jashtë prokurimit sepse një kontratë sipas ligjit të prokurimit nuk mund të jetë më e gjatë se 3 vite. Te subvencionet, pa dashur të keqkuptohemi, Qemajl Krasniqi është zyrtar i komunës dhe po e shoh që komuna i ka mbetur edhe 900 euro borxh për subvencionim, cili është ky subvencion?. Një shqetësim tjetër, te korrigjimi i kontratave dhe në bazë të tabelave dhe materialit që na keni dhënë, del që të gjitha kontratat kanë korrigjim. Në faqe 18; Ndërtimi i sheshit qëndror, kontrata e lidhur me 14.12.2022 afati i zbatimit 30.07.2025 dhe vlera e kontratës 3.817.347 euro. Janë

paguar 180.000euro!. Cilat punë janë bërë në shesh që janë paguar këto mjete?. Avansin me ligj ndoshta mund ta shpjegosh, por 180.000 euro është vlerë e mirë sa i përket çmimit të kontratës në total.
**Lirigzon Kastrati –** Faleminderit kryesues. Pasiqë kam analizuar raportin financiar 2022, konstatoj se kemi një keqadministrim të buxhetit komunal në pjesën e të hyrave dhe shpenzimeve dhe veçanërisht te pjesa e kontratave të nënshkruara dhe obligimet që nuk janë paguar. Kërkoj nga ekzekutivi sqarim se cilat lloj të të hyrave komunale nuk ka mundur t'i realizoj sepse siç shihet nga paraqitja tabelare figuron shuma prej 92.000 euro e cila nuk mund të arkëtohet dhe çfarë masa konkrete do të ndërmerren në realizimin e tyre. Është shumë e nevojshme të sqaroheni se në cilat drejtime keni ngecje në arkëtimin e të hyrave komunale duke pasur parasysh që për këtë çështje keni marrë vërejtje nga auditori i jashtëm. Nga detyrimet, komuna është e obliguar rreth 11.000.000 duke lidhur kontrata me shumë operatorë. Mendoj që veprimi i tillë dëmton buxhetin e komunës dhe ka efekt direkt edhe te shërbimet e qytetarëve në përgjithësi. Çfarë ka ndodhur me kontratat e vitit 2020-2021 pasiqë të njëjtat nuk figurojnë në këtë raport. Kjo ndoshta mund të jetë e ligjshme, por është e padrejtë për qytetarët që të presin me vite të tëra për përfundimin e një projekti që i shërben pikërisht atyre. Në lidhje me këto dua t'ju rikujtoj që auditori i jashtëm i ka gjetur disa të gjetura duke dhënë disa rekomandime. Nga e gjithë kjo gjendje, jam kundër keqmenaxhimit që po zë vend ndërvite në qeverisjen komunale.
**Sejfullah Sejfullahu –** Faleminderit kryesues. Te obligimet e taksave kur u përmend nga Lirigzoni, të cilin e ka shok, është mirë që ekzekutivi ka bërë tolerancë, sepse ka shumë qytetarë që nuk kanë mundësi t'i paguajnë taksat, ka afaristë që i kemi punët shumë keq, duke u nisur nga vetvetja, i pari jam që kam borxhe (taksë komunale) dhe i pari jam që shes pajisje me kilogramë që t'i paguaj taksat përmarimore. Afaristët në Rahovec që jemi në gjendje të keqe, jemi rreth 80% dhe është mire që ka pak tolerancë sa i përket taksave.
**Leonard Morina –** Faleminiderit kryesues. I kam 2-3 pika që më kanë lënë përshtypje te raporti. Te tabela A, kodi 1370 për karburante për vetura, për vitin 2022 komuna ka shpenzuar 12.124 euro karburante dhe nëse e shikojmë i bie 1000 euro për muaj që nuk po më duket shumë, por ajo që më bëri përshtypje është që Zyra e Kryetarit 50% të këtij buxheti e ka shpenzuar në derivate me 5 drejtori tjera. A po iu kryen punët 5 drejtorive, apo po punon sa 5 drejtori, pse gjysmën e buxhetit të karburantëve e keni shpenzuar? Apo është ndonjë matematikë që ne nuk po e kuptojmë. Te tabela C, te kodi 13133 te Drejtoria e Arsimit, shpenzimet e tjera për udhëtime zyrtare, mesa e di unë janë disa kontrata për bartjen e nxënësve. Te raporti i obligimeve, te tabela 5.1 mallra dhe shërbime, rreth 90% nuk janë bërë pagesat për shkak të vitit fiskal, po e vërejta që në qershor kanë ndodh obligimet dhe viti fiskal përfundon në dhjetor. Një pikë tjetër është te drejtoresha e Inspekcionit, është e vetmja që e ka realizuar punën 1781%, ka planifikuar 1000 euro dhe ka arritur t'i grumbulloj 17.000 euro.
**Rasim Fazliu –** Faleminiderit kryesues. Falënderoj edhe drejtorin e financave për një raport të mjaft të thukët. Janë bërë dy gabime të vogla pa qëllim, e kemi në faqen 4, shtylla e dytë, për mendimin tim duhet të jetë "gjobat e trafikut për vitin 2022" e këtu shkruan "gjobat nga e trafikut 2022". Rubrika e tretë është ndyshimi 2022-2022. Faqe 6, e kemi tatimin në pronë, me një vend ndryshe, me një ndyshme, ka dallim në shifra te planifikimi dhe është mirë ta përmirësoni. Në çoftëse dalim te përqindja e realizimit të buxhetit për vitin 2022, buxheti është realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme 97.19%. Një sqarim rreth këtyre kodeve ku shkruan "mirëmbajtja rutinore"? Drejtor, kemi disa kontrata të lidhura brenda vitit 2022, si psh: Instalimi i jashtëm i ujit, rrymës dhe kanalizimit në qerdhen për fëmijë në Krushë të Madhe, furnizimi me material shpenzues mjekësor për nevojat e QMF-së, furnizimi me karriga stomatologjike dhe ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit. Ajo çka më intereson është te lidhja e kontratës psh: kontrata është lidhur 27.05.2022 dhe përfundon me 22.11.2022 i bie që këto kontrata janë kryer brenda vitit dhe po e shoh këtu prapë i keni mbet borxh. Pse kanë mbetur këto borxhe kur në buxhet të vitit 2021 për 2022 janë paraparë që këto kontrata të paguhen.
**Kryetari –** Faleminiderit. Është fakt që ne e kemi përmbushur planin e të hyrave, madje e kemi kaluar. Askush nuk e mohon faktin që kemi obligime kontraktuale, borxhe financiare dhe sfida tjera. Auditori na ka rekomanduar

t'i vazhdojmë sigurimin e ekzekutimit të kontratave për kontratat e skaduara dhe për operatorët që nuk i kanë përfunduar punët. Mos ta harrojmë faktin që ka qenë edhe pandemia dhe rritja e çmimeve ka krijuar vështirësi shtesë për komunën, operatorët dhe shtetin. Leonardi - Shumë karburantë po hargjon kryetari. Është e vërtetë që kryetari punon dhe punon më shumë se plotë kryetarë të komunave të Kosovës. Karburante i japim zjarrfikësve, organizatës së veteranëve të luftës, klubeve sportive, SHL-Kosovës, OJQ-ve të ndryshme kur kanë aktivitete etj... Të gjitha këto duke u bazuar në rritjen e çmimeve të karburantit. Rasimi e ngirit çështjen e borxheve. Kur kemi kontata që kanë mbetur edhe pak pa u paguar e konsiderojmë pagesën me bartje të buxhetit. Mendoj që menaxhimi i buxhetit është bërë mirë dhe nuk po synojmë të themi në mënyrë perfekte sepse jemi duke i parë gabimet që po na tregojnë auditorët, kuvendi dhe qytetarët, prandaj jemi duke tentuar t'i mbulojmë dobësitë. Sa i përket transparencës buxhetore, sivjet jemi të parët në nivel vendi.

**Rasim Fazliu –** Unë e ceka që ka kontrata që janë të lidhura në vitin 2022, të njëjtin vit kanë përfunduar, por nuk janë paguar, pra i keni mbetur borxh. Gjithashtu obligimet janë gati 13 milion euro, vetëm 1 milion e diçka janë paguar. tjerat jo dhe kjo është shqetësuese dhe problem për komunën.

**Kryetari –** Pikërisht, operatori e ka kryer punën, por nuk ka ardhë me faturë ta bëjë tërheqjen e parave. Normal që këto borgje ngelin sepse nuk kemi situacion për pagesë. Kemi kësi lloj situata shpesh, përndryshe të gjitha projektet ndër vite janë planifikuara me mbulueshmëri financiare nga komuna, pa e llogaritur që mund të marrim edhe mjete shtesë nga qeveria. Shpresoj që nuk do të kemi situata problematika të veprimeve përmbarimore që do të na dëmtonin pozicionin e projekteve në komunën tonë.

**Leonard Morina –** Nuk thash që ka hargjuar kryetari buxhet shumë, por më bëri përshtypje që Zyra e Kryetarit e ka hargjuar 50% të buxhetit dhe më bëri të kuptoj që ndoshta ka diçka në mes të rreshtave. Kryetari e sqaroi, faleminderit kryetar.

**Bejtullah Deliu -** Faleminderit kryesues, kryetar, zëvendës, drejtora, të pranishëm. Kryetar, deshta të ndërlidhem me sqarimin që e dhatë në pyetjet e parashtruara në atë se ju nuk i bëni pagesë të punës pa e përfunduar punën. Paraprakisht te sheshi qëndror 180.000 euro janë paguar ende pa e filluar punën, mos është kontradiktë sqarimi juaj?... Te mallra dhe shërbimet kodi 13401 / Shërbimet e arsimit dhe trajnimit – huamarrja, për vitin 2021 janë shpenzuar 10.602 euro, në 2022 asnjë cent. A thu që arsimi nuk ka nevoj për trajnime dhe është stabilizuar mjashtueshëm apo si qëndron puna?...

**Kryetari –** Pyetjes së parë, Bejtullah, po i përgjigjem shkurt, avansi është diçka tjetër i bazuar në ligj, ndërsa punën e pakryera kur ekziston kontrata nuk mund t'i paguajmë pa situacion. Ne e kemi dhënë avansin sepse kemi rrezikuar që ato para të shkojnë në suficit në qeveri. Me bazë ligjore ia kemi dhënë kontraktuesit të sheshit, si dhe për dy shkolla tjera, aneksin në Ratkoc dhe shkollën në Xërxe.

**Burim Krasniqi –** Pajtohna plotësisht me Bejtullahun te çështja e avanseve. Tabela 5.5, ndërtimi i qerdhes në Ratkoc janë diku edhe 91.000 euro të papaguar të kontratës. Zgjerimi i ndriçimit në Rahovec, kontratë e 2019-tës janë edhe 206.000 obligime të papaguara d.m.th. këto janë kontrata që e kanë kaluar afatin ligjor 3 vjeqare, nuk janë paguar borxhet, por është dhënë avansi.

**Kryetari –** Në çoftëse ne kemi para në shesh, duhet ta marrim vendimin e kuvendit që ti bartim diku tjetër apo jo, po quditna se Burimi e din shumë mirë se çka po them. Prej sheshit qëndror nuk mund t'ia japim ndriçimit publik sepse kontrata për sheshin qëndror është lidhur me 14 dhjetor, ndërsa kontrata për ndriçimin publik është lidhur në 2019-tën. Me 23 dhjetor mbyllet viti edhe mënyra më e mirë si t'i shpëtojmë këto para ka qenë që t'ia japim avans.

**Kryesuesi –** Vazhdojmë me pauzë deri në ora 13:15 ...

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimit të Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr.80/20 të datës 28.06.2020, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021;**

**Afrim Oruqi -** Faleminiderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit. Bëhet fjalë për nenin 17 në rregullore për taksa dhe tarifa, paragrafi 7. Shuma që është në rregulloren për taksa dhe tarifa në vlerë prej 600 euro,

zëvendësohet në 500. Neni 17 i rregullores bazike pas pikës 8 shtohet pika 9 me tekstin si në vijim; Dhënia e vërtetimit për taksë afariste, taksa 5 euro. Bëhet fjalë për shërbim të ri në ofrimin e vërtetimit për taksë afariste. Neni 5. Bëhet fjalë për nenin 20 në rregullore për taksa dhe tarifa, pra rregullorja bazike pas fjalës "tokë" i shtohet fjala "pronë". Neni 6. Neni 21 paragrafi 1 i rregullores nr.0899 shuma prej 500 euro zëvendësohet në shumën prej 100euro. Neni 7. Neni 24 paragrafi 1 i rregullores riformulohet me takstin si në vijim; Vërtetimet sipas PZHK-së –lloji i destinimeve të tokave të tjera, ky është formulim që i përshtatet akteve tjera që kanë fuqi më të lart sesa rregullorja. Neni 8. Neni 28 i rregullores bazike ndryshohet dhe plotësohet. Do t'i lexoj vetëm udhëzimet që mos marrim kohë t'i lexojmë shërbimet. Bëhet fjalë për UA të Ministrisë së Mjedisit me nr. 11/19 për ndarjen e ndërtesave dhe pjesave të ndërtesës, me nr. 12/10 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, UA me nr. 09-2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës, bëhet fjalë për UA 05-2021 për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 09-2020. Pra, të gjitha këto udhëzime që i përmendëm specifikojnë saktë shërbimet dhe shumën e pagesës. Vazhdojmë me nenin 9. Neni 28 paragrafi 1, pika 8 dhe 9 të rregullores bazike; Shuma 3 euro, zëvendësohet me shumën 3 euro për metër katror, bëhet fjalë për shërbimin dhe shumën e njejtë, prej menakizmave kompetent është kërkuar që te rubrika që parasheh çmimin, të shtohet edhe metri katror. Neni 10. Neni 29 paragrafi 2 i rregullores bazike ndryshohet dhe riformulohet si në vijim; Bëhet fjalë për shërbimet që i ofron drejtoria e shërbimeve publike për reklamat e vendosura në shtyllat e ndriçimit publik deri në 1m katror (2 euro copa), në hapësirë tokësore deri në 4m katror me taksë vjetore në vlerë prej 100 euro, taksa vjetore në vlerë prej 200 euro është kur reklama është deri në 12 metra katror. Bilbordat në hapësirë tokësore deri në 15 metra katror është vlera 300 euro viti. Vendosja e transparentëve reklamues, taksë mujore 15 euro dhe vendosja e shpalljeve dhe publikimeve është taksa vjetore 25 euro. Neni 11. Neni 31 paragrafi 1 i rregullores bazike, pas pikës 25 shtohet pika 26 me këtë tekst; Vendosja e shtyllave elektrike, taksë prej 10 euro. Neni 12. Neni 34 i rregullores bazike pas paragrafit 4, shtohet paragrafi 5 me këtë tekst; Lirohen nga taksa e vlerësimit për dëmet në bujqësi nga komisioni, personat fizik dhe juridik në raste të fatkeqësive natyrore. Neni 13. Bëhet fjalë për nenin 36 të rregullores për taksa dhe tarifa, paragrafi 1, pika 3 e rregullores bazike, riformulohet me këtë tekst; Kërkesa për plotësimin e kushteve minimale higjieniko-teknike për subjekte afariste. Neni 36 paragragi 1, pika 7,8,9 fshihen nga teksti bazik i rregullores për taksa komunale, bëhet fjalë për shërbime që kanë kaluar në kompetenca të AVUK-ut. Neni 14. Neni 38 paragrafi 1 i rregullores bazike pas pikës 8, shtohet pika 9 me këtë tekst; Dhënia e vërtetimit, referencat për OJQ-të që ushtrojnë veprimtari në komunën e Rahovecit, taksa 2 euro është vlerë e re në rregullore. Vazhdojmë me nenin 15, bëhet fjalë për nenin 41 i rregullores bazike, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim; Ndaj çdo subjekti afarist i cili nuk i përfill procedurat kundërvajtëse do të zhvillohet procedura përmbarimore. Neni 16 është neni i parafundit, pas miratimit nga kuvendi i komunës, ndryshimi dhe plotësimi i rregullores për taksa komunale do të jetë pjesë e tekstit bazik të rregullores në fuqi. Neni 17 propozimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit. Ftoj anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit të këtyre propozim-ndryshimeve që burojnë nga udhëzimet administrative të ministrive përkatëse t'i votoni propozimet dhe ndryshimet në rregulloren e re.

**Kryesuesi** – Faleminiderit drejtor, a ka dikush diçka në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime, bashkë me përmirësimet teknike votohet pika e gjashtë.

**7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-01240-0 në zonën kadastrale Retijë;**

**Afrim Oruqi** – Në mbështjetje të ligjeve në fuqi, kryetari i komunës ju propozon shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës me nr. 1240-0 në zonën kadastrale në Retijë (23 ari e 12 metra katror, kulturë – kullosë e klasit të dytë). Qëllimi është rreth inicimit të procedurave për shpronësim të parcelës, kjo parcelë menaxhohet prej

AKP-së dhe zyra e kryetarit ka pranuar një kërkesë nga këshilli i fshtatit Retijë për inicim të procedurave për ta kthyer në pronësi të komunës.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë pyetje rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e shtatë.

**8. Shqyrtimi i raporti për zbatimin e rekomandimeve te auditorit te përgjithshëm sipas Planit të Veprimit për vitin 2022;**

**Afrim Limani** – Përshëndetje edhe një herë. Rreth raportit financiar që u ngritën disa pyetje; Burimi ngriti disa pyetje, rreth planifikimit d.m.th joharminizimi. Në raport të hyrat totale kanë rritje rreth 92.000, mirëpo në të hyrat e rregullta inkasimi është 94%, kemi zvogëlim sepse ka ndikuar tatimi në pronë apo vendimi i kryeministrit për heqjen e kushtëzimit me rastin e regjistrimit të veturave. Te certifikatat e lindjes janë disa kode që regjistrohen të hyrat, planifikimin e kemi bërë në mënyrë të rregullt dhe përafërsisht ka dalë ashtu. Te shpenzimet përmbarimore janë kryesisht aty që lidhen me kontratën kolektive. Te obligimet kontraktuale, nuk jemi rasisht komuna në vend të parë sa i përket transparencës buxhetore sepse të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet janë të përfshiera në këtë raport financiar. Vlera e kontratave të lidhura është 26.280.000 euro d.m.th mbetje kanë mbetur edhe 17.532 euro. Në kuadër të obligimeve kontraktuale, 1.2 milion janë mallra dhe shërbime, 596.000 janë subvencione kur i zbresim këto, obligimet kontraktuale mbesin 15.729.000 euro. Pagesa për ndërtimin e sheshit, realisht aty nuk janë 160.000 por përafërsisht 150.000. E kemi bërë pagesën sepse ligji i prokurimit në nëntor 10% në dhjetor 5%. Këto mjete kanë qenë nga granti dhe shumë mirë kemi bërë sepse mjetet në fjalë kanë qenë të rrezikuara të shkojnë në suficit. Te subvencionet për z. Qemajlin, kryetari si çdo kë tjetër edhe Qemajlin e ka subvencionuar për botimin e një libri, nuk kemi mundur t'ia bëjmë pagesën edhe pse mjetet kanë qenë, por janë disa procedura që duhet të regjistrohen me sistem në të cilin ka vonesa.

**Burim Krasniqi** – Faktikisht sipas asaj që the te investimet i kemi 15 milion obligime, në KAB për tri vite 2023-24-25 janë rreth 20 milion dhe the që na stabilizojnë mirë financiarisht. A nënkupton kjo që në 2023-24-25 nuk bën komuna të shpallë më shumë se 5 milion kontrata, që ta bëjmë balancimin financiar. Po flasim si investim për tri vitet e ardhshme.

**Afrim Limani** – Faleminiderit shumë për pyetje dhe konsideroj që është me vend. Në fillim thash që obligimet kontraktuale aktualisht janë 15.7 milion, këto obligime vetëm me buxhetin e vitit 2023-2024 mbulohen, përveç buxhetit të vitit 2025 që e kemi 7 milion dhe për këtë arsye e kemi stabilitetin financiar, duke e ditur që granti çdo vit rritet me një përqindje të konsiderueshme.

Kalojmë në pikën e zbatimeve e zbatimit të rekomandimeve të auditorit; Siç jeni në dijeni edhe ju pasqyrat financiare për vitin 2022 kanë rezultuar me 14 rekomandime. Pas pranimit të raportit, ne si qeveri komunale me vendim të kryetarit e kemi formuar një komision për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe kemi mbajtur takime të shumta. Në bazë të veprimeve, konsiderojmë që 7 rekomandime janë zbatuar dhe 7 të tjera pjesësisht dhe janë në process të zbatimit.

**Bejtullah Deliu** – Përshëndetje i nderuar kryesues, desha të ndalem tek çështja e vonesave në realizimin e projekteve. Kontrata për rregullimin e shtretërve dhe lumenjve që është lidhur me 6 dhjetor 2018 dhe ka përfunduar me 61% të realizimit në 2021. Për këto tre vite që nuk është kryer ky projekt dhe vërshimet që kanë qenë, a ndjeheni si komunë fajtore, sepse ka mundur të ketë më pak vërshime nëse punët kishin përfunduar me kohë. Një kontratë tjetër për pastrim dhe mirëmbajtje higjienike me ftesë njëburimore rreth 50.000 euro, pse është lidhur në këtë formë, ndoshta ka mundur të menaxhohet më ndryshe.

**Kryetari** – Kontrata për pastrues ka skaduar, ndërkohë kontrata e re nuk është lidhur për shkak të vonesave në procedura dhe mungesa e OSHP-së. Ne e kemi kërkuar një leje prej Autoritetit Qëndror të Prokurimit, që ta zhvillojmë një kontratë me negocim për disa muaj. Kjo është e gjetur e auditorit edhe pse veprimi ynë ka qenë ligjor sepse në raste të veçanta kemi të drejtë për kontrata me negocim. Pse kanë mbetur pa u kryer punët?... Kam

folur shumë herë për këtë temë, kanë mbetur sepse janë rritur çmimet dhe kanë shkaktuar ngecje, madje në disa komuna janë pezulluar të gjitha kontratat e vjetra për shkak të çmimit. Në shtator kemi pas përmbytje, por mos harroni që në janar jo, sepse kanë vazhduar punimet në pastrim të kanaleve të shumta, duke e zvogëluar shumë potencialin e vërshimeve të mundshme në të ardhmen. Rreth 6 milion kemi kontrata për trajtim të shtretërve dhe përrojve problematik. Sa i përket rekomandimeve të auditorit, këtë të gjetur e kemi marrë shumë seriozisht dhe kemi filluar t'i planifikojmë mjetet në mënyrë që kontratat të kenë mbulueshmëri financiare. Zbatimi i kontratave dhe koha e zbatimit të tyre varen edhe nga 2-3 faktorë të tjerë të jashtëm. Unë nuk jam njeri që e përfaqësoj konceptin e ankesave, po janë shumë para që hargjohen dhe duhet të gjejmë mekanizma që ta rrisim mbështetjen për projekte të tilla, në mënyrë që të evitohet maksimalisht rrezikun nga vërshimet. Granti do të rritet dhe besoj që ne do të marrim projekte nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe nga ministritë e caktuara, ku do të kemi mundësi ta shfrytëzojmë mundësinë për projekte të reja dhe ta stabilizojmë shlyerjen e obligimeve që janë në proces.

**Bejtullah Deliu** – Faleminderit kryetar, më mirëkuptove saktë. Pyetja ime ishte shumë direkte. Në 2018, kur është lidhur kontrata është paraparë buxheti dhe puna dinamike e asaj pune, tani gjatë fjalimit e cekët që tani pas punës tonë, vërshimet janë më të pakta. Vetëm deshta të kthehem që prej 2018-2021 nuk po qëndron ajo që çmimet kanë qenë të larta, por dinamikat e punës është dashur të rrjedhin siç janë paraparë me plan-projekt dhe kjo gjendje që ka ndodhur tani "me më pak vërshime" ka mundur të ndodh edhe në 2018-2019-2021. Pyetja ime ishte se a ndiheni fajtor që kjo kontratë nuk ka mund të zbatohet në përpikmëri? ...

**Kryetari** – Fatkeqësitë natyrore mund t'ia ngarkojmë edhe vetes, por vetëm për përgjegjësi morale. Përgjegjësi për planin institucional kanë institucionet qëndrore dhe agjencitë sepse nëse i kishim pritë qeveritë se kur kanë pasur plan të investojnë në përroi në Fortesë, në Drinin e Bardhë, përroin në Ratkoc, në Xërxe e në Krushe, ne sot ende do të ishim mbi vërshime dhe duke u marrur me dëme. Ne kemi vepru si Komunë, qeveritë e kaluara nuk na kanë ndihmuar, as kjo e sotit, shumë e thjeshtë.

Ne sipas kërkesës dhe kritereve të MAPL-së për grant të performancës duhet ta shqyrtojmë raportin e adresimit të rekomandimeve dhe luftojmë që në fund të kemi opinion të pakualifikuar, opinion ky i cili do të na binte 2 milion euro për vitin 2022. Mendoj që ka qenë veprim jo i drejtë dhe tendencioz sepse të gjitha dokumentet kanë shkuar së pari për t'u filtruar në Ministrinë e Financave që udhëhiqet nga Hekuran Murati. Kodet kanë qenë të lejuara nga ata dhe i bie që me gabimet e tyre, jemi dënuar ne me opinion të kualifikuar. Ndërsa raporti i vitit 2022 jam i bindur që do të jetë i pakualifikuar dhe në të gjitha parametrat do të jemi të parët ose të dytët.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues. Uroj që komuna do t'i zbatojë të gjitha rekomandimet. Nëse më lejohet, desha të ndërlidhem te çështja e shtretërve të lumenjve. E potencove shtratin e lumit që i lidhë pesë fshatra. Vitin e kaluar 60.000 euro janë ndarë, a keni bërë diçka me ato mjete?...

**Kryetari** – Jo, sepse operatori nuk ka pasë vullnet për punë, ka qenë aneks memorandum.

**Burim Krasniqi** – Faleminderit, rreth raportit mbi zbatimin e rekomandimeve. Kur po flas, kuptomni drejt, jo në kuptimin e gjykimit por në kuptimin e asaj që kemi rezultate më të mira herave tjera. Te çështja A2, përdorimi joadekuat i procedurës së prokurimit, keni thënë që është i zbatuar. Këtu ka të bëjë me kontratat e negociuara. Unë prej E-prokurimit i kam pa rreth 10 kontrata të negociuara në komunën e Rahovecit në 2022. Ndërtimi i rrugëve dhe këndeve rekreative - lagjeve të komuniteteve, kontrata e lidhur me 15.12.2022 me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës. Izolimi i objekteve të zjarrfikësve, Ndërtimi i infrastrukturës për aktivitete kulturore në Dejn etj… Çështjen e kontratave të pambuluara financiarisht e diskutuam gjatë, por besoj që stabiliteti financiar do t'iu bëjë vendin e duhur. Te zotimi i mjeteve jo sipas procedurave financiare, thotë: Pjesërisht i zbatuar, pse pjesërisht i zbatuar? Është qëllimi që raporti mos të jetë i kualifikuar, nuk është gjykim sepse ka shumë tema që nuk pajtohemi, por kjo është me rendësi për të gjithë qytetarët. Te çështja C1, pagesa shtesë 30% në mungesë të shtimit të pozicionit, pjesërisht e zbatuar, te 2022 është dashur të jetë e zbatur dhe jo pjesërisht,

sepse është kontrata, është shtuar 30%-shi, vetëm duhet shtuar numri i punëtorëve dhe bëhet zbatimi i plotë. Procedura e alokimit të mjeteve nuk mund të jetë pjesërisht e zbatur, duhet të jetë e zbatuar sepse procedurë, nuk është diçka që të mbanë peng gjithë kohën.

**Kryetari** – Kontrata me shtretërit është rekomandim i zbatuar dhe këtu është një gabim teknik total, sepse ajo ka vlerë deri në prill 2022 dhe nuk ka më kontratë të re të asaj natyre. Çështja e kontratave të negociuara, iu tregova cilat janë lidhur në pandemi, diçka për furnizime. Tani punët shtesë quhen kontrata me negocim. Në këtë drejtim, ne jemi duke luftuar ti ikim punëve shtesë sepse duhet më shumë të angazhohemi më shumë në projekte më të detajizuara. Te zotimi i mjeteve, pjesërisht e zbatuar, po, sepse ne kemi procedura të cilat fare nuk janë në planin vjetor të prokurimit. Supozojmë sot na thirr Ministri i Pushtetit Lokal dhe thotë merre një projekt, ne këtë rast ne nuk e kemi planifikuar, nuk kemi zotuar mjete, projekti po vjen "qyl". Pra, të gjitha këto gjëra i kemi sqaruar me auditorë. Opinioni i pakualifikuar është luftë, jo vetëm për prestigj, por është edhe mundësi e mirë për përfitime të shumta që mund t'i kenë qytetarët.

**Kryesuesi** – Faleminderit kryetar, atëherë po e kalojmë këtë pike dhe kalojmë te pika e nëntë.

**9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-05864-0;**

**Afrim Oruqi** – Falemininderit kryesues. Të nderuar anëtarë të kuvendit, e kam një propozim për ju. Janë gjashtë pika sot, që e kanë tematikën e njejtë për formimin e komisioneve për t'i dhënë me qera këto parcela. Ligji e kërkon që paraprakisht për secilën parcelë të formojmë nga një komision, i cili do t'i zhvillojë procedurat për vlerësimin e ofertave. Nëse jeni të pajtimit unë i prezentoj gjashtë në një pako. Sipas zyrës ligjore në MAPL, i njejti asambleist mund të përfshihet në disa komisione.

**Kryesuesi** – Drejtor, e prezanton secilin vendim dhe gjatë prezantimit i përfshijmë edhe emrat e të deleguarve.

**Afrim Oruqi** – Sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovës, para jush keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, bëhet fjal për zonën kadastrale në Rahovec P-05864-0 (20 ari – shfrytëzim 10 vite).

**Kryesuesi** – Atëherë i ftoj grupet e asambleistëve që ta japin një propozim, mund të shkojmë me rotacion dhe të kemi mirëkuptim mes grupeve. Armir Vuçitërna dhe Doruntina Sopjani nuk mund të marrin pjesë, sepse janë në komision për ankesa, gjithë të tjerët po.

**Hasan Përboqi** – Në emër të grupit të AAK-së, propozojmë asambleistin Feriz Thaqi.

**Leonard Morina** – LVV për këtë pike nuk ka propozim.

**Edona Kryeziu** – LDK propozon Lirigzon Kastratin.

**Sejfullah Sefullah** – PDK propozon Melinda Iska – Oruqin.

**Kryesuesi** – Nëse kemi më shumë se dy propozime, duhet t'i vendosim në votim. I kemi 3 propozime; Feriz Thaqi (AAK), Lirigzon Kastrati (LDK) dhe Melinda Iska (PDK).

Kush është për Ferizi? ... Lirigzon Kasttratin? ... Melinda Oruqin? ... Atëherë, Feriz Thaqi dhe Melinda Ouriqi me nga 16 vota "për" janë pjesë e komisionit, Lirigzon Kastrati 9 vota.

**10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-07111-1;**

**Afrim Oruqi** - Sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovës, para jush keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, bëhet fjal për zonën kadastrale në Rahovec P- 07111-1 (88 ari e 10 metra katror).

**Kryesuesi** – Falemininderit drejtor.

**Hasan Përboqi** – AAK për këtë komision e propozon përsëri Feriz Thaqin.

**Leonard Morina** – LVV nuk ka propozim.

**Edona Kryeziu** – LDK nuk ka propozim.

**Melinda Iska** – PDK propozon Sejfullah Sejfullahun.
**Kryesuesi** – Atëherë, dy përfaqësues nga kuvendi i komunës për këtë komision janë; Feriz Thaqi dhe Sejfullah Sejfullahu. E vendosim në votim pikën e nëntë e rendit të ditës. Kush është për?... Atëherë po 19 vota aprovohet. Vazhdojmë me pikën e dhjetë, kush është për?... Me 20 vota "për" miratohet edhe kjo pikë.
**11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00251-0;**
**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues. Sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovës, para jush keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Çifllak me nr. P-00251-0 (11 ha, 42 ari e 30 metra katror)
**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor.
**Hasan Përboqi** – AAK propozon Valmir Gashin.
**Leonard Morina** – LVV nuk ka propozim.
**Edona Kryeziu** – LDK gjithashtu nuk ka propozim.
**Sejfullah Sefullahu** – PDK propozon Melinda Iska Oruqin.
**Kryesuesi** – Atëherë po e vendosim në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës, me të deleguarit prej kuvendit komunal, Valmir Gashi (AAK) dhe Melinda Oruqi (PDK). Kush është për?... Me shumicë unanime miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.
**12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03710-0;**
**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec (6 ari e 16 metra katror), P-03710-0. Ftoj anëtarët e kuvendit që t'i propozojnë anëtarët e komisionit.
**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor.
**Hasan Përboqi** – AAK, nuk kemi propozim.
**Leonard Morina** – LVV, propozon Sinan Kryeziun.
**Edonë Kryeziu** – LDK, nuk kemi propozim.
**Melinda Oruqi** – PDK, propozon Sejfullah Sejfullahun.
**Kryesuesi** – Atëherë dy anëtarë të deleguar nga kuvendi për këtë komision Sinan Kryeziu dhe Sejfullah Sejfullahu. Si të tillë po e vendosim në votim, kush është "për" ?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e 12-të e rendi të ditës.
**13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-03818-0 dhe P-03819-0;**
**Afrim Oruqi** - Faleminderit kryesues. Sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovës, para jush keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec P-03818-0 dhe P-03819-0, parcela e parë i ka 31 ari 96 metra katror, e dyta 11 ari e 59 metra katror.
**Kryesuesi** – Faleminiderit drejtor.
**Hasan Përboqi** – AAK, propozojmë Drilon Mustafën.
**Leonard Morina** – LVV, nuk kemi propozim.
**Edonë Kryeziu** – LDK, propozojmë z. Eqrem Spahiun.
**Melinda Oruqi** – PDK, nuk ka propozim.

**Kryesuesi** – Faleminiderit për mirëkuptim. Atëherë dy të deleguar për këtë komision janë Drilon Mustafa dhe Eqrem Spahiu. Po e vendosim në votim si të tillë, kush është "për"?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e 13-të e rendi të ditës.

**14. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-02352-0;**

**Afrim Oruqi** - Faleminderit kryesues, është vendimi i fundit dhe para jush keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec, P-02352-0 (48 ari e 47 metra katror).

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor.

**Hasan Përboqi** – AAK, e propozojmë asambleistin Afrim Berisha.

**Leonard Morina** – LVV, propozojmë Sinan Kryeziun.

**Edonë Kryeziu** – LDK, propozojmë Faton Ramadanin.

**Sejfullah Sejfullahu** – PDK, propozojmë znj. Melinda Iska.

**Kryesuesi** – Atëherë, meqenëse i kemi 4 propozime, po i vendosim në votim. Afrim Berisha-është i propozuari i parë?... Sinan Kryeziu?... Faton Ramadanin?... Melinda Oruqin?... Atëherë Afrim Berisha me 20 vota dhe Sinan Kryeziu me 16 për, janë anëtarë nga kuvendi i komunës në këtë komision. Me këtë përbërje po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 14-të.

**15. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kuvendit për vitin 2022;**

**Kryesuesi** – Fillimisht, kisha kërkuar nga shefat e grupeve që t'i njoftojnë anëtarët e tyre të kuvendit që çdo mungesë e paarsyeshme dhe pa nënshkrim në listën e fundit të seancës, do t'i ndalet mëditja, sepse është e vetmja formë që ngrit përgjegjësinë.

Dimë që Kuvendi Komunal funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Planin e Punës. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë organet kryesore të komunës, të dyja zgjidhen veç e veç me vota të drejtpërdrejta të qytetarëve. Qëllimi i Raportit të Punës së Kuvendit për vitin 2022 është që të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien. Në fillim të mandatit, kuvendi krijon dy komitete obligative, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete dhe sipas nevojës krijon edhe komitete të konsultative dhe të tjera. KPF në periudhën janar-dhjetor 2022 ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje të rregullta. Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë 17, prej tyre 12 seanca të rregullta (100 vendime, 2 rregullore, 9 plane, 1 statut dhe 1 program, gjithnjë në monitorim të vazhdueshëm nga MEDIA-t, OSBE, SHL-Kosova, KFOR-i, OJQ-të, dhe MAPL), në muajin shkurt 1 seancë komemorative, në mars 1 seancë solemne, në qershor, tetor dhe dhjetor poashtu nga 1 seancë solemne. Në përgjithësi Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratur 128 akte. Prej 100 vendimeve (do t'i veçoja tre prej tyre; Themelimi i çmimit "Ukshin Hoti", miratimi i kornizës afatmesme buxhetore 2023-2025, si dhe vendimin për miratimin e buxhetit për 2023), secili prej tyre është përcjellur në MAPL për ligjshmëri. Janë shqyrtuar 71 vendime, prej tyre 8 janë kthyer dhe si kuvend komunal jemi të obliguar t'i shqyrtojmë sipas rekomandimeve të MAPL-së. Raporti i dedikohet të zgjedhurve, qytetarëve, monitoruesve dhe publikut të gjërë. Mirëpresim kontributin e secilin përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo dobësive eventuale, duke i bërë bashkërisht përmirësimet e nevojshme.

**Sejfullah Sejfullahu** – Faleminderit kryesues, më pëlqeve që e permende shpalljen e vendimit "Ukshin Hoti". Jam kureshtar ta dij, a jemi ne legjislatura më e mirë se ajo e kaluara!

**Kryesuesi** – Besoj që Kuvendi Komunal për vitin kalendarik 2022 ka funksionuar në mënyrë shumë të drejtë dhe në frymën e duhur.

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues. Raporti nuk ka faqe (numra rendor), do të ishte mirë t'i kishte. Në faqe 19, te tabela përmbledhëse është një gabim teknik, është periudha janar-dhjetor 2022, jo 2023.
**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues. Nuk pata ndërmend të flas, faleminiderit për motivimin. Po e ndërlidhi me arsim. Një ditë erdhi një inspektor i arsimit në orë, për ta parë sesi po e mban orën mësimore mësimdhënësi, (ta zëmë që mësimdhënësi isha unë). Në atë moment nxënësve iu thash t'i nxjerrin librat për t'i lexuar, gati përfundoi ora duke iu thënë, lexo ti, lexo ti. Inspektori në fund tha: Zotëri edhe një "qoban i bagëtive" e din këtë mënyrë për ta përfunduar orën mësimore. Në rregull jemi, kalova me një vërejtje. Kjo i bie që anëtari i kuvendit nuk do.të thotë që e kryen detyrën e tij, nëse vijnë pikat e rendit të ditës, e ngrit dorën edhe kryehet seanca. Mendoj që çdo anëtarë i kuvendit duhet ta jep një kontribut të veçantë në diskutimin e pikave të rendit të ditës. Aktiviteti dhe kontributi i të gjithë kuvendarëve që kanë qenë aktiv është i pasyqyruar dhe për këtë flasin procesverbalet.
**Kryesuesi** – Faleminderit Rasim Fazliu. Po e plotësoj pak veten në raportin për vitin 2022. Falenderoj ekzekutivin për bashkëpunimin dhe raportimin, çoftë ligjor apo me vullnet. Këshillën e Rasim Fazliut ia vlenë ta marrim si inkurajim edhe për anëtarët tjerë që nuk kanë marrë pjesë në diskutime, ta kryejnë përgjegjësinë që e kanë. Falenderoj poashtu edhe Sekretarinë e Kuvendit për punën e palodhur që e bëjnë për gjatë tërë vitit.
**Hasan Përboqi** – E kam një kritikë dhe një kërkesë. Kritika për ju është që shkoi viti dhe nuk e kemi të paktën një fotografi zyrtare. Kërkesa ka të bëjë me atë që mund ta realizojmë brenda vitit, te pjesa e mureve në sallën e kuvendit si kujtim të shënohen emrat e asamblesitëve që kanë qënë nëpër legjislatura.
**Sejfullah Sejfullahu** – Edhe unë e kam një kritikë dhe një kërkesë për kryetarin. Të na dërgoni edhe neve me ndonjë trajnim pune ose hulumtim. Prizreni ka shkuar në vizitë hulumtuese edhe pse janë me nivel më të ulët në krahasim me asamblenë tonë.
**16. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2022;**
**Senad Mullaavda** – Përshëndetje për kryesuesin, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, të pranishmit. Këshilli i fshatit funksionon në bazë të ligjit Nr 03L039/2008 për zonat e veçanta të mbrojtura. Procesi i zgjedhjes së anëtarëve është bërë në kuvend me datë 31.05.2022. Me atë vendim është formuar këshilli i fshatit me 5 anëtarë. Janë mbajtur gjithsej 6 mbledhje, 4 kanë qenë të rregullta, 1 konstituive dhe 1 urgjente. Në fund i falënderojë të gjithë për kontributin e dhënë.
**17. Shqyrtimi i Informatës rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2022;**
**Kryetari** – Faleminderit shumë. Informatën e keni para vetes. Ne e kemi përmbushur planin e takimeve për 2022. Mekanizmi i KKSB-së është i rëndësishëm. Është dominuar tema e pandemisë, vlerësimi i sigurisë së përgjitshme në komunë, lirimi i hapësirave publike – trotuarëve, shkelësit e ligjit, uzurpimet. Në këtë mekanizëm marrin pjesë OJQ-të, policia, bizneset, përfaqësuesit e FSK-së, përfaqësuesit e bashkësive fetare. Për 2023 do të jenë dy pika standart për trajtim në çdo takim. Rrjedha e lumenjve në komunën tonë dhe Siguria rreth ushqimeve.
**18. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Komunitete për vitin 2022;**
**Bajram Morina** – Faleminderit kryesues. Përshëndetje për kryetarin, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë kuvendarët. Në kuadër të Komitetit për Komunitete e kemi bërë realizimin e planit të punës në plotni. Kemi mbajtur vizita në terren, komunikim të vazhdueshëm me të gjitha drejtoritë dhe me Zyrën për Komunitete dhe Kthim, për të gjitha adresimet që kanë të bëjnë me komunitetin joshumicë në komunën tonë. Para vetes e keni materialin dhe mbesim me shpresë për vazhdimin e komunikimit të përbashkët konstruktiv. Faleminderit.
**19. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2022;**
**Vlora Vuçiterna Çmega** – Përshëndetje për të gjithë. I nderuar kryetar, nënkryetar, kryesues i kuvendit, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë. Ky raport është për periudhën shtator 2022 – dhjetor 2022. Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është themeluar me vendimin e kuvendit të komunës me nr 326/22 i datës 31 maj 2022. Kryesuese jam unë (LVV), Shukrije Himaj (AAK), Lirigzon Kastrati (LDK), Armir Vuçiterna (PDK) dhe Edmond Kabashi (Ekspert i jashtëm). Komiteti ka mbajtur gjithsej 3 takime të rregullta, e para me 16 shtator,

e dyta me 28 tetor dhe mbledhja e tretë me datë 25 dhjetor 2022. Komiteti, duke pasur parasysh kërkesat e institucioneve të vizituara gjatë kësaj periudhe tre mujore, i propozon Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që t'i ketë si rekomandime kërkesat, me qëllim të plotësimit të nevojave duke reflektuar pozitivisht edhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

**Burim Krasniqi** – Besoj që komisionet e kanë rolin e vet edhe pse kanë qenë në funksion për një periudhë të shkurtër. Në këtë rast Komiteti për Shëndetësi i ndihmon Drejtorisë për Shëndetësi, ndoshta zyrtarët përgjegjës janë të gatshëm të japin më shumë informata dhe të njëjtit ta ndihmojnë drejtorinë për të qenë më e kompletuar në shërbime shëndetësore dhe sociale. Te QPS-ja dhe mungesa e stafit profesional. Kryetar, ndoshta nuk është adekuate por përafrohet, në Drejtorinë për Bujqësi e keni të angazhuar në punë një sociologe dhe më e arsyeshme do të ishte nëse ajo punon në QPS ose në Drejtori të Arsimit. Ia mundëson ta kryj punën, të avancohet profesionalisht gjithashtu. Kërkoj që, nëse nuk mund ta keni me punë të rregullt, aty ku janë shërbimet e veçanta, të shihen mundësitë e kompletimit të këtij stafi.

**Kryetari** – Besoj që jeni të informuar që QPS është e dëmtuar në kuadro sepse ka sfida, Bylbyl Oruqi ka dhënë dorëheqje, Edmond Kabashi gjithashtu, dikush tjetër ka dalur në pension edhe e kemi pas të bllokuar konkurset deri në vitin 2022. Kuadrot po përpiqemi t'i mbajmë, por po na ikin nëpër gjithë Kosovën. Informata me rekomandime që ka dhënë Komiteti për Shëndetësi është mjaftë e dobishme.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, ekzekutiv, kolegë anëtarë. Kryesuesja e paraqiti raportin për aq sa kemi pasur mundësi ta kryejmë punën. E kemi diskutuar që këtyre qendrave të ndihshme, si grup i asambleistave në të ardhmen duhet patjetër t'u ofrojmë përkrahje pa dallime partiake. Këto ambulancat të cilat janë jashtë funksionit, së paku duhet ta bëjnë një punë me reduktime (dy herë në javë – vizita).

**20. Shqyrtimi i Raportit të Punës se Komitetit për Arsim për vitin 2022;**

**Fahrije Lushi Morina** – Faleminderit kryesues. I nderuar kryetar, këshilltarë, drejtorë të drejtorive, gjithë të pranishëm. Komiteti për Arsim është themeluar në periudhën e fundit (4 mujorin e fundit të vitit) dhe ka përbërje prej 5 anëtarëve. Fahrije Lushi Morina (LDK), Ellma Hamza (PDK), Leonard Morina (LVV), Alban Bajraktari (AAK), Xhevdet Morina (ekspert i arsimit). Kemi mbajtur gjithsej 3 mbledhje. E para është mbajtur më 16 shtator 2022 (zgjedhja e kryesueses), mbledhja e dytë më 14 tetor 2022 (përpilimi i listave të shkollave për vizitë), mbledhja e tretë 21 nëntor 2022 (kemi trajtur temat rreth nivelit të shkollimit të komunitetit RAE - bullizmi). Synimi i Komitetit për Arsim ka qenë që të marrim nga afër shqetësimet dhe vështirësit që hasin nxënësit dhe mësimdhënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kemi marrë parasysh edhe shkallën e arritshmërisë në shkollat e komunës sonë. Kemi arritur të realizojmë takime në 7 shkolla. Në shkollën e mesme "12 Maji" – Ratkoc, në shkollën fillore e mesme e ulët "Mustafë Ibishi" – Kramovik, në shkollën fillore e mesme e ulët "Hamëz Thaqi – Xërxë, në shkollën e mesme "Ukshin Hoti"- Krushë e Madhe, në në shkollën fillore e mesme e ulët "Isa Boletini" – Rahovec, në shkollën fillore e mesme e ulët "Gëzim Hamza – Piktori" – Rahovec dhe në shkollën fillore e mesme e ulët "Lidhja e Prizrenit" – Opterushë. Në përgjithësi në të gjitha shkollat, shqetësuese ka qenë rënie e numrit të nxënësve, gjendja e nyjeve sanitare, gjithashtu edhe dukuritë tjerë si bullizmi, incidentet, mungesa e sigurisë dhe dhuna në shkolla. Një rekomandim i veçantë nga drejtori i shkollës "Gëzim Hamza" dhe shkon për DKA-në dhe kryetarin e komunës, që nxënësve t'u ofrohet një objekt i ri shkollor.

**Kryesuesi** – Po më vie shumë mirë që këto dy komitetet tjera po funksionojnë dhe i inkurajoj për më shumë produktivitet në të ardhmen.

**Kryetari** – Faleminderit Fahrije Lushi, jam dakort me të gjeturat. Funksioni i këtyre komiteteve është rekomandim që mund t'i adresohen në këtë rast DKA-së dhe Drejtorisë, Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe gjithsesi edhe kuvendit për raportim. Më bëri përshtypje që drejtori i shkollës "Gëzim Hamza" ka kërkuar objekt të ri. Nuk ka kërkuar objekt të ri, por hapësirë për fushë sportive - oborr dhe bëhet fjalë për një pronë (20 ari) e cila duhet të trajtohet në kuvend.

Në plan e kemi të gjitha shkollat t'i fusim në efiçiencë dhe sa i përket funksionimit të mjediseve fizike në shkolla, me ndihmën e Fondit të Kosovës për Eficiencë me Energji dhe pak si komunë. Faleminderit shumë Fahrije dhe Vlorë, si dhe ju inkurajojë të formoni edhe ndonjë komitet tjetër.
**Kryesuesi** – Faleminderit kryetar. Atëherë me përfundimit e kësaj pike, po përfundon edhe seanca e parë e rregullt për këtë vit kalendarik. Lista e nënshkrimeve është këtu. Mirëmbetshi.

**Procesmbajtësi:** **K R Y E S U E S I**

______________________
**Albion Krasniqi**

______________________
**Defrim Kafexhiu**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
III- Nr. I prot / Br. prot. 438 Më / Dt. 08.02.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

# KOMUNA E RAHOVECIT

## RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE - KONTRATAT KORNIZË

Konform nenit 82. ... të Ligjit Nr. 04/L-042, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë

| Data e përgatitjes së raportit: | 08.02.2023 | Viti fiskal: | 2022 |
|---|---|---|---|

### PJESA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

| | |
|---|---|
| Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues | Komuna e Rahovecit |
| Lloji i Autoritetit Kontraktues | Qeveritar |
| Kodi buxhetor | 623 |
| Adresa | Rr. "Xhelal Hajda - Toni" p.n. |
| Kodi postar - Qyteti | 21000 - Rahovec |
| Tel. fiks/ Celulari /Faksi | 038/200-45316 |
| Emri i menaxherit të prokurimit | Astrit Mullabazi |
| E-mail adresa | prokurimi.rahovec@rks-gov.net & prokurimi.rahovec@gmail.com |
| Adresa e webit të AK | http://kk.rks-gov.net/rahovec/ |

### PJESA II. KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

| Lloji i Buxhetit: Të Hyra Vetanake (1) ose Buxh.i Kons.i Kosovës (2) ose Donacion | Nr.i Prokurimit: Numri rendor i prokurimit | Numri brendshëm i prokurimit | Lloji i prokurimit | Vlera e prokurimit | Procedura e prokurimit | Klasifikimi (2 shifrat e para të FPP) | Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës (ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Afatet për implementimin e kontratës (shkruaj daten e fillimit dhe të përfundimit) | Data e përmbylljes së kontratës (data e pranimit të përkohshëm/preliminar) | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Çmimi i Aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Zbritjet nga kontrata për shkak të ndalesave | Çmimi total i paguar për kontratën | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata | OE vendor (1) jo vendor (2) | Numri i kërkesave për DT | numri i ofertave të dorëzuara | Numri i ofertave të refuzuara (shkruaj vetëm ato me çmimin më të ulët në krahasim me fituesin) | Afati kohor për pranimin e ofertave: Afati kohor normal (1) Afati kohor i shkurtuar (2) | Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët (1) Tenderi ekonomikisht më i favorshëm (2) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | | | | | 24 | 25 |
| 2 | 1304 | 001 | 5 | 2 | 1 | 45 | SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE | 25.02.2022 | 03.03.2022 | 04.08.2022 | 11.08.2022 | 11.08.2022 - 10.08.2025 | 10.08.2025 | € 150,000.00 | € 150,000.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | N.SH. "Liriu", Brig.123, SUHAREKË | 1 | 31 | 6 | 1 | 1 | 1 |
| 2 | 1399 | 002 | 1 | 2 | 1 | 28 | FURNIZIM ME REKUIZITA SPORTIVE PËR SHKOLLA | 01.03.2022 | 04.03.2022 | 27.04.2022 | 29.04.2022 | 29.04.2022 - 28.04.2023 | 28.04.2023 | € 22,000.00 | € 18,214.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | Grup i Operatorëve Ekonomik: MB TEXTILE SH.P.K.; MEBLI DIZAJN SH.P.K., Xhelal Hajda Toni, p.n., Rahovec | 1 | 21 | 5 | 3 | 1 | 1 |
| 2 | 1723 | 005 | 2 | 2 | 1 | 60 | SHËRBIMET E ZHVENDOSJES ME MARIMANGË DHE BLLOKIMIT TË AUTOMJETEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT | 01.03.2022 | 11.03.2022 | 13.04.2022 | 20.04.2022 | 20.04.2022 - 19.04.2024 | 19.04.2024 | € 30,000.00 | € 30,000.00 | € 0.00 | € 0.00 | 21.80 Euro - Çmimi për njësi | "XONI" SH.P.K., Brigada 123, Suharekë | 1 | 7 | 1 | 0 | 1 | 1 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 2161 | 007 | 2 | 2 | 1 | 93 | ASGJËSIMI I BARNAVE ME AFAT TË SKADUAR | 10.03.2022 | 22.03.2022 | 05.05.2022 | 12.05.2022 | 12.05.2022 - 11.05.2023 | 11.05.2023 | € 21,950.00 | € 21,880.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | "PRINCI COMPANY" SH.P.K., Ilaz Kodra 119, Prishtine | 1 | 8 | 2 | 1 | 1 | 1 |
| 2 | 3932 | 011 | 1 | 2 | 1 | 33 | FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF – së LOT I – FURNIZIM ME MATERIAL REAGENSA SHPENZUES PËR LABORATOR | 26.04.2022 | 06.05.2022 | 11.08.2022 | 25.08.2022 | 25.08.2022 - 24.08.2023 | 24.08.2023 | € 30,000.00 | € 30,000.00 | € 0.00 | € 0.00 | 963.40 Euro - Çmimi për njësi | Atom - Med, Uran Tinova p.n., FERIZAJ | 1 | 16 | 2 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 3932 | 011 | 1 | 2 | 1 | 33 | FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF – së LOT II – FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PËR STOMATOLOGJI | 26.04.2022 | 06.05.2022 | 11.08.2022 | 25.08.2022 | 25.08.2022 - 24.08.2023 | 24.08.2023 | € 7,231.00 | € 7,231.00 | € 0.00 | € 0.00 | 83.72 Euro - Çmimi për njësi | PRO MEDICAL SH.P.K., Rr. Kadri Zeka, Ferizaj | 1 | 16 | 3 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 3932 | 011 | 1 | 2 | 1 | 33 | FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF – së LOT III – FURNIZIM ME BARNA AMPULLARE EMERGJENTE MATERIAL SANITAR | 26.04.2022 | 06.05.2022 | 14.10.2022 | 20.10.2022 | 20.10.2022 - 19.10.2023 | 19.10.2023 | € 59,408.00 | € 59,408.00 | € 0.00 | € 0.00 | 20.90 - Euro - Çmimi për njësi | MADEKOS SH.P.K., Vragoli ( Magjistralja Prishtinë-Pejë), Fushë Kosovë | 1 | 16 | 5 | 1 | 1 | 1 |
| 2 | 3932 | 011 | 1 | 2 | 1 | 33 | FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES MJEKËSOR PËR NEVOJAT E QKMF – së LOT IV – FURNIZIM ME OKSIGJEN | 26.04.2022 | 06.05.2022 | - | 11.08.2022 | - | - | € 1,112.32 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | ANULIM | 1 | 16 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 5495 | 020 | 5 | 2 | 1 | 77 | LOT 1 - INVESTIME DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT | 01.06.2022 | 08.06.2022 | 13.07.2022 | 19.07.2022 | 19.07.2022 - 18.07.2024 | 18.07.2024 | € 66,578.69 | € 64,901.77 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | EKO-DRINIA SH.P.K., Ratkoc, RATKOC | 1 | 31 | 5 | 1 | 1 | 1 |
| 2 | 5495 | 020 | 5 | 2 | 1 | 77 | LOT 2 - INVESTIME DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE GJELBËRUESE, PARQE, VARREZAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT | 01.06.2022 | 08.06.2022 | 13.07.2022 | 19.07.2022 | 19.07.2022 - 18.07.2024 | 18.07.2024 | € 34,357.94 | € 31,453.18 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K., Sheshi Ilmi Maliqi, RAHOVEC | 1 | 31 | 5 | 2 | 1 | 1 |
| 2 | 6019 | 021 | 5 | 2 | 1 | 77 | MIRËMBAJTJA E SHTIGJEVE TË ECJES NË KOMUNËN E RAHOVECIT: DENJË, KRUSHË E MADHE, GRADISH, DRENOC, RAHOVEC (SHTEGU TE ZHDRELLA, SHTEGU TE MAJA E SHKODRANIT) DHE PASTRIMI I LUMIT BIQEC NË RATKOC | 13.06.2022 | 17.06.2022 | 10.08.2022 | 16.08.2022 | 16.08.2022 - 15.08.2023 | 15.08.2023 | € 42,323.50 | € 25,481.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | EKO-DRINIA SH.P.K., Ratkoc, RATKOC | 1 | 24 | 10 | 1 | 1 | 1 |
| 2 | 8650 | 024 | 2 | 2 | 1 | 93 | OFRIMI I SHËRBIMEVE JURIDIKE LIGJORE PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT - Ritenderim | 23.06.2022 | 25.08.2022 | 15.09.2022 | 19.09.2022 | 19.09.2022 - 18.09.2024 | 18.09.2024 | € 124,000.00 | € 124,000.00 | € 0.00 | € 0.00 | 470.11 Euro - Çmimi për njësi | Oruçi & Associates L.L.C., Rruga Sheh Mihedini, p.n, Rahovec | 1 | 13 | 1 | 0 | 2 | 1 |
| 2/3 | 9534 | 027 | 1 | 2 | 1 | 28 | FURNIZIM ME MATERIAL NDËRTIMOR PËR RENOVIMIN E SHTËPIVE TË KOMUNITETEVE JOSHUMICË NË KOMUNËN E RAHOVECIT | 08.07.2022 | 13.09.2022 | 19.10.2022 | 20.10.2022 | 20.10.2022 - 19.12.2022 | 19.12.2022 | € 25,000.00 | € 24,246.74 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | Grup i Operatorëve Ekonomik: Lulzim Eq. Gashi B.I.; AR – TECH SH.P.K., P.n. Hajdin Berisha, Suharekë | 1 | 21 | 2 | 0 | 1 | 1 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot I – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN ZATRIQ – RAHOVEC DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | 23.08.2022 | 31.08.2022 | 31.08.2022 - 30.06.2023 | 30.06.2023 | € 7,175.00 | € 7,175.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | AUTO TAXI NASER SHABANI, ZATRIQ, ZATRIQ | 1 | 9 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot II – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN MRASOR – KRAMOVIK DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | 23.08.2022 | 31.08.2022 | 31.08.2022 - 30.06.2023 | 30.06.2023 | € 6,440.00 | € 6,440.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | ALBIN REXHEPI B.I., Mrasor, Mrasor | 1 | 9 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot III – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN RAKOVIN – KRAMOVIK DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | 23.08.2022 | 31.08.2022 | 31.08.2022 - 30.06.2023 | 30.06.2023 | € 10,304.00 | € 10,304.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | Dervish Hasanaj B.I., Rakovinë, Gjakovë | 1 | 9 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot IV – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN KAZNIK – PASTASEL DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | 23.08.2022 | 31.08.2022 | 31.08.2022 - 30.06.2023 | 30.06.2023 | € 5,796.00 | € 5,796.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | ADEM FEJZAJ B.I., Koznik, Rahovec | 1 | 9 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot V – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN HOÇË E MADHE – RAHOVEC DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | 23.08.2022 | 31.08.2022 | 31.08.2022 - 30.06.2023 | 30.06.2023 | € 5,152.00 | € 4,968.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | VLADIMIR MORAVCEVIC I.B., Rahovec, Rahovec | 1 | 9 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot VI – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN GURI I KUQ - KRAMOVIK DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | 23.08.2022 | 31.08.2022 | 31.08.2022 - 30.06.2023 | 30.06.2023 | € 5,337.50 | € 5,337.50 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | D.P.Z. "Fonex", Kramovik, Rahovec | 1 | 9 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot VII – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN RETI E POSHTME - PIRANË DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | 23.08.2022 | 31.08.2022 | 31.08.2022 - 30.06.2023 | 30.06.2023 | € 5,796.00 | € 5,796.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | VALMIR MUSTAFA B.I., Randobrave, Randobrave - Prizren | 1 | 9 | 1 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 7552 | 032 | 2 | 2 | 1 | 60 | BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONET PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 Lot VIII – BARTJA E NXËNËSVE NË RELACIONIN VRAJAK, BRATOTIN – RATKOC DHE ANASJELLTAS PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023 | 25.07.2022 | 26.07.2022 | - | 23.08.2022 | - | - | € 5,337.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | ANULIM | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 8956 | 045 | 1 | 1 | 1 | 02 | FURNIZIM ME PELET PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT | 29.08.2022 | 31.08.2022 | 28.09.2022 | 04.10.2022 | 04.10.2022 - 03.10.2023 | 03.10.2023 | € 230,450.00 | € 272,350.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | N.P.T. „Haris", Rr. UCK-së, RAHOVEC | 1 | 13 | 4 | 2 | 1 | 1 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 9763 | 048 | 1 | 1 | 1 | 02 | FURNIZIM ME DRU PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT | 12.09.2022 | 16.09.2022 | 11.10.2022 | 12.10.2022 | 12.10.2022 - 12.12.2022 | 12.12.2022 | € 161,500.00 | € 159,220.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.T. „Haris" ; N.P.T „Acvilla, Rr. UCK-së, RAHOVEC | 1 | 12 | 3 | 2 | 2 | 1 |
| 1/2 | 11049 | 052 | 2 | 1 | 1 | 93 | SHËRBIMET E ENERGJISË (ESCO) PËR KOMUNËN E RAHOVECIT | 03.10.2022 | 24.10.2022 | 06.12.2022 | 12.12.2022 | 12.12.2022 - 11.12.2025 | 11.12.2025 | € 2,300,000.00 | € 2,300,000.00 | € 0.00 | € 0.00 | 19.701.71 Euro – Çmim për njësi; | Grup i Operatorëve Ekonomik: LCE SH.P.K.; JAVNA RAZSVETLJAVA d.d Branch in Kosovo, Rr.Ferid Curri Arberi, Prishtine, Prishtine | 1 | 33 | 2 | 1 | 2 | 1 |
| 2 | 11580 | 055 | 5 | 2 | 1 | 45 | PASTRIMI I PËRRENJVE DHE LUMENJËVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT | 20.10.2022 | 24.10.2022 | 13.12.2022 | 15.12.2022 | 15.12.2022 - 13.12.2024 | 13.12.2024 | € 143,550.00 | € 142,856.00 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | Mendi -P SH.P.K., KRAMOVIK, KRAMOVIK | 1 | 46 | 5 | 4 | 1 | 1 |
| 2 | 12680 | 059 | 1 | 2 | 1 | 17 | FURNIZIM ME REKUIZITA PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT | 07.11.2022 | 11.11.2022 | 02.12.2022 | 07.12.2022 | 07.12.2022 - 06.12.2023 | 06.12.2023 | € 24,579.50 | € 22,276.50 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | Grup i Operatorëve Ekonomik: MB TEXTILE SH.P.K., MEBLI DIZAJN SH.P.K., Xhelal Hajda Toni, p.n., Rahovec | 1 | 27 | 2 | 0 | 1 | 1 |
| 2 | 12829 | 060 | 2 | 2 | 1 | 93 | MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI I PALESTRËS SPORTIVE "MIZAHIR ISMA" NË RAHOVEC | 11.11.2022 | 17.11.2022 | 20.12.2022 | 22.12.2022 | 22.12.2022 - 20.12.2024 | 20.12.2024 | € 25,135.00 | € 25,135.00 | € 0.00 | € 0.00 | 883.92 Euro – Çmim për njësi; | Grup i Operatorëve Ekonomik: GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K.; Efa Dienstleistung GmbH Dega në Kosovë, Sheshi Ilmi Maliqi, RAHOVEC | 1 | 34 | 3 | 0 | 1 | 1 |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | € 3,550,513.45 | € 3,554,469.69 | € 0.00 | € 0.00 | € 0.00 | | | | | | | |

TOTALI (15+16-17) : 3,554,469.69

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Rahovecit

Astrit Mullabazi

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja c), nenit 17 dhe nenit 40 pika 2 shkronja (a) dhe (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 12, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2021 miraton këtë:

**RR E G U LL O R E**

**Për**

**Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021**

**Neni 1**

Neni 7 paragrafi 1 pika 18 largohet nga teksti bazik i Rregullores për Taksa Komunale.

**Neni 2**

Neni 10 paragrafi 1 i Rregullores bazike, pas pikës 15 shtohet pika 16, me tekstin si në vijim:

16. Referencat për Operatorët Ekonomik për projekte të përfunduara - Taksa 50€.

**Neni 3**

Neni 11 paragrafi 1 pika 4 dhe 24 largohen nga teksti bazik i Rregullores për Taksa Komunale.

**Neni 4**

Neni 17 paragrafi 4 i Rregullores bazike, shuma "600€" zëvendësohet me shumën "500€".

Neni 17 i Rregullores bazike, pas pikës 8 shtohet pikat 9, me tekstin si në vijim:

9.Dhënia e vërtetimit për taksa afariste – Taksa 5€.

**Neni 5**

Neni 20 i Rregullores bazike, pas fjalës "tokës" i shtohet fjala "(pronës)".

**Neni 6**

Neni 21 paragrafi 1 i Rregullores bazike, Nr. 0899 shuma "500€" zëvendësohet me shumën "1000€".

**Neni 7**

| | | |
|---|---|---|
| 23 | Parcela në format digjital (shpfile,dwg, gml, ili) mbi 5 ha- (sipas kërkesës së palës, pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) | **60€** |
| 24 | 5. Ndërtesa në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompania gjeodete e licencuar) | **5€** |
| 25 | 6. CD—kompakt disku | **0.50€** |
| 26 | 7. Kontrollimi dhe rregjistrimi në rregjistër të të dhënave nga tereni – për njesi kadastrale | **20€** |

2. Udhëzimi Aadministrativ (MEA) NR. 09/2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme.

3. Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 05/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave e pronave të paluajtshme.

| Nr. | Shërbimi | Taksa |
|---|---|---|
| | **Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në bazë të vlerës së transaksioneve** | |
| 1 | Për vlerën e transaksionit deri në 10.000 € | **30€** |
| 2 | Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € e deri në 50.000 € | **50€** |
| 3 | | |
| 4 | Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € e deri në 100.000 € | **70€** |
| 5 | Për vlerën e transaksionit prej 100.000 € e deri në 200.000 € | **90€** |
| 7 | Për vlerën e transaksionit prej 200.000 € e deri në 500.000 € | **120€** |
| 13 | Për vlerën e transaksionit mbi 500.000 €-e deri ne 1.000.000€ | **240€** |
| 14 | Për vlerë e transaksionet mbi vlerën mbi 1.000.000€ | **500€** |
| **15** | Për vlerën e kotratës-transaksionit që është vërtetuar para vitit para vitit 1999 | **50€** |
| **16** | Lirohen nga pagesa rastet kur keni të bëjmë me riregjistrim të pronave të paluajtshme në kadastër | |
| | **Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të kontratë mbi dhuratën** | |
| 30 | Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratë së dhurimit për qdo anëtar të ngushtë të familjes është: | **30€** |
| 31 | Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratë së dhurimit për personin që nuk është anëtar i familjes dhe që nuk i është caktuar vlera e pronës tarifa është: | **80€** |
| 32. | Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për dhurimin e pronës së paluajtshme, në të cilën është caktuar vlera e pronë dhe dhuratmarrës nuk është anëtar i familjes zbatuhet tarifa sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ (09/2020) | |
| | **Tarifa e regjistrimit të pronësisë apo të drejtave tjera sendore në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore** | |
| 30 | Tarifa për regjistrimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave tjera sendore në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor për çdo person është: | **30€** |
| | | |

| | | |
|---|---|---|
| | Tarifa për regjistrimin e të drejtës së servitutit për secilën parcelë dominante apo person | **30€** |
| | Tarifa për modifikimin e servitutit | **10€** |
| 56 | Tarifa për fshirjen e servitutit nga Regjistri | **20€** |
| | **Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit** | |
| 57 | Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje deri në 10 vite | **10€** |
| 58 | Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej dhjetë (10) vite deri në katërdhjetë (40) vite | **30€** |
| 59 | Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej katërdhjetë (40) vite deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vite | **50€** |
| | Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale | **10€** |
| | Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale | **20€** |
| | Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – Qirambajtjes, për pronat e privatizuara nga ish Ndërmarrjes Shoqërore, me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë vite (99), bëhet duke zbatuar tarifën e përcaktuar sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ (09/2020). | |
| 60 | Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 10 vite | **10€** |
| 61 | Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit –qira mbajtje me kohë zgjatje prej 10 deri në 25 vite | **30€** |
| 62 | Ndryshimi apo fshirja e regjistrimit të drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtje me kohë zgjatje prej 3 deri në 99 vite | **100€** |
| | **Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrave dhe ngarkesave tjera** | |
| | Lirohet nga tarifa regjistrimi i barrës | |
| | Lirohet nga tarifat regjistrimi i masës së sigurisë (masës së përkohshme) apo modifikim e saj | |
| | Tarifa për regjistrimin e vërejtjes sipas ligjit për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme | **40€** |
| | Tarifa për regjistrimin e ndalesës nga përmbaruesit privat apo gjykata në procedurë përmbarimore për çdo akt juridik është: | **30€** |
| | Tarifat për regjistrimin e vërejtjes të mbajtësit në pronën e paluajtshme të të mbajturit në momentin e lidhjes së kontratës mbi mbajtjen e përjetshme është: | **20€** |
| | Lirohet nga tarifa modifikimi i barrës apo ngarkesës tjetër. | |
| | Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër. | |
| | **Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale** | |
| | Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët është: | **30€** |
| | Lirohet nga tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasojë e gabimit të ZKK apo AKK, si dhe të gjitha gabimet e konstatuara nga sistemet e mëparshme. | |

Neni 34 i rregullores bazike, pas paragrafit 4 shtohet paragrafi 5, 6 dhe 7, me tekstin si në vijim:

5A.Lirohen nga taksa e vlerësimit të dëmeve në bujqësi nga komisioni personat fizik dhe juridik, në rast të fatkeqësive natyrore.

6A.Taksa për shërbimet profesionale për preprjen e pyjeve private janë:
6.1. Dru zjarri me vëllim më të vogël se $7m^3$ – Taksa $1.50€/m^3$.
6.2. Dru zjarri me vëllim mbi $7m^3$ – Taksa $2.00€/m^3$.
6.3. Dru teknik për $m^3$ – Taksa $3.00€/m^3$.

7A.Lartësia e taksave për shfrytëzimin e kullosave sipas llojit të bagëtisë janë:

| Nr | Lloji i bagëtisë | NB/kokë | EUR/kokë |
|---|---|---|---|
| 1 | Gjedhët mbi një vjet | 1 | 1.20 |
| 2 | Viçat | 0.45 | 0.54 |
| 3 | Delet | 0.18 | 0.22 |
| 4 | Qengjat | 0.1 | 0.12 |
| 5 | Kuajt dhe gomarët | 1 | 1.20 |
| 6 | Dosat | 0.5 | 0.60 |
| 7 | Derrat | 0.3 | 0.36 |
| 8 | Rosat | 0.014 | 0.02 |

**Neni 13**

Neni 36 paragrafi 1 pika 3 e rregullores bazike, riformulohet me tekstin si në vijim:

Kërkesa për plotësimin e kushteve minimale higjieno teknike për subjektet afariste.

Neni 36 paragrafi 1 pika 7, 8 dhe 9 fshihen nga teksti bazik i Rregullores për Taksa Komunale.

**Neni 14**

Neni 38 paragrafi 1 i Rregullores bazike, pas pikës 8 shtohet pika 9, me tekstin si në vijim:

9.Dhënia e vërtetimit (referencës) për OJQ-të që ushtrojnë veprimtari në Komunën e Rahovecit – Taksa 2€.

**Neni 15**

Neni 41 i Rregullores bazike, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3, me tekstin si në vijim:

Ndaj çdo subjekti afarist, i cili nuk përfill procedurat kundërvajtëse do të zhvillohet procedura përmbarimore.

**Neni 16**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale do të jetë pjesë e tekstit bazë të Rregullores në fuqi.

**Neni 17**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Të njoftohen:***

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 43-461/10
Data 15.02.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit<br>Defrim Kafexhiu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Blerim Hasani, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë<br>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural | |
| Përmes: | Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Besim Myrtezani**,Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 15.02.2023<br>Nr. 43-461/7 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Gëzim Sahiti, zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Driton Xhafa, Zyrtare për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë se Rregullores nga MBPZHR | |
| Lloji i aktit: | Rregullore e Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së (QRK) Nr. 06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| **Rregulloren Nr. 05/23 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa komunale Nr. 80/20, dt. 29.06.2020 e plotësuar dhe ndryshuar edhe me datën Nr. 169/21 me datën 260.02.2021** |
| I miratuar më datë: 30.01.2023 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.02.2023 |

Komisioni ndërministror, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

<table>
Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019")*, nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023 merr këtë:

**VENDIM**
**Për këmbimin e pronës komunale me pronën private**

1. **Miratohet** vendimi dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Skeja, zona kadastrale Xërxë, ngastra me numër P-71510033-01038-2 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1231$m^2$ (njëmijë e dyqind e tridhjetë e një metra katror) **I JEPET** në posedim Isni (Vehbi) Thaqi nga fsh. Xërxë, Komuna e Rahovecit, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510033-01041-1 në posedim të Isni (Vehbi) Thaqi nga fsh. Xërxë me sipërfaqe të përgjithshme prej 1472$m^2$ (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy metra katror) **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për hapjen e rrugës publike.

2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është për interes publik, dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.

3. OBLIGOHET, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.

5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbyera, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S NË R A H O V E C**

**01-Nr.____/2023**
**Me datë:28.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**
**_________________**
**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec/Municipality of Rahovec

Nr. Br. No 01/22 Nr. i faq/Br.str/No.pg 409
Datum/Date 28.12.2022

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë

**VENDIM**
**Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01041-1 në Zonën Kadastrale Xërxë**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/3097/22 i datës 08.12.2022 dhe merret vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik parcelën **P-71510033-01041-1** në Zonën Kadastrale Xërxë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1472m$^2$ (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy metra katror) në vendin e quajtur Skeja, me kulturë arë e klasës 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Isni (Vehbi) Thaqi nga fsh. Xërxë Komuna e Rahovecit.

2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës private me pronën komunale".

3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr.409/22**
**Datë:28.12.2022**

**Defrim Kafexhiu**
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510033-01038-2

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | 08-942/03-0049621/22 |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 02.11.2022 - 14:49 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Xërxë / Zrze / Xërxë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510033-01038-2 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 1231 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SKEJA- | | | | |



**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 4/Njiva 4 Klase/4th Class Arable Land | 1231 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | **Komuna e Rahovecit** | 600535233 | RAHOVEC /<br>ORAHOVAC /<br>RAHOVEC / | | DËSHMORËT E<br>PASHTRIKUT | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Xërxë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510033-01038-2 | Parcelë / Parcela / Parcel | 1231 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:428

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 02.11.2022

Koha/ Vreme/ Time: 02:51:56

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2023 merr këtë:

**VENDIM**

**Për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 149/2006 i datës 14.07.2006 për dhënien në shfrytëzim në kohë të caktuar të pronës komunale**

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi 01 Nr. 149/2006 i datës 14.07.2006 për dhënien në shfrytëzim në kohë caktuar në afat prej 10 (dhjetë) viteve të pronës së paluajtshme të komunës.

2. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që personin juridik NTP "Gëzimi" Xërxë ta shlyej si shfrytëzues i parcelës sipas certifikatës me Nr. P-71510008-00266-0 në zonën kadastrale Hoçë e Madhe dhe ta kthej në gjendjen e mëparshme në emër të titullarit, përkatësisht Komuna e Rahovecit.

3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***MAPL-së,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01Nr.___/23**
**Datë:28.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

| Kuvendi Komunal<br>Rr."Xhelal Hajda-Toni<br>Rahovec | | Skupština Opštine<br>Ul."Xhelal Hajda-Toni"<br>Orahovac |
|---|---|---|

Municipal Assembly
Str."Xhelal Hajda-Toni"
Rahovec

Kuvendi komunal Rahovec,duke vendosur sipas kerkeses se N.P.T „Gëzimi'' Xëexë ne çeshtjen administrative-ndarjen e tokes ne pronesine shoqerore per ndertimin e fabrikes se kartonave me nxemje me avull,ne baze te nenit 11 pika 3 te rregullores mbi veteqeverisjen e komunave te kosoves nr.2000/45,nenit 29 pika 2 e statutit te komunes se Rahovecit dhe nenit 40 te ligjit mbi tokat ndertimore(„Gazeta zyrtare e K SAK'' nr.14/80 ne mbledhjen e vet te mbajtur me 14. 07.2006, merr

## AKTVENDIM

I.- APROVOHET kerkesa e NPT„Gëzimi''Xërxë dhe i Ndahet ne shfrytezim ne kohe te caktuar ne afat prej 10 (dhjet) viteve,me te drejte vazhdimi per ndertimin e fabrikes per prodhimin e kartonit me nxemje me avull,parcela nr.266 ne vendin e quajtur „Kalinski dubovi'',sipas kultures kullose e kl.6 ne siperfaqe prej 1.00.99 ha nga fleta e posedimit nr.274 z.k.Hoqa e Madhe,PSh e Kosoves,titular K.K.Rahovec.

I.-Te drejtat dhe obligimet qe rrjedhin nga ky aktvendim,per dhenjen e tokes shoqerore ne shfrytezim ne kohe te caktuar,dote rregullohet me kontrate te veqant,ne pajtim me parimet e ligjit mbi token ndertimore,ndermjet KK te Rahovecit dhe shfrytezuesit NPT „Gëzimi'' Xërxë.

III.-Nese shfrytesuesi i tokes shoqerore ne afat prej 3 (tre) viteve nga dita e plotefuqishmerise se ketij aktvendimi nuk nderton objektin,ose nuk i kryen punet e konsiderueshme ne ndertimin e objektit industrial,KK Rahovec dote merr vendim mbi inicimin e procedures per denoncimin e kontrates mbi dhenjen e tokes shoqerore ne shfrytezim ,nen kushtet dhe menyren e caktuar sipas dispozitave te ligjit mbi token ndertimore dhe vendimit te KK Rahovec.

### Arsyetim

NTP „Gëzimi''Xërxë me kerkesen e vet 02 nr.123 te dt.30 05.2006 eshte drejtuar bordit te drejtoreve te KK Rahovec qe per ndertimin e fabrikes per prodhimin

e kartonit dhe amballazhes transportuese me nxemje më avull, i'iu ndahet parcela shoqerore me afer te cekur nes dispozitivin te keti aktvendimi,duke theksuar se per momentin eshte duke shfreytesuar me qira objktin e Sh.A.,,Ede-Comerc'' ne Gjakove e cila per shkak te hapesire jot te mjaftueshme, nuk i ploteson kushtet per prodhim.per qka eshte treguar nevoja,per zgjerimin e objektit industrial ,duke patur parasysh kerkesen e madhe te konsumatoreve dhe firmave prodhuese te cilet tani furnizohen ekskluzivisht nga kjo fabrike si prodhuese e vetme e kartonit ne Kosove.

Bordi i drejtoreve kerkesen ne fjale e ka percjelle drejtoris per kadaster,gjeodezi dhe sherbimit pronesoro-juridik,qe ne kete procedur te pregatis lenden me kompletimin e te dhenave kadastrale dhe provave tjera te mjafueshme per shqyrtim dhe vendosje.

Drejtoria ne fjale,nepermjet ekspertit te gjeodezise,ka dale ne vendin e ngjarjes ,dhe ka konstatuar se parcela shoqerore e cekur ne dispozitivin e keti aktvendimi ,ne tere siperfaqen e saje eshte e lire ,ne baze te se ciles eshte hartuar skica e terenit dhe kopja e planit, ne te cilen eshte pasqyruar kjarte pozita,kufiri dhe siperfaqja e cila mund te shfrytezohet per ndertimin e objektit industrial per prodhimin e kartonit dhe amballazhes transportuese me nxemje me avull.

Nga arsyet e cekura me larte eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

U vendos prane Kuvendit komunal Rahovec me 14.07.2006

KESHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi nuk mund te parashtrohet ankese ,por mund te zhvillohet konflikt administrative prane Gjykates Supreme te Kosoves ,ne Prishtinë,ne afat prej 30 diteve ,nga dita e pranimit.

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC
01nr.149/2006

Kryetari
Esad Haxhijaha

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-066, mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-143, të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L-108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40, paragrafi 2, pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 65, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë28.2.2023, miraton këtë:

**VENDIM**
**Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022, në vitin 2023**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/135/23, i datës 8.2.2023 dhe merret vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022, në vitin 2023, në shumën prej **479,989.22€ (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet e dy cent).**

2. Mjetet në shumën prej **479,989.22€ (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet e dy cent)**, do të barten në vitin 2023, në këto programe dhe kategori buxhetore si në vijim:

**Në kategorinë e investimeve kapitale, në shumën prej 419,989.22€:**

**2.1. Në programin Shërbimet Publike (180), nënprogrami Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional 0451.**

a) Ndërtimi i rrugëve Rahovec– Xërxe– Opterushë- Krushë e Madhe– Gexhe- Kramovik- Hoqë, kodi **53790**, në shumë prej **70,000.00€;**
b) Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (Gropa Septike), kodi **53866**, në shumën prej **50,000.00€;**
c) Ndërtimi i kanalit për ujëra atmosferike dhe ndërtimi rrugëve me kubëza në fshatin Zatriq, kodi **48181**, në shumë prej **7,200.00€.**

**2.2. Në programin Planifikimi Urban dhe Mjedis (660), nënprogramin Planifikimi Urban dhe Inspeksion (66360), kodi funksional 0620.**

a) Rregullimi i shtretërve të lumenjeve, përrockave, Krushë e Madhe– Polluzhë- Malësi e Vogël– Dejnë– Celinë- Sopniq, kodi **53800**, në shumën prej **120,000.00€;**
b) Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve dhe të Civilëve, Celinë– Krushë e Madhe- Opterushë– Ratkoc– Mrasor- Rahovec, kodi **53858**, në shumën prej **10,000.00€.**

2.3. **Në programin Kulturë, Rini, Sport (850), nën Shërbimet Kulturore– Rahovec (85011), kodi funksional 0820.**

a) Ndërtimi i Shtëpisë- muze "Bajram Curri", Krushë e Madhe, kodi **50753**, në shumën prej **25,000.00€;**

b) Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë së Kulturës, Celinë, në shumën prej **40,000.00€.**

2.4. **Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nënprogramin Administrata (92055), kodi funksional 0980.**

a) Ndërtimi i Çerdhes në Ratkoc, kodi **45787**, në shumën prej **37,600.00€;**

b) Ndërtimi i Shkollës Fillore, në Fortesë, kodi **48090**, në shumën prej **45,000.00€;**

c) Renovimet në shkollat Rahovec– Qifllak- Zoqisht, kodi **53783**, në shumën prej **20,189.22€.**

**Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, në shumën prej 60,000.00€:**

2.5. **Në programin Planifikimi Urban dhe Mjedisor (660), nënprogramin Planifikimi Urban dhe Inspeksion (66360), kodi funksional 0620, në shumën prej 60,000.00€.**

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb– faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01 Nr. ___/2023**
**Datë: 28.02.2021**

**Defrim Kafexhiu**

__________________

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02
Nr./Br./No 135 Nr. i fq/Br.str/No.pg 108
Data/Datum/Date 8 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58, shkronja (h), të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-143, të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, 74 paragrafi 1, dhe paragrafi 2, pika 2.9 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, u:

**PROPOZON**

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit me të cilin lejohet bartja e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022, në vitin 2023.

2. Mjetet e pashpenzuara nga viti 2022, janë në shumë prej **479,989.22€ (katërqind e shtatëqind e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë euro e njëzet e dy cent)**, të cilat do të barten në vitin 2023, dhe do të shpërndahen në kategori ekonomike të caktuara, si në vijim:

**Në kategorinë e investimeve kapitale në shumën prej 419,989.22€:**

**2.1. Në programin Shërbimet Publike (180), nënprogrami Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**

a) Ndërtimi rrugëve Rahovec– Xerxe– Opterushë- Krushë Madhe– Gexhe– Kramovik - Hoqë, kodi **53790**, në shumë prej **70,000.00€;**
b) Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (Gropa Septike), kodi **53866,** në shumë prej **50,000.00€;**
c) Ndërtimi i kanalit për ujëra atmosferike dhe ndërtimi i rrugëve me kubëza në fshatin Zatriq, kodi **48181,** në shumë prej **7,200.00€.**

**2.2. Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nënprogramin Planifikimi Urban dhe Inspeksion (66360), kodi funksional 0620.**

a) Rregullimi i shtretërve të lumenjeve, përrockave, Krushë e Madhe– Polluzhë– Malësi e Vogël– Dejnë– Celinë- Sopniq, kodi **53800,** në shumën prej **120,000.00€;**
b) Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve dhe të Civilëve, Celinë– Krushë e Madhe– Opterushë– Ratkoc– Mrasor- Rahovec, kodi **53858,** në shumën prej **10,000.00€.**

**2.3. Në programin Kulturë, Rini, Sport (850), nën Shërbimet Kulturore– Rahovec (85011), kodi funksional 0820.**

a) Ndërtimi i Shtëpisë- muze "Bajram Curri", në Krushë të Madhe, kodi **50753,** në shumën prej **25,000.00€;**
b) Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë së Kulturës, në Celinë, në shumën prej **40,000.00€.**

**2.4. Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nënprogramin Administrata (92055), kodi funksional 0980.**

a) Ndërtimi i Çerdhes në Ratkoc, kodi **45787**, në shumën prej **37,600.00€;**

b) Ndërtimi i Shkollës fillore ne Fortesë, kodi **48090**, në shumën prej **45,000.00€;**

c) Renovimet ne shkollat Rahovec– Qifllak- Zoqisht, kodi **53783**, në shumën prej **20,189.22€.**

**Në kategorinë Mallra dhe Shërbime, në shumën prej 60,000.00€:**

**2.5. Në programin Planifikimi Urban dhe Mjedisor (660), nënprogramin Planifikimi Urban dhe Inspeksion (66360), kodi funksional 0620, në shumën prej 60,000.00€**

3. Për zbatimin e këtij propozimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Me propozim të njoftohen:***

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

pël:

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17, paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë**

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.

2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-72510063-00722-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1689m$^2$ (njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë metra katror), zona kadastrale Polluzhë, e evidentuar në posedim të P. SH. E KOSOVË. K. K. RAHOVEC. SHKOLLA FILLORE.

3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen **200m$^2$ (dyqind metra katror),** për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.

4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 200m$^2$ (dyqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë sipas pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566, i datës 30.5.2013, gjendet brenda zonës ndërtimore.

5. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit, do të financohet nga donatorët.

6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet, nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore, apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.

7. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, në Komunën e Rahovecit, që ta bëjë parcelizimin dhe skicimin në terren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastralë.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb– faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe***
- ***Arkivi.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S R A H O V E C**

**01-Nr.____/23**
**Me datë:28.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**

**________________**

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Rahovec/Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kabineti i Kryetarit të Komunës/Kabinet Predsednika Opštine/Municipal Mayor Cabinet
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 123 Nr. i fag/Br.str/No.pg 107
Data/Datum/Date 6 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008)*, nenit 74, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika 2.9 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, u:

## PROPOZON

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit, për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij propozimi, do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-72510063-00722-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1689m$^2$ (një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë metra katror), zona kadastrale Polluzhë, e evidentuar në posedim të P. SH. E KOSOVË. K.K. RAHOVEC. SHKOLLA FILLORE.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2, të këtij propozimi, ndahen **200m$^2$ (dyqind metra katror)** për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë.
4. Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 200m$^2$ (dyqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Polluzhë, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij propozimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566, i datës 30.5.2013, gjendet brenda zonës ndërtimore.
5. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit do të financohet nga donatorët.
6. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet, nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore, apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
7. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

***Me propozim të njoftohen:***

1. ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
2. ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
3. ***Arkivi.***

Republika e Kosovës – Komuna e Rahovecit

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510063-00722-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0004930/23 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 30.01.2023 - 09:17 |
| Komuna / Opština / Municipality: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Polluzhë / Poluža / Polluzhë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510063-00722-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 1689 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| SELO-SELO | | | | |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Albina Durguti | P-71510063-00722-0 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Oborr/Dvorište/BackYard | | 1569 |
| 2 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building | | 120 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | P.SH.E<br>KOSOV.K.K.RAHOVEC.SH<br>KOLLA FILLORE | KCID1513644 | Polluzha / Polluzha /<br>Polluzha / | | POLLUZHA 34 | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Polluzhë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510063-00722-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 1689 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:424

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 30.01.2023

Koha/ Vreme/ Time: 09:27:59

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo**
**Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec**

**Drejtoria e Urbanizmit,planifikim dhe mbrojtje e mjedisit**
**Uprava za urbanizam,planiranje i zashtitu okoline**
Department for Urbanism, planning and environmental protection

| | |
|---|---|
| Numër: reference/protokoli | |
| Data: | 06.02.2023 |
| Për: | **Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë** |
| Nga: | Drejtoria për Urbanizm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Rahovecit |
| Përmes | Drejtorit të drejtorisë **Albnor Mullabazi** |
| **Lënda / subjekti** | **Vërtetim Urbanistik** |
| Baza: | Plani Zhvillimor Komunal nr.2566 të datës 30.05.2013 dhe ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative |

Bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të datës 06.02.2023, për mes emailit për verifikimin e destinimit sipas PZHK-së që është në fuqi për parcelën nr. 722-0 në sipërfaqe prej 1689 m²

1. Ngastra kadastrale Nr. P-71510063-00722-0, vendi i quajtur Selo Selo, me sipërfaqe 1689 m², pronë shoqërore-paluejtshmëria, K.K.Rahovec, z.k. Kramovik.

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit pas shqyrtimit të lëndës dhe shkresat e lëndës suaj ka konstatuar se:
Ngastra kadastrale me Nr. P-71510063-00722-0 në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) nr.2566 të datës 30.05.2013 kjo parcelë është brenda **Zonës Ndërtimore.**
Shiko Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013.

***Pëlqimi ti dërgohet :***

1. *Palës*
2. *Arkivit të Drejtorisë .*

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.00.2022 merr këtë:

**VENDIM**
**Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në __ (_________) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 000/22 i datës 00.00.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510068-01952-1, respektivisht tregut të fshatit Ratkoc.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
   **2.1.** _______________, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
   **2.2.** _______________, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
   **2.3.** _______________, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
   **2.4.** _______________, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
   **2.5.** _______________, përfaqësues nga sektori joqeveritar.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në __ (__________) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.

4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.

6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivi***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01Nr. ___/23**
**Datë: 00.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**
________________
**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), nenit 17, shkronja c) dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17, paragrafi 1 dhe 2, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10, paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, paragrafi 1 pika 1.3,, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me datë 00.02.2023, merr këtë:

**VENDIM**
**Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 000/22, i datës 00.00.2022, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510057-02240-73.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
   **2.1.** _______________, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
   **2.2.** _______________, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
   **2.3.** _______________, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
   **2.4.** _______________, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
   **2.5.** _______________, përfaqësues nga sektori joqeveritar.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.

4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.

6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb– faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS RAHOVEC**

**01 Nr.____23**
**Datë:00.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**

**_______________**
**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016")*, nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.00.02.2023 miraton këtë:

**V E N D I M**
**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01-Nr. 406/22 i datës 28.12.2022 për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01-Nr. 406/22 i datës 28.12.2022 për miratimin e Planit të Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027.

2. Ndryshimi dhe plotësimi bëhet duke u bazuar në shkresën me rekomandimet nga ana Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës 07 Nr. 740 të datës 23.01.2023 dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-16/8 të datës 02.02.2023 e që ka të bëjë me plotësimin e Planit me Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01-Nr. 406/22 i datës 28.12.2022 mbesin të pandryshuara.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr.___/23**
**Datë:00.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17 dhe nenit 40 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal *("Gazetën zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008")*, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 pika 2.3 dhe 2.6, nenit 65 paragrafi 1 pika 1.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, e në mbështetje të Rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20 të datës 29.06.2020, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.02.2023, miraton këtë:

**V E N D I M**
**Për faljen e borxhit të pa paguar për taksën në aktivitet (afariste)**

**Neni 1**
Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të pa paguar për taksën në aktivitet (afariste), për të gjithë taksapaguesit e Komunës së Rahovecit nga data **1.1.2000** deri më **31.12.2017.**

**Neni 2**
Me miratimin e këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të pa paguara për taksen në aktivitet (afariste), të gjitha borxhet e taksapaguesve, përfitues nga periudha e cekur në nenin 1, të këtij vendimi nga zyrtarët përgjegjës të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

**Neni 3**
Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.

**Neni 4**
Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8, të Rregullores (QRK) Nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

**K U V E N D I  I  K O M U N Ë S  N Ë R A H O V E C**

**01-Nr.___/23**
**Me datë:00.02.2023**

**Defrim Kafexhiu**
______________
**Kryesues i Kuvendit**